

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CCXVI
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 81

SELMAN RIZA

VEPRA

6

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CCXVI
SECTION OF LINGUISTICS AND LITERATURE
BOOK 81

SELMAN RIZA

OEUVRES

6

Prepared by academician Rexhep Ismajli
Translations from French: Rexhep Ismajli

Approved for publication at the meeting of the Section of Linguistics and Literature,
held on 27th September, 2022.

Editor: Academician Sabri Hamiti, Secretary of the Section of Linguistics and Literature.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CCXVI
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË
LIBRI 81

SELMAN RIZA

VEPRA

6

Përgatiti: akademik Rexhep Ismajli
Përkthimet nga frëngjishtja: Rexhep Ismajli

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë,
mbajtur më 27 shtator 2022.

Redaktor: Akademik Sabri Hamiti, sekretar i Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë.

Copyright © ASHAK



Selman Riza

PËRMBAJTJA

Rexhep Ismajli: Nga gjuhësia tek intelektuallogjia.....	9
Trakti dhe platforma për Kosovën.....	10
Kanuni i Lekës në Burgun e Prishtinës.....	11
Irena Sawicka: Një gjuhëtar shqiptar që meriton të mbahet mend.....	25
Mbi Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe rendin shoqëror që i përgjigjet	31
Letër përcjellëse në vend të hyrjes	33
Mbi Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe rendin shoqëror që i përgjigjet	35
Sur le “Canon” de Lec Doukadjin et l'ordre social auquel il correspond...71	
Lettre d'accompagnement en guise d'introduction.....	73
Sur le “Canon” De Lec Doukadjinn et l'ordre social, auquel il correspond	77
Luftë kundra okupatorit! - Luftë kundra germanit!.....	115
Sur une concordance grammaticale spécifique de l'albanais avec le grec.....	129
Mbi gjuhësinë – komunikativistikën, logjikën – intelektuallogjinë, nga dorëshkrim “mendime të shkëputur të një vazhde së vetme”	149
Teza e Pavlovit	153
Tri teza intelektuallogjike:.....	163
Dy pasionet e jetës sime	167
<i>Gramatika dhe Kosova</i>	167
Intelektologjia dhe komunikativistika.....	180
Nga logjika dhe linguistika në intelektuallogjinë dhe komunikativistikën	196
Një analizë kritike e “signalevet” të Pavlovit.....	203



*Në mes Eqrem Çabej dhe Selman Riza, anash Hilmi Agani, Besim Bokshi
dhe Rexhep Ismajli, Tiranë, para Hotel Dajti, 1980*

REXHEP ISMAJLI: NGA GJUHËSIA TEK INTELEKTOLOGJIA

Selman Riza ka lindur më 1909 në Gjakovë, ku i ka filluar mësimet e para, për të vazhduar shkollimin fillor në Tiranë, pastaj në Liceun e Korçës, për të ndjekur dhe mbaruar në vijim studimet për filologji (gjermanike) dhe për jurisprudencë, të dyja në nivelin tradicional francez *Licence* në Universitetin e Toulouse-s. Kishte punuar profesor i Liceut të Korçës, ku ka dhënë mësim të shqipës, të frëngjishtes, të latinishtes e të materieve filologjike. Më 1939 e kishin larguar nga Korça për Tiranë dhe në vijim përjashtuar nga mësimdhënia *përgjithmonë* dhe për shkak të aktivitetit kundër pushtimit italian e kishin internuar në Ventotene për 1,5 vjet. Pastaj kishte punuar si nëpunës në një ndërmarrje private në Durrës, pastaj si avokat në Prizren, ishte marrë dhe me organizime e veprimtari që lidhen me statusin e ardhshëm të Kosovës, për çka kishte përfunduar në burg në Tiranë më 1945 me akuzat “*kosovar, irredentist, antijugosllav*”, por asnjëherë nuk ishte trajtuar në gjykatë, as ishte ngritur kundër tij padi. Thuhet se në burgun e Tiranës ishte hetuar nga hetues jugosllavë, por edhe nga hetues shqiptarë, por për gjithë atë periudhë nuk ka asnjë gjurmë arkivore të zbuluar deri tash. Më 1945 e kishin nisur për ta ekstraduar në Jugosllavi (me urdhër të Koçi Xoxës), edhe pse kishte shtetësi shqiptare, porse me ndërhyrje (mbase të Enver Hoxhës) e kishin kthyer mbrapsht nga Shkodra dhe kishte qëndruar në burg në Tiranë deri më 1948, kur e kishin dorëzuar në Jugosllavi me dyshimet që ishin vënë në fillim. Nga 1948 deri në gusht 1951 e kishin mbajtur në burg në Prishtinë, por pa vendim gjykate dhe pa asnjë procedurë gjykimi. Në gusht 1951 e kishin lënë të lirë nga burgu, por ia kishin caktuar vendbanimin e detyrueshëm (internim) në Sarajevë, ku kishte punuar si lektor i gjuhës frënge në Universitetin e atjeshëm. Më 1953 ishte kthyer në Prishtinë për të punuar në Institutin e sapothemeluar albanologjik deri më 1955, kur u mbyll Instituti, Selman Riza u deportua në Shqipëri, sepse nuk e kishte pranuar shtetësinë jugosllave. Nga dhjetori 1955 e më tej jetoi në Tiranë, u caktua të punonte në Institutin e Gjuhësisë-Historisë (më tej në Universitetin Shtetëror të Tiranës) dhe ishte vënë në survejim intensiv, siç shihet nga *Dosja 2B* e botuar më 2009 (R. Ismajli: *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*, ASHAK, Prishtinë 2009, f. 395-487). Më 1967 u internua sërish, këtë herë në Berat, ku qëndroi deri në pensionim (1970). Prej atëherë deri më 1988 jetoi në Tiranë.

Në vitin 1943 në Prizren bashkë me një grup entuziastësh kishte kërkuar

nga Ministria e atëhershme për kulturë e arsim e Shqipërisë të themelohej *Qendra e studimeve kosovare*. Në periudhën 1936-1944 kishte botuar disa shkrime e studime nëpër revista, sidomos te *Përpyjekja shqiptare*, dhe më 1944 në Tiranë veprën *Tri monografina albanologjike*. Më 1953 kishte marrë pjesë në Mbledhjen e gjuhëtarëve në Prishtinë, ndërsa pastaj, përveç artikujve në shtypin dhe revistat e kohës (*Rilindja*, *Zâni i rinis*, *Jeta e ré*, *Përparimi*), kishte botuar librat: *Fillimet e gjuhësisë shqiptare* 1952, *Gramatikë e serbokroatishtes* 1954, *Pronorët e shqipës*, 1953 dhe e kishte lënë të përfunduar (bashkë me M. Bardhin) *Fjalorin terminologjik shqip-serbisht-frangjisht*. Në Tiranë me të gjallë kishte botuar studime në revistat *Buletin i USHSH*, *Studime filologjike* dhe si monografi të veçantë *Emrat në shqipë*, *Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* 1965 (përfunduar për shtyp më 1963), si dispensa *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe* 1961. Më 1979 në Prishtinë me redaktim të H. Aganit, B. Bokshit e R. Ismajlit u botua te Rilindja një përzgjedhje e studimeve të tij me titull *Studime albanistike I*. Ishte parashikuar që seria të vazhdonte më tej, por pas vitit 1981 nuk qe e mundur. Nga veprat që kishte lënë dorëshkrim pas vdekjes në Tiranë u botuan *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe* dhe *Foljet e shqipës*. Nga viti 1996 në ASHAK në Prishtinë nisi seria e botimeve të tij të veprave me titull të përbashkët *Vepra* dhe në vijim dolën 5 vëllime, ku përfshiheshin të gjitha studimet e tij të botuara dhe dorëshkrimet, të cilat ai ia kishte lënë testament autorit të këtyre radhëve. Ne patëm mundësi të merreshim me to vetëm me një distancë kohore brenda së cilës një pjesë e tyre kishte qarkulluar ndër të interesuar të tjerë. Më 2009 te Dukagjini në Pejë botuam vëllimin *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, që Riza e kishte lënë në 13 fletore të shkruara me dorë, e që janë gjurmë shumë të vlefshme për rrjedhat e preokupimeve të tij në periudhën pas pensionimit. Më 2009 Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike në Tiranë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë botoi vëllimin me studime të tij *Vepra të zgjedhura*.

Selman Riza vdiq dhe u varros në Tiranë më 1988. Sipas amanetit që kishte lënë me shkrim në *Fletore* mbetjet e tij u rivarrosën në vendin e tij të lindjes – Gjakovë në 100-vjetorin e lindjes së tij.

Trakti dhe platforma për Kosovën

Në tetor apo nëntor 1943 kishte “*nxjerrë edhe një trakt për të argumentuar e popullarizuar këtë platformë aq konforme me aspiratat e kosovarëve dhe drejtësinë ndërkombëtare*”, ku, gjithë duke agjitur me parullën “*as bisht i Ballit, as shtojcë e Frontit*”, vepronte “*për krijimin e një lëvizjeje irredentiste antifashiste kundër rikthimit eventual në Kosovë të dominacionit jugosllav të cilësdo credo*

ideologjike dhe të cilitdo rend shoqëror (pastë për të qenë)”. Traktin të nënshkruar nga Selman Riza nuk e kemi gjetur, por në Arkivin e Kosovës, te *S. Riza, dokument br. 2172, Istoriska Komisija, OK SK za Kosmet, Prishtinë*, kemi gjetur një dorëshkrim prej 9 faqesh të formatit të madh, për të cilin, në bazë të shkrimit dhe të gjuhës, kuptohet edhe të faktit se është klasifikuar në dokumentacionin për S. R., edhe pse faqja ku mund të jetë nënshkrimi mungon, kemi prurë bindjen ta identifikojmë si tekst të Selman Rizës, dhe pikërisht si tekstin për të cilin ka folur edhe ai vetë në shënimet biografike. Këtë dokument po e sjellim këtu të tejskruar. Dorëshkrimi që kemi gjetur nuk është i plotë.

Në periudhën mars-korrik 1944 në Tiranë S. Riza e kishte hartuar monografinë “*Për dokumentarin e kundërtezës shqiptare (mbi çështjen nacionale të Kosovës)*”, dorëshkrim të cilit deri sot nuk i kemi rënë në gjurmë. Supozoj se duhet të gjendet diku nëpër arkivat në Tiranë.

Kanuni i Lekës në Burgun e Prishtinës

Sa kishte qëndruar në burg në Prishtinë Selman Riza kishte shkruar studimin mbi *Kanunin e Lekë Dukagjinit*, të cilin e kishte hartuar me dorë në gjuhët frënge dhe serbe (ai vetë rrëfente ta kishte hartuar edhe shqip, por versioni shqip nuk është gjetur). Ai dorëshkrim është ruajtur në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve në Beograd, ku ndërkohë ishte marrë si kopje nga Petrit Imami, prej të cilit e kishte marrë të fotokopjuar dr. Etleva Domi për Bibliotekën Kombëtare në Tiranë më 2005. Ne kemi një fotokopje prej së cilës e kemi lexuar dhe tejskruar tekstin frëngjisht, që po sjellim këtu. Ndërkaq, teksti serbisht është po ashtu i lexueshëm, ashtu siç ishte dorëshkrimi i S. Rizës, me alfabet cirilik dhe me një serbishte të saktë dhe të përzgjedhur të kohës. Përkthimin shqip e kemi bërë duke u nisur nga versioni frëngjisht, por në shumë raste na është dashur ta konfrontojmë me versionin serbisht, qoftë për faktin se terminologjia përkatëse e fushës së të drejtës zakonore lidhur me kanunin në këtë gjuhë mund të ketë qenë më e afërt me të shqipes, qoftë edhe për qartësinë e mendimit eliptik, të hartuar me mjete skajshmërisht të kursyera shprehjore dhe përmes fjalive-tekste, të ndërkallura, të nënrenditura e të zgjatura pikërisht në paragrafë të tërë me argumentime të niveleve të ndryshme brenda dhe me përfundime po kështu komplekse, të plota e të sakta. Siç e thoshte dhe vetë, hartimi-përshtatja e tekstit në tri gjuhë, e kishte ndihmuar edhe vetë saktësimin e shprehjes, apo ndonjëherë edhe të mendimit të tij. Frëngjishtja e tij, ashtu si paraqitet në këtë tekst po edhe në tekste të tjera më vonë, është tërësisht e ndërtuar, madje-madje, në raste të veçanta ai shtrëngohej të krijonte dhe terminologji që i shkonin përshtat të menduarit të tij për këtë rast, e

që nuk i gjente gjetiu. Sikur ta kishim në dorë tekstin shqip, do të kishim pasur mundësi të diskutonim dhe për çështje të konfrontimit midis tri versioneve në gjuhë të ndryshme dhe të përkapnim tërë dimensionet iluminuese të kësaj situatë vërtet të rrallë në raport me një mendje kështu virtuozë.

Më 2019 prof. dr. Begzad Baliu më dha përkthimin serbisht të *Kanunit të Lekë Dukagjinit*, si kopje (prepis) me makinë, nga teksti origjinal, për çka e falënderoj. Origjinali ruhet, mbase, në Akademinë Serbe të Shkencave dhe të Arteve, apo është marrë nga trashëgimia e ish Institutit Albanologjik apo në Arkivin e Kosovës (këtë nuk e di). Kopja që kam mban titullin:

Zakon Leke Dukadini-a /prepis/, 228 strana, ff. I-XVI: Zakon Leke Dukadini-a. Predgovor, P. Gjergj Fishta, O.F.M.; ff. XVII-XVII-XX: Biografske beleške o ocu Shtjefen Konstantin Gječov, A. P. Bardhi, O.F.M.; ff. XXI-XXII: pa titull, Faik Konica; f. 0: Zakon Leke Dukadini-a /Delo objavljeno posle smrti/Sakupljeno i kodificirano od A. Shtjefen Konst. Gječov, O.F. M. sa predgovorom od A. Gjergj Fishte-a, O.F.M. i biografijom od A. Pashk Bardhi-a, O.F.M. Grb: Dvoglavi orao sa inicijalima SHQIP /Šćipnija/ SKADAR, Franjevačka štamparija 1933 godine. ff. 1-203: Kanuni.

dhe nuk ka emër të përkthyesit. Në bazë të gjuhës më duket se mund të jetë përkthim i Selman Rizës. Nuk ka as datë apo shënim tjetër.

Më 27 gusht 2022 B. Baliu më shkruante ndër të tjera: “...dorëshkrimi origjinal i përkthimit të *Kanunit të Lekë Dukagjinit* gjendet në Arkivin tim personal dhe besoj se mbeti gjatë rrugëtimit në linjën: Riza (Nimani) Danqetoviç – Ajeti.”

Me Akademik prof. dr. Idriz Ajetin kemi qenë bashkë në redaksinë për botimin e veprave të Selman Rizës, por nuk mbaj mend ta ketë përmendur përkthimin e *Kanunit*. Kjo është krejt sa di unë.

Në studimin dorëshkrim *Mbi kanunin e Lekë Dukagjinit* nga burgu i Prishtinës Selman Riza thoshte shprehimisht se nuk e kishte pasur në atë kohë në dorë botimin e *Kanunit* të përgatitur nga Shtjefën Gjeçovi, porse referonte botimin *Të drejtat e Shqipnis ethnike* nga Leka 1938, çka do të thotë se *Kanunin* ai mund ta kishte përkthyer pas muajit prill 1949, nuk dihet sa ishte në burg, apo më vonë në Prishtinë, gjithnjë me supozimin se kopja që kemi është përkthimi i tij.

Dorëshkrimi i studimit *Mbi kanunin e Lekë Dukagjinit dhe rendin shoqëror që i përgjigjet*, që ishte ruajtur në Beograd dhe që po sjellim këtu të përkthyer shqip dhe të transkriptuar frëngjisht, ka gjithsej 61 faqe të formatit të madh (A4) të fletoreve me pagjnim 1-61 serbisht dhe 1a-61a frëngjisht. Është shkruar i tëri në burgun e Prishtinës me kërkesën e një të cilësuar si *Shok*... Versioni shqip nuk është gjetur.

Në këtë studim Selman Riza shqyrtonte çështjen e Kanunit të Lek Dukagjinit,¹ më parë se nga aspekti juridiko-etnologjik, nga aspekti i një interpretimi sociologjik. Në të vërtetë, ai merrej në radhë të parë me Kanunin nga aspekti i rendit shoqëror që i përgjigjet atij, si e përgjithshme, për të lënë hapësirë për vështrime të veçanta të së drejtës zakonore të ngërthyer në të. Në vështrimin e tij rendi shoqëror malsor-fisnor i Shqipnisë së Veriut nuk dilte i njëjësueshëm me asnjë prej rendeve shoqërore të njohura të vendosura nga teorikët e socializmit shkencor, kështu që ai e shihte të nevojshme të diskutonte arsyet përse u lanë në heshtje specifikat shoqërore të fiseve malsore dhe dobinë që do të kishim nga ai diskutim. Kështu diskutimet e tij shtrihen në kapituj të veçantë për transformimet e komunitetit primitiv në shoqëri skllavopronare, pastaj për transformimin nga komuniteti primitiv në fiset malsore, për federativitetin në raportet brendafisnore dhe ndërfitnore te fiset malsore, federativitet që ndërlidhet me paaftësinë e rendit shoqëror përkatës për të bërë aparatit shtetëror dhe për arsyet e mbijetesës në ato rrethana.² Diskutimet e tij ndërlidhen sidomos në shqyrtimet për mungesën e apa-

¹ Kanuni i Lekë Dukagjinit është përkthyer e botuar serbokroatisht më 1986 nga dr. H. Trnavci: *Kanon Leke Dukadžinija* (posthumno djelo). Sakupio i kodificirao Štjefen Konstantin Đečovi, Stvarnost, Zagreb, ff. 203.

² At Gjergj Fishta në *Parathënien* e tij për botimin postum të Kanunit të Lekë Dukagjinit të mbledhur dhe kodifikuar nga At Shtjefën Gjeçovi, problematikën e kanunit të parë në raport me rendin shoqëror që i përgjigjet atij, ishte nisur nga konceptimi i zhvillimeve në 5 faza – e para është ajo e “*shteteve civile*” oksidentale (të krishtera), që bazohet në pranimin e të mirës si parim në relacion me jetën shoqërore e me jetën fizike të njeriut; e dyta është ajo e kulturës së popujve me perfeksion kultural e material, që perfeksionin moral e mbështesin në parime morale të zbuluara prej së vërtetës së hyjnueshme ose mbi parime prej vetvetes të njohura ose edhe mbi parime të rrejshme, pra rend civil si te grekët e romakët; e treta shkallë e kulturës shfaqet tek ata popuj që synojnë të mirën e përbashkët, ashtu si në kulturën e krishterë apo në greko-romaken, por mbi bazë “ersijet të mendjes”, nuk e marrin në kujdes perfeksionimin kultural e material të kolektivitetit, këtë ia lënë privatit, nuk kanë mjete materiale të përbashkëta, ndërsa veprimi i autoritetit përmbledhet në formulën “*me pré ligje e m, e dá gjyq*”, pra kanë një kulturë legjendare, heroike, sepse sundon parimi i lirisë, i nderit dhe burrnisë; në rendin e *katërt* hyjnë shtetet ku për qëllim “*nuk áshet e mira e përbashkët*”, po ajo e sovranit, kastës zotnuese, mjetet e përbashkëta përdoren “*me zhveshë popullin, me i pengue lirinë*”, pra karakterizohet me sundimin e tiranit në raport me rajanë, shoqëri barbare; rendi i *pestë* është ai i familjeve zakonisht të një fisi, nën një krye me qëllim që ta mbajë ekzistencën fizike, nuk kanë vend të ngulur as ligje të përbashkëta, gjithëçka bëhet sipas hamendjes së kryetarit, përgjithësisht *t’egjër*. Të gjitha këto, edhe mund t’i kishte parasysh Riza, por as korrespondojnë me mënyrat e tij të analizës, që ndërlidhen me trajtime të një tjetër rendi të sociologjisë borgjeze dhe të “socializmit shkencor” me Marxin e Leninin (rendi shoq. primitiv, rendi skllavopronar, rendi feudal, rendi kapitlaist dhe rendi socialist).

ratit shtetëror – *pa-shtetësinë* në shoqëri në përgjithësi dhe në fisin malsor në veçanti, pra në fisin malsor-alpin, edhe te zviceranët e te baskët, çka e justifikonte, sipas tij, shqyrtimin si një rend të veçantë shoqëror, të cilin klasikët e socializmit shkencor e kishin lënë anash për arsyt që nuk i kanë thënë, por që Riza provon t'i supozojë. Me atë rast sikur sugjerohet një vëzhgim për raportet e papajtueshme midis shtetit dhe lirisë: *“Thamë tashmë se për barazinë reale, për pasojë për lirinë reale në shoqërinë fisnore malsore, dëshmon pa dyshim vetë fakti i mos-ekzistencës tek ajo të çdo aparati të Shtetit. Në të vërtetë, shteti dhe liria përjashtohen reciprokisht. Pos tjerash, ekzistenca në një shoqëri e një aparati është gjë kaq vendimtare për lirinë individuale të pjesëtarëve të asaj shoqërie, saqë thelbi i çdo kontraverze filozofike mbi përparësitë e individualizmit dhe papërshtatshmëritë e kolektivizmit dhe e kundërta reduktohet në çështjen e dëmshmërisë apo e dobisë nga Shteti...”*

Konceptimin e *pa-shtetësisë fisnore* ai e vinte në përqasje me të proklamuarën *pa-shtetësi komuniste*, gjithnjë duke diskutuar për konceptimet e shtetësisë në sociologjinë borgjeze dhe në socializmin shkencor, për të kuptuarit e qeverisjes, në një anë, dhe të *pa-qeverisjes*, në anën tjetër. Në vijim diskutonte përmbledhtazi reflekset për vështrimin konceptual të shtetit si përbërës të rendit shoqëror përkatës, për aspektet imperialiste të shtetit lidhur me pushtetin, për degjenerimet e mundshme edhe në shoqërinë komuniste drejt kuazi-imperializmit të përkohshëm dhe më tej drejt llojit të qeverisjeve klasore, etj., në tërësi lidhur me shtetësinë primitive në shoqëritë komuniste, etj. Diskutonte po ashtu për arsytet se përse sociologjia borgjeze e reduktonte shtetësinë në qeverishmëri, etj., për të arritur te kapitulli i fundit, ku synonte të shprehte pikëpamjen e vet për vëllimin konceptual të shtetit. Gjithë duke synuar *“përjashtimin paraprak të çdo tentative eventuale nga ana e ndonjë shpirti paqësor për ta interpretuar pikëpamjen tonë mbi vëllimin konceptual të Shtetit si rektifikim temrinologjik të teorisë së Marksit e të Leninit mbi Shtetin”*, ai sillte propozicionet që kujtojmë se duhet të jepen të plota, sepse kanë të bëjnë me: *“a) shndërrimin eksepsional të komunizmit primitiv në fisni (tributarietet) malsore; b) rendin shoqëror si element i parë përbërës i çdo Shteti; c) dallimin e formës parësore shtetërore (me pushtet shoqëror të përkohshëm), që në zhvillimet e deritashme të shoqërisë njerëzore vërtet ka krijuar përjashtim, por që para vetes e ka të ardhmen – me formën statale dytësore (me qeveri të përhershme klasore), që, pa dyshim e ka përbërë rregullën e zhvillimit të përmendur, por që i shtrohet shuarjes dhe ç) vendosjen në shoqërinë komuniste të formës parësore shtetërore”* – jemi të vetëdijshëm, duke ritheksuar se propozicione të tilla – *“pasi të jenë verifikuar shkencërisht, do të paraqisnin një zhvillim të mëtejshëm të teorisë marksiste-leniniste për Shtetin”*.

Në tërësi, duhet të mbajmë parasysh derisa lexojmë këtë tekst disa aspekte me rëndësi: formimin e S. Rizës si filolog dhe si jurist, mtesat e tij të përhershme në fushën e gnoseologjisë, në këtë rast manifestimin e mtesave për të zhvilluar pikëpamjet e tij për rendin shoqëror dhe për interpretimet mirëfilli sociologjike lidhur me të si konceptim i përgjithshëm shkencor dhe njohjet e detajuara të së drejtës zakonore shqiptare si rast i veçantë i shoqërisë alpine-fisnore, por edhe dy fakte aspak pa rëndësi: faktin se autori i tekstit ndodhej në burg në Jugosllavi, e cila kishte interesa të drejtpërdrejtë për një pjesë të bashkësisë malsore shqiptare, me akuza të paformuluara në gjyq të natyrës politike, çka e ndërlikon pozitën e subjektësisë së tij, derisa po shprehej jo vetëm për çështje të Kanunit dhe të rendit shoqëror që mund t'i përgjigjej atij, po edhe pak më tej për çështje të *shtetësisë/pa-shtetësisë*, për raportet midis Shtetit dhe Lirisë, etj. Leximi i këtij teksti kërkon të mbahet parasysh gjendja e autorit në kohën kur po e hartonte, në mënyrë që të shquhet vendosmëria intelektuale e individit që mbrun në vete sigurinë e atillë që e bën të ta nyjëtojë mendimin deri në fund.

Nyjat që nuk shkuan në Sofje

Përmes veprave të botuara me të gjallë të tij pas LDB-së, S. Riza ishte identifikuar si filolog që ishte specializuar për tekstet e vjetra shqipe, për historinë e shqipes së shkruar, ashtu si një nga studiuesit më të rëndësishëm të morfologjisë së kësaj gjuhe. Paraqitjet e tij kritike të zhvillimeve në fushat e studimeve për shqipen dhe në mënyrë të veçantë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes së një gjuhe të vetme letrare (Riza (1944), f. 228, rimarrë pas një heshetjeje të gjatë te Riza (1996), monografitë e tij historike dhe bashkëkohore për përemrat dëftorë, për përemrat pronorë. Vepra e fundit ka përfshirë pjesë të pabotuara nga dorëshkrimi për aspektet historike të nyjave lidhur me studimet e mëhershme për to ashtu si një trajtim të gjerë për përdorimin e nyjave tek autorët e vjetër të shqipes), për sistemin rasor tani më njihen mjaft mirë nga studiuesit e fushës, edhe pse monografitë për sistemin foljor, për autorët e vjetër dhe monografia diakronike për nyjat që mundën të botoheshin vetëm pas vdekjes së tij.

Gjuhëtar me frymë heterodokse, antifashist dhe luftëtar për pavarësi dhe ribashkim të Kosovës me Shqipërinë gjatë LDB-së, që ndëshkuar nga regjimi Italian në Shqipëri dhe pastaj nga regjimet komuniste në Shqipëri dhe në Jugosllavi. Kaloi në burgje 1.5 vjet në Itali (1941-2), më se 3 vjet në Shqipëri (1945-1948) dhe më shumë se 3 vjet të tjera në Jugosllavi (1948-1951), dhe pas të gjithave 2.5 vjet internim në Shqipëri (1967-1970). Pasi u la i lirë nga internimi,

më në fund, nuk gëzoi të drejtën e botimit. Vitet e vetme të S. Rizës në të cilat ka pasur mundësi të merrej me studime për botim eventual pa pengesa të mëdha, pas shkollimit, mund të llogariten këto: 1936-1939 në Korçë, 1943-1945 në Kosovë, 1952-1955 në Prishtinë dhe 1956-1966 në Tiranë, gjithsejt 18, ndërsa të tjerat duhet të shihen si vite të një jete me vështirësi jo të vogla. Brenda asaj kohe ai ia kishte dalë të na linte gjithato vepra studimore.

Për Kongresin e studimeve të Europës Juglindore të Sofjes (1966) ku ishte parashikuar të merrte pjesë si anëtar i delegacionit të studiuesve nga Shqipëria, Riza kishte përgatitur studimin *Sur une concordance grammaticale spécifique de l'albanais avec le grec*, në 1-54 faqe, që u ruajt vetëm në dy-tri kopje. Në atë studim kritikohet qëndrimi sipas të cilit nyja shqese në shqipen është krijuar fillimisht në pozitë të prapavendosur. Ky diskutim mbi aspekte të ndryshme të të dy sintaksave të nyjës (të paravendosur dhe të prapavendosur) në gjuhën shqipe, ka filluar nga ideja e hershme e Dhimitër Kamardës lidhur me raportet midis shqipes dhe greqishtes. Në fund Riza shtronte një çështje shumë më të gjerë: "A nuk ka ardhur tashma koha për të reaguar energjikisht kundër mendimit tepër komod sipas të cilit teprimet aprioristike grecozuese të më se një shekulli të Kamardës do të kenë komprometuar për gjithnjë çdo rikonsiderim më adekuat të relcioneve strukturore pikërisht specifike të dy gjuhëve të vetme të gjalla indoeuropiane paleoballkanike?" (Riza (2009), *Vepra 5*, f. 547-563).

Versioni frëngjisht i këtij studimi përfshihet këtu (nga *Studime*, ASHAK 2004), ndërsa versioni shqip i rishikuar më 1977 u botua te S. Riza, *Vepra 4*. Nuk ka dyshim se refuzimi për botim në prapavijë kishte pikëpamjet kundërshtuese për versionin e tij të përgjithshëm për çështjen e nyjave në shqipen, ashtu si për konceptin funksional-semantik të shquarësisë, pra edhe të kolegëve.

Drejt gjuhësisë së përgjithshme dhe intelektualogjisë

Referimet e Rizës te dallimet e Ferdinand de Saussure-it midis *sinkronisë* dhe *diakronisë* më 1956, më vonë lidhur me teorinë e shenjës, flasin për një lexim jo-sipërfaqësor të teorive strukturale, gjithsesi të parakohshme në Prishtinë, e të pakohshme në Tiranë. Diskutimet teorike të Rizës të viteve 1955-1957 dhe zbatimi i rezultateve të tyre, qoftë dhe vetëm implicit, në veprat e tij për shqipen gjatë viteve 1958-1966 ashtu si teoria e tij për mbetjet shërbenin për të përthyer frymën e kohës, edhe pse jo plotësisht eksplicite. Diskutimet e atilla, po të ishin lejuar, mund ta çonin mendimin gjuhësor shqiptar në rrafsh të tjera. Sugjerimi i tij për të përfaqësuar në mënyrë binare të dhënat gjuhësore, edhe pse jo plotësisht eksplicite, mund të nxiste zhvillime. Të gjitha këto është dashur të përballeshin me

vërejtjet e kujdestarëve ideologjikë. Seminarët nuk u botuan me të gjallë të tij, ndërsa diskutimet për çështje të atilla nuk u dukën askund. Për këto çështje më gjerësisht të shihen ato që u referuan në fillim. Këtu po rimarrim vetëm një moment. Më 1966, në shqyrtimet e Institutit të Gjuhësisë, në kuadër të përgatitjeve për të hartuar gramatikën e re shkencore të shqipes, u diskutua një artikull i S. Rizës për pjesët e ligjëratës. Atje ai e refuzonte në mënyrë eksplicite konceptin e pretenduar marksist të pjesëve të ligjëratës: “*Për shkak të karakterit të tyre filozofik tepër të përgjithshëm përkth. universal tepër të pakufizuar, as kategoritë (konceptuale të materializmit dialektik: ‘lënda, ndërgjegjja, cilësia, sasia, kundërthënia, doemosdosia dhe rastësia, forma dhe përmbajtja etj’ nuk çfrytëzohen dot si bazë logjike për klasifikimin e fjalëvevet në pjesë të ligjëratës*” (Riza (2004), *Vepra*, 4:183). Si duket ky refuzim do të jetë interpretuar si provokim dhe do të ketë nxitur detyrimin e drejtuesit zyrtar të institutit ta mbronte marksizmin dhe detyrimin për ta zbatuar atë në gjuhësi.

Informim më specifik për interesimin e Rizës mbi çështje të gjuhësisë së përgjithshme mund të gjejmë në letrën e tij të vitit 1974 *Nga logjika dhe lingvistika te intelektuallogjia dhe komunikativistika*,³ ku shpjegonte se synonte që ta paraqiste me terma personalë konceptin e tij për dy disiplina komplementare (shkenca) mbi të menduarit dhe të komunikuarit e tij. Kjo do të thotë se ai dëshironte ta vështronte tërë procesin e të menduarit dhe të komunikuarit e tij si dy aspekte të varura nga vetë të menduarit si pikënisje. Më tej në letër ai shpjegonte se kishte për qëllim një vështrim kritik për logjikën e Aristotelit, duke shquar raportin e asaj kritike si ‘rindërtim të logjikës’ dhe duke vendosur njëherësh kritikën e tij për lingvistikën e Saussure-it.

Siç kemi shënuar më herët, Riza mendonte se përmes kritikës së themeleve të logjikës së Aristotelit ai po përpiquej ta shndërronte atë nga një disiplinë normative-preskriptive vetëm mbi të menduarit e rregullt, në një “*shkencë deskriptive-demonstrative të të menduarit në përgjithësi*”. Intelektologjia e tij do të ishte shkenca për intelektin apo mendjen, çka të çon larg përtej përpjekjeve thjesht lingvistike. Dhe për këto të shihen shënimet e referuara në fillim.

Sido që të jetë, nuk ka dyshim se diskutimet e Rizës për pjesët e ligjëratës dhe pikëpamjet e tij të përgjithshme për foljet e pak më pak për nyjat, ashtu si për tërë studimet albanistike, siç thoshte ai vetë, kishin zgjatur mjaft (1936-44, 1948-55, 1956-67 = 28), ka qenë vetëm një parantezë në përpjekjet e vazhdueshme si

³ Letër për R. Ismajli, botuar te *Fjala*, nr. 5, Prishtinë, 1974; shih Ismajli (1994).

metodolog dhe gnoseolog, apo me fjalë të tjera si studiues i filozofisë së shkencave, kështu që secila vepër e tij në albanistikë, e thoshte ai, karakterizohet nga aspirote për ta trajtuar subjektin konkret nga perspektiva e “*metodologjisë dhe gnoseologjisë sime*.”⁴

Por, le të rimarrim këtu vetëm një moment nga shqyrtimet për vizionin e Rizës dhe përpjekjet e tij metodologjike–gnoseologjike. Këtë e bëjmë për shkak se disa momente të tilla janë riprodhuar nga Fletoret në dorëshkrim si të shkëputura me këtë rast. Në të vërtetë, siç kishim konstatuar, nuk do të gjejmë diçka si traktat apo nyjetim të plotë të këtyre ideve në veprën e tij. Por ka të dhëna të shpërndara nëpër shënimet dhe në veprat e tij. Në projektin e tij “*Kurs i një filozofie heterodokse*” që në një moment mund të kishte ëndërruar të hartonte rreth viteve ’80, ai kishte vënë këtë nëntitull: *Nga logjika dhe linguistika te intelektuallogjia dhe komunikativistika*, ku *Intelektologjinë* e konceptonte si shkencë për intelektin (me një hyrje në psikologji), duke përfshirë diskutime të gjera për zbrazëtitë terminologjike lidhur me Saussure-in si semiolog-linguist, ashtu si dhe anekse kritike për *semiotikën* e *semantikën*, si dhe kapituj për *komunikativistikën* si teknika të shkencave të ndërmjetme midis ndërgjegjes dhe komunikimit, për të vazhduar me tri shkrime të përgjithshme për shkarjet e idealizmave dhe papërsosmëritë e materializmave, një hipotezë ontologjike dhe etikë prosopologjike brenda integritimit në moral, çka krejt së bashku shkon përtej dijes që mund të kemi si gjuhëtarë për to.

Pikënisja e tij ishte kjo: me reduktue veset e logjikës aristoteliane dhe të gjuhësisë së përgjithshme, në atë mënyrë që të dy disiplinat e ngushta të ishin në gjendje të integroheshin në bazë të një teorie të përgjithshme për metodologjinë shkencore: intelektuallogjia; gjuhësia në teknikën e komunikimit – *signoteknia*. Sipas S. Rizës, disiplina dhe shkencë të reja mund të krijohen nga mosgjëja në dy drejtime: përmes diferencimit të një shkence me objekt të gjerë studimi në dy a më shumë; ose përmes integritimit të një a më shumë shkencave të veçanta në një shkencë më të gjerë teorike. Ai vetë ishte në favor të qasjes së dytë, që do të thotë se logjika e Aristotelit duhej të transformohej nga një shkencë normative-preskriptive në një shkencë të përgjithshme përshkruese-shpjeguese për të menduarit. Prandaj donte ta theksonte faktin se ishte i pari që po paraqiste një shkencë për tërësinë e signifikimit dhe të të menduarit. S. Riza synonte ta implementonte projektin e tij për ri-vendosjen e disiplinave në kuadër të të cilave do të përfshihej studimi i gjuhës, duke bërë të mundur t’i rishënohej asaj disipline statusi nga “*gjysmë-shkencë post-biologjike*” në “*shkencë pre-*

⁴ Riza (2009a), p. 420.

gnoseologjike”, çka mund të shihet në skemën vijuese:

Psikologji	→ Psikologji
Logjikë	→ Intelektologji
Linguistikë	→ Komunikativistikë
Gjysmë-shkenca post-biologjike	→ Shkenca pregnoseologjike ⁵
Diçka më të saktësuar në formë traktati nuk kemi gjetur.	

Sido që të jetë, lidhur me intelektologjinë dhe komunikativistikën ashtu si i mendonte Riza, kemi pasur mundësi të shohim diçka në shënimet që po rimerren këtu dhe në ato që lidhen me konceptet e kritikuarra për pjesët e ligjëtratës në kuadër të studimeve gramatikore të shpërndara si teza. A ka qenë e mundshme që konceptet e Rizës të nxisnin krijimin e një teorie të re për prodhimin e diskursit, diçka si kritika e strukturalizmit në vitet '70, apo më tej në suaza të gjuhësisë kognitive? Është sfiduese të mendosh për këtë ide, qoftë edhe si intuitë, sidomos nëse marrim parasysh se nga fundi i jetës së tij Riza kishte shprehur ambicien e madhe për një projekt që mendonte se *nuk ishte vetëm ëndërrim*, por që sot mund ta vlerësojmë ndoshta *vetëm si ëndërrim*, sepse nuk kemi në dorë diçka më shumë: *“Themelimin nga një austriak, të “Psikanalizës” jo gjithandej së padiskutueshme ta pasojë themelvënia, prej një shqiptari, e një “Intelektanalize” më pak së kundërdëshmueshme, ja (jo ëndrra, por) projekti i fazës fundore së jetës sime”*.⁶ Ky shënim flet po ashtu se Riza në fazat e vona të jetës së tij kishte arritur në lexime të thelluara edhe të psikanlitikëve. Është për t'ardhur keq që tërë ajo dije mbeti pa u shënuar publikisht në refleksat e saj të një shqiptar i atij brezi.

Këtu, për ta pasqyruar në një mënyrë gjendjen në të cilën e kishte ndjerë veten ai, ta zëmë, në moshën 60-vjeçare, po mjaftohemi të sjellim një shënim të lënë në rendin 544. të Fletore I: *“Kur të jetë përshkuar njeriu nëpër një numër aq të madh rreziqesh aq të mëdhenj dhe provash aq të mëdha (siç je përshkuar ti), atëherë arritja – pa gjymtim të trupit, njiollosje të emrit dhe shterpëzim të mendjes – deri në moshën 60 vjeçare (që ke arritur ti), është një fat nga më të lakmueshmit për një emigrant jo-ekonomik (siç je ti).”*

Në fund le të themi se refleksionet e natyrës teorike të Rizës kanë mbetur të shpërndara dhe të fragmentuara në formë tezash dhe opinionesh qoftë të fshehura diku nëpër qoshet e shkrimeve të botuara, apo më shpesh nëpër fleta dorëshkrimesh të pabotuara, madje as të dërguara për botim, që nuk janë përmbledhur në një vend. Ai mbetet në gjuhësinë shqiptare linguisti (i përgjithshëm) në tentativë. Puna dhe fati i tij mund të ngrenë diskutime në të ardhmen. Fati dhe trajtimi i tij në momente të rëndësishme të jetës, ashtu si në zhvillimet intelektuale flasin

⁵ Riza (2009), p. 482.

⁶ Riza (2009a), p. 319.

krejtësisht deprimueshëm për trajtimin dhe qëndrimet tona ndaj mendjes dhe individëve vërtet të ndritur që ka falur natyra edhe midis nesh. Pas leximit të gjithë asaj që gjendet nëpër dosjet për të, ashtu si të të gjitha diskutimeve të tjera, më duket se shpjegime duhet të kërkojmë jo vetëm tek orientimi rrënjësor pro-ruso-sovjetik dhe kundër çdogjije që vinte nga Perëndimi, çka në dijet ishte instaluar menjëherë pas LDB-së, ndërsa në albanistikë kishte marrë impulse të fuqizuara rrënuese sidomos pas vitit 1956, por edhe te zakonet tona të rrafshimit me të tjerët të kokave që mund të ngrihen pak përmbi. Selman Riza në reflektimet e tij kishte lënë dhe një shënim ku regjonte se si e mendonte ai rrjedhën e dijes albanologjike-linguistike në të ardhmen e saj: në vlerësimet e tij (shih nr. 3772 të *Mendime*) “3772. *Gjuhësia shqiptare nuk mund të bëhet shkencë gjuhësore pa u pamvarësuar nga historicizmi hindo-evropianist si dhe nga konfuzionizëm-verbalizmi ruso-sovjetik*”, ose 3909. “*Karakterit sa kumulativ aq inkonkludues i gjuhësisë ruso-sovjetike mos po vazhdon së kundërshenjuari edhe tonën?*” Për ndikimin ruso-sovjetik në gjuhësinë shqiptare Riza kishte folur dhe në raste të tjera të mbetura dorëshkrim, sidomos lidhur me politikat e ndjekura lidhur me hartimin e fjalorëve.⁷ Mendimet e tij për historicizmin indoevropian mund të hetohen dhe në qëndrimet e tij konkrete për çështje të studimit të gjuhës.

Për të parë një vlerësim për idetë e Selman Rizës jashtë botës shqiptare në kohën kur u botuar vëllimi *Studime albanistike 1* në Prishtinë, po sjellim në vijim recensionin e Irena Sawicka-s të përkthyer shqip nga ajo vetë.

Me këtë vëllim përfundon seria e botimit Vepra të Selman Rizës.

⁷ Shih *Për lavrimin refleks të shqiptarishtes së mbasçlirimit*, dorëshkrim autograf, botuar te S. Riza: *Vepra 5*, ASHAK, Prishtinë 2009, ff. 137-165. Në këtë dorëshkrim ai fliste hapur për tendencën që përfaqësonte ai që mtonte të ishte “*albanist i epokës socialiste*”, A. Kostallari, i shkolluar në Rusi, e që qysh me kritikën e *Fjalorit* të vitit 1954, me pikësnyimet e parapërcaktuar normativo-letrar, teknikoshkencor dhe ideologjik të “*1. diskualifikimit, 2. të denigrimit dhe 3. komprometimit vete drejtfilli vetëm të fjalorit, por ama tërthorazi edhe të bashkautorëve, të cilët të shkolluar e të formuar për pafatësinë e tyre – kush në Itali (K. Cipo), kush në Austri (E. Çabej), kush në Hungari (A. Krajni), kush në Turqi (O. Myderrizi) e kush në Francë (M. Domi), e pra asnjëri në Bashkimin Sovjetik e rrjedhimisht kryekëput të iniciuar në 'leksikografinë më të përparuar në botë' alias në atë ruso-sovjetike*”, po instalohej një *'konfuzionizëm-verbalizëm ruso-sovjetik'*, pra me aspekte *'etiko-etnoideale'*. Në përpjekjet për të marrë vendime përkatëse lidhur me hartimin e fjalorit, madje vonë, Riza nuk e linte pa e vënë në pah *'ambicien për t'u afirmuar si i vetmi albanist i epokës socialiste'* të A. Kostallarit, i cili “*u vu fort kundër rrymës që miratoi Fjalorin: ai bazën dialektore (toske) së shqiptarishtes së mbasçlirimit e interpretonte në mënyrën vërtë më maksimaliste të mundshme e pra relativisht maksimaliste, përndryshe – përndryshe prevencionin antigeqë e kishte në përbrendësinë e lokalistit gjuhësor*”, aty, f. 150-151.

Kronologji e jetës së Selman Rizës

- 1909 Lindi më 25. 12. 1909 në Gjakovë.
- 1922 Kapërceu ilegalisht kufirin jugosllavo-shqiptar
- 1925 Mbaroi shkollën plotore gjashtëvjeçare në Tiranë
- 1931 Kreu për 6 vjet 9 klasat e Liceut Kombëtar në Korçë
- 1931-1932 Punoi si Sekretar i dytë i Seksionit fillor në Ministrinë e Arsimit të Shqipnisë
- 1932-1936 Mbaroi studimet universitare në Toulouse të Francës paralelisht për filologji gjermanike dhe për drejtësi
- 1936-1939 Profesor i frëngjishtes, shqipes, latinishtes e gjermanishtes në Liceun e Korçës
- 1939 Si antifashist e pjesëmarrës në manifestimet kundër pushtimit italian u largua nga Liceu i Korçës dhe u transferua në Gjinnazin e Tiranës
- 1940 Në muajin shkurt u internua në Ventotene të Italisë
- 1941 U lirua nga internimi në muajin tetor
Nuk pranoi të punonte profesor nën drejtimin e pushtetit kolaboracionist. Komisioni qeveritar ia mori të drejtën për të punuar në arsim.
Sekretar në firmën tregtare private “Kruja-Myshketa” në Durrës
- 1942 korrik, dhjetor 1943: përfaqësues juridik në gjyq në Prizren; veprimtar kundër rikthimit të dominimit jugosllav në Kosovë
- 1944 Bëri gati për botim veprn 200 faqesh *Dokumentar i kundërtezës shqiptare për çështjen kombëtare në Kosovë*; mbeti e pabotuar dhe dorëshkrimi nuk gjendet
Botoi *Tri monografina albanologjike*, Tiranë
Në korrik u largua për në Prizren
Në shtator e tërhoqi familjen nga Prizreni në Tiranë
Në dhjetor u kthye në Tiranë
- 1945 Në janar e arrestuan si “kosovar, irredentist, antijugosllav”; në prill me urdhër të K. Xoxes e nisën për Jugosllavi, por nga rruga e kthyen me urdhër të E. Hoxhës
- 1945-1948 Burg në Tiranë, pa vendim gjyqi; K. Xoxe më 1948 ua dorëzoi jugosllavëve
- 1948 (janar) – 1951 (gusht) burg në Prishtinë, pa vendim gjyqi as proces gjyqësor
- 1951-1953 Internim në Sarajevë, ku punoi si lektor i frëngjishtes në Universitet
- 1952 Botoi *Fillimet e gjuhësisë shqiptare dhe Gramatikë e serbokroatishtes* në Prishtinë
- 1953 Botoi *Diftorët e shqipes dhe historiat e tyre* në Prishtinë
- 1954-1955 Punues shkencor në Institutin albanologjik të Prishtinës
- 1955 Në dhjetor u ekstradua në Shqipëri
- 1958 Botoi monografinë për nyjat në Tiranë
- 1959 Kandidat i shkencave
Dorëzoi monografinë për pronorët e shqipes
- 1961 Mori gradën Profesor në Universitetin Shtetëror të Tiranës
- 1964 Dorëzoi disertacionin e doktoratës, por ndërkohë ndryshoi sistemi dhe nuk u bë mbrojtja
- 1965 Çmimi i Republikës për shkencë në Tiranë
Emrat në shqipe, tipet e lakimit
- 1967 U internua në berat për arsye ideore e politike
- 1970 U pensionua dhe u kthye në Tiranë, pa të drejtë botimi
- 1979 Në Prishtinë te Rilindja u botua përzgjedhja e veprave *Studime albanistike 1*
- 1988 Vdiq dhe u varros në Tiranë
- 1992 Medalja “*Mësues i popullit*” nga Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha
- 1993 Medalja “*Punonjësi i shquar i shkencës dhe teknikës*” nga Presidenti i Shqipërisë Sali Berisha
- 1994 Instituti i Gjuhësisë dhe i letërsisë i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë

- në Tiranë botoi *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore* të mbetur dorëshkrim na 1966
- 1996-2009 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës në Prishtinë botoi Vepra 1-5
- 2002 Shtëpia botuese Toena në Tiranë botoi Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe nga dorëshkrimi i vitit 1964
- 2005 Medalja e artë “*Lidhja e Prizrenit*” nga Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova
- 2009 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës shënoi 100-vjetorin e lindjes; u riatdhësuan mbetjet mortore të Selman Rizës në Gjakovë, u inaugurua busti i tij po në Gjakovë
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Qendra e Studimeve Albanologjike botoi *Vepra të zgjedhura të S. Rizës në një vëllim*
- Shtëpia botuese Dukagjini në Pejë botoi dorëshkrimin *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*

Bibliografi:

- Agalliu, Fatmir (1966): *Reçension rreth punimit të prof. S. Rizës “Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Tiranë, manuscript 3 p.
- Agalliu, Fatmir (1983): Sinkroni apo diakroni?, *Studime filologjike* 1/ 1983, Tiranë,
- Agalliu, F. (1995): Mbi disa ndihmesa të prof. Selman Rizës në përpunimin e teorisë gjuhësore të re, *Rilindja*, Tiranë, 1.9., p. 9.
- Agani, H.-Bokshi, B.-Ismajli, R. (1979): *Parathënie në Riza, Studime albanistike* I, Prishtinë.
- Ajeti, I. (1954): S. Riza, *Gramatika e serbokroatishtes, Jeta e ré*, Prishtinë, 5-6, 409-410.
- Angoni, Engjëll (1999): *Selman Riza – gjuhëtar dhe atdhetar i shquar*, Tiranë, 231.
- Arkivi i Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Punëve të Brendshme, Tiranë, D. NR- 5391-A, *Dosje përpunimi, Kategoria 2-B Nr. 2282*. Ismajli (209), 395-487.
- Bokshi, Besim (1980): *Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes*, ASHAK, Prishtinë.
- Bokshi, Besim (1986): *Prapavendosja e njëjës në gjuhët e Ballkanit*, Rilindja, Prishtinë.
- Camaj, Martin (1989): *Vdiq gjuhëtari Selman Riza, Dielli*, Boston, 28.4.1989.
- De Mauro, Tullio (1972) in F. De Saussure, *Cours de linguistique générale*, éd., Paris,
- De Saussure, F. (1977): *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Rilindja, Prishtinë; Dituria, Tiranë 2002, përkth. R. Ismajli.
- Demiraj, Shaban (1994): Për veprimtarinë shkencore të prof. Selman Rizës, *Gjuha jonë*, Tiranë, n. 1-4.
- Desnickaja, A.V. (1959): *Recension i disertacionit të shokut Selman Riza “Pronorët e shqipes”*, 6/XI/59, dsh.
- Dhirmo, Ali (1994): Heretiku i gjuhësisë shqiptare, *Rilindja*, Tiranë, 6.2., p. 9.
- Dhirmo, Ali (1999): Gjuha e Selman Rizës – pasqyrë e punës së tij për klasifikimin e normës letrare të shqipes, *Gjuha jonë*, Tiranë, nr. 3-4, p. 25-30.
- Dodi, Anastas (1991): Nderim për prof. Selman Rizën, *Mësuesi*, Tiranë, 27.7.1991, 2.
- Domi, Mahir (1989): Prof. Selman Riza – studiues i shquar i gjuhës shqipe, *Gjuha jonë*, Tiranë, nr. 2.
- Holenstein, Elmar (1974): *Jakobson*, Paris, pp. 36-61.
- Hysa, E. (2000): Selman Riza: *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, *Studime filologjike*, Tiranë, nr. 3-4, p. 181-187.
- Ismajli, R. (1991): Sur les contributions de Selman Riza, Selman: *Studia albanica*, Tiranë, nr. 1-2, 61-71.
- Ismajli, R. (1994): Rithemelimet e Selman Rizës, *Etni e modernitet*, Dukagjini, Pejë, 141-157.
- Ismajli, R. (2009): *Pasionet dhe pësimet e Selman Rizës*, ASHAK, Prishtinë, 506.
- Ismajli, R. (2009a): Amaneti i Selman Rizës, *Koha ditore*, 21 shkurt, p. 28-29.
- Meillet, Antoine (1921): *Linguistique historique et linguistique générale*, Paris.
- Pëmaska, R. (1965): Një atdhetar i flaktë dhe shkencëtar i madh jokonformist, *Illyria*, New-York, 29.6.-1.7., nr. 411, p. 14.
- Pëmaska, R. (1995a): *Selman Riza – patriot dhe shkencëtar i madh*, *Illyria*, New-York, 3-8.7, nr. 412.
- Raka, Fadil (1994): Rreth veprimtarisë së prof. Selman Rizës në fushën e shqipes letrare, *Gjurmime albanologjike, Seria shkencat filologjike*, 23-1993, Prishtinë, 43-63.
- Raka, F. (1996): Kritika gjuhësore në veprat e Selman Rizës, *Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Tiranë, 18-31.4., p. 214.
- Replika të S. Rizës nga diskutimet në Sektor lidhur me Referatin Mbi pjesët e ligjëratës*, dorëshkrim, por jo i daktilografuar, si thoshte Angoni, po vështirë i lexueshëm. Ruhet në arkivin personal.

- Riza, Selman (1944): *Tri monografina albanologjike*, Tiranë, sipas Riza, *Vepra I*, Prishtinë, 1996, 111.
- Riza, S. (1952): *Fillimet e gjuhësisë shqiptare*, Mustafa Bakija, Prishtinë, 126 pp.
- Riza, S. (1952a): *Gramatikë e sërbo-kroatishtes, 1. Fonetikë, 2. Morfologji*. Mustafa Bakija, Prishtinë.
- Riza, S. (1953): *Difiorët e shqipes dhe historiat i tyne*, Mustafa Bakija, Prishtinë.
- Riza, S. (1955): *Linguistika, filologjia dhe gramatika deskriptive, Përparimi*, Prishtinë, 1955, 1-2, p. 47-53.
- Riza, S. (1956): Një cikël seminaresh mbi problematikën metodike në gramatikën deskriptive, dorëshkrim nga vitit 1956, i botuar te *Vepra IV*, ASHAK, Prishtinë, f. 20.
- Riza, S. (1958): *Nyjat e shqipes (Punim përshkrues normativ)*, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore*, Tiranë, nr. 2, p. 3-72,
- Riza, S. (1958a): *Pronorët e shqipes* (Punim historik e kritik, kërkues e dokumentues), Autoreferat i disertacionit për marrjen e gradës shkencore “kandidat i shkencave filologjike”, botim i shaptilografuar i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, IGjL, Tiranë, p. 34;
- Riza, S. (1958b): Mbi vlerën fonetike të grafive buzukjane (sllave) dhe V (latine), *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore*, Tiranë, 1, 81-84.
- Riza, S. (1959): *Pronorët e shqipes (Punim historiko-kritik)*, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore*, Tiranë, 2, p. 43-103, 3, p. 3-35;
- Riza, S. (1959a): *Relacion i zgjeruar mbi ribotimin kritik të Gjon Buzukut nga Eqrem Çabej*, ms., cf. *Vepra I*, p. 491-529.
- Riza, S. (1960): *Pronorët e shqipes (Punim përshkrues normativ)*, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore*, Tiranë, nr. 3, p. 3-47;
- Riza, S. (1961): *Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, Krestoaci, thjeshtë gjuhësore*, UShT, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Katedra e gjuhës shqipe. Dispensë e shaptilografuar., 64 pp.
- Riza, S. (1962): *Disa teza mbi tre dorëshkrimet e Katekizmit të Matrëngës*, *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Seria shkencat shoqërore*, Tiranë, 1, f. 76-81;
- Riza, S. (1963): *Letër Drejtorisë lidhur me organizimin e diskutimit për Shtojcat*, 24. 6., ms..
- Riza, S. (1965): *Enrat në shqipe, Sistemi i rasave dhe tipet e lakimit* (Punim historik me dy shtojca kritike), UShT, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 151 pp.
- Riza, S. (1965a): *Kundërzetat e S. Rizës ndaj vërejtjeve të Komisionit të kumtesave për Kongresin e Sofjes*, Tiranë, më 7/ XII, f. 10, dorëshkrim i pabotuar.
- Riza, S. (1965a): *Thèses sur les trois manuscrits du Catéchisme de Lekë Matrënga*, *Studia albanica*, Tiranë, nr. 1, p. 125-130.
- Riza, S. (1965b): *Dy versionet e veprës së Pjetër Bogdanit, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike* (15-21 nëntor 1962), Tiranë, p. 278-286;
- Riza, S. (1978): *Vehëtësia dhe veprat e Pjetër Budit (1566-1622)*, *Gjurmime albanologjike, Seria e shkencave filologjike, VIII*, Prishtinë, p. 111-121;
- Riza, S. (1979): *Studime albanistike I*, Rilindja, Prishtinë, p. 478.
- Riza, S. (1983): *Nyjat e shqipes në tekstet e pesë autorëve tanë më të vjetër*, *Studime filologjike*, Tiranë, nr. 1, p. 21-53.
- Riza, S. (1985): *Probleme të njyave të shqipes, Gjurmime albanologjike, Seria e Shkencave filologjike*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, nr. 19, 33-54.
- Riza, S. (1991): *Historiku e kritika e trajtimeve të njyave të shqipes nga gramatikanët përshkrues, Studime filologjike*, Tiranë, nr. 3-4, p. 87-115.
- Riza, S. (1994): *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Akademia e Shkencave e R Sh, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 316.
- Riza, S. (1996): *Vepra 1*, ASHAK, Prishtinë, 566 pp.
- Riza, S. (1997): *Vepra 2*, ASHAK, Prishtinë, 596 p.
- Riza, S. (2002): *Vepra 3*, ASHAK, Prishtinë, 490 p.
- Riza, S. (2002a): *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 399 p.
- Riza, S. (2003): *Réfutation de la “théorie”, largement internationale, sur les cofonctions non-déterminatives de l’article determinatif, et rectification de la thèse de Dhimitër Kamarda sur la concordance de l’albanaise i e të avec le grece ho hë to*, *Studime*, ASHAK, Prishtinë, 10, pp. 37-56,
- Riza, S. (2004): *Vepra 4, ASHAK*, Prishtinë, 664 p.
- Riza, S. (2004a): *Mbi një bashpërkim gramatikor të posaçëm të gjuhës shqipe me greqishten në Vepra 4*, ASHAK, Prishtinë, p. 91-114.
- Riza, S. (2009): *Vepra 5, ASHAK*, Prishtinë, p.572.
- Riza, S. (2009a): *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme*, Dukagjini, Pejë, 608.

Riza, S. (dorëshkrim): *Qëndrimi i S. Rizës ndaj diskutimevet në Sektor mbi punimin "Nyjat e shqipes" paraqitur në cilësinë e disertacionit për doktorat, dorëshkrim.*

Sawicka, I. (1983): S. Riza, Studime albanistike 1, *Studia linguistica VIII*, Wrocław, 104-108.



Me të shoqen, Sabire



Me të ëmën, Zyla



Me të birin, Emin

IRENA SAWICKA: NJË GJUHËTAR SHQIPTAR QË MERITON TË MBAHET MEND

Botimi i vëllimit të parë të shkrimeve të zgjedhura të Selman Rizës duhet shënuar si një ngjarje e madhe.¹ Ai është një gjuhëtar shqiptar që meriton të mbahet mend për shumë arsye. *Studime albanistike* të tij u pritën në rrethin e albanologëve me gëzim dhe shpresë për një vazhdimësi. Selman Riza lindi në vitin 1909 në Gjakovë (Jugosllavi). Mori arsim filologjik dhe juridik. Ka studiuar në Tiranë dhe Korçë, si dhe në Francë e Austri. Fillimisht ka punuar si mësues në Korçë dhe Prizren, më pas si lektor i frëngjishtes në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Sarajevës dhe së fundi në Institutin Albanologjik në Prishtinë. Që nga viti 1955 jeton në Shqipëri, ku ka punuar si profesor ordinar në Fakultetin e Filologjisë dhe të Historisë në Universitetin e Tiranës dhe në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë po në Tiranë. Riza është laureat i çmimit shtetëror për arritje shkencore në fushën e gjuhësisë – ky çmim i ishte akorduar për disertacionin e tij mbi përemrat pronorë në shqip: *Pronorët e shqipes*. Ai tashmë është në pension, jeton në Tiranë dhe ka shumë vite që nuk ka botuar gjë, prandaj botimi i *Studime albanistike* meriton vëmendje të veçantë. Veprat e Rizës mahnitin me një mënyrë të menduari modern (sidomos në sfondin e arritjeve të deritanishme të gjuhësisë shqiptare) dhe në një masë të madhe paraqesin zgjidhje teorike të përshtatshme për gjuhësinë bashkëkohore.

Riza ka arritur një pozicion të përhershëm në Shqipëri. Ai kishte interesa të gjera dhe arriti rezultatet më të mira në fushën e morfologjisë historike. Ai është marrë edhe me aspektin teorik dhe metodologjik të gjuhësisë së përgjithshme. Studimet e tij kritike gjithashtu meritojnë vëmendje. S. Riza është autor edhe i gramatikës serbokroate, e cila i ka të gjitha tiparet e një përshkrimi kontrastiv: Gramatikë e sërbo-kroatishtes (Prishtinë 1952). Kjo pune u shfaq shumë vite përpara se të formuloheshin supozimet teorike të gramatikës kontrastive. Veprat më të rëndësishme të S. Rizës kanë të bëjnë me analizën gramatikore të teksteve më të vjetra shqipe, si tekstet e Buzukut, Matrangës, Budit, Bardhit, Bogdanit. Këto janë studime të detajuara filologjike mbi një sërë aspektesh: përshkrim dhe interpretim i grafive, përshkrim monografik i gjuhës së autorit, interpretime gramatikore, përfshirë edhe interferencat gjuhësore, ndërsa, para të gjithave, studimet e tij

¹ Selman Riza, *Studime albanistike*, Prishtinë 1979, f. 478. Botuar në *Acta Universitatis Wratislaviensis* No 645, *Studia Linguistica VIII*, Wrocław 1983, f. 104-108.

mbi zhvillimin e formave dhe të kuptimeve gramatikore karakterizohen me qasje sistemiko-funksionale. Riza e përshkruante gjuhën e një autori të caktuar në një qasje sinkronike dhe e krahasonte atë me sistemin bashkëkohor. Ai botoi gjithashtu një version popullor të krestomatisë të shqipes së vjetër.

Përsa i përket zhvillimit të formave morfologjike, studimet më të rëndësishme të S. Rizës kanë të bëjnë me sistemin e rasave, me nyjën dhe me përemrat. Askush përveç tij nuk e ka trajtuar këtë problem nga pikëpamja funksionale – përshkrimet e tij mahnitin me shkathtësinë e analizës dhe interpretimin modern; në aspektin teorik, Riza u modelua sipas veprave të A. Meillet.

Selman Riza, është gjithashtu autor i shumë artikujve mbi metodologjinë, gjuhësinë e përgjithshme dhe sociolinguistikën, si dhe i disa shkrimeve kritike. Veprat e këtij autori karakterizohen nga logjika, saktësia dhe qartësia e argumentit shkencor, por për lexuesin modern janë mjaft të vështira për t'u lexuar për shkak të gjuhës së vjetër dhe terminologjisë specifike. Botimet e tij më të rëndësishme, përveç monografive të ribotuara në Studime albanistike dhe *Gramatikën serbo-kroate*, janë: *Fillimet e gjuhësisë shqiptare* (Prishtinë 1952), *Pesë autoret ma të vjetër të gjuhës shqipe*, Tiranë 1960, *Tri monografina albanologjike*, Tiranë 1944.

Studime albanistike përfshinte kryesisht të gjitha disertacionet e tij për problemet e grupit nominal të shqipes. Libri përbëhet nga katër pjesë, secila prej të cilave, përveç të fundit, përfshin disa studime më të vogla për të njëjtën temë. Pjesa e parë, *Emrat në shqipe, sistemi i rasave dhe tipet e lakimit* (f. 1-149), shqyrton zhvillimin e sistemit të rasave, zhvillimin e formave dhe të funksioneve, si dhe përfshin një përshkrim të gjendjes moderne në këtë fushë. Këtu përfshihen edhe dy studime kritike mbi këtë temë. Pjesa e dytë, *Nyjat e shqipes* (f. 149-221), shqyrton zhvillimin historik dhe përdorimin bashkëkohor të nyjave në shqipën. Pjesa e tretë, *Pronorët e shqipes* (f. 221-419), u kushtohet përemrave pronorë në terma historikë dhe bashkëkohorë, dhe pjesa e katërt, *Diftorët e shqipes dhe historiat e tyre* (f. 419-419), i shqyrton përemrat dëftorë. Këto janë ribotime të veprave të Rizës nga vitet 1953-1965, përveç veprës diftorët që u botua si e veçantë në Prishtinë, janë botuar si të veçanta ose në *BUSH të Tiranës (Seria Shkencat Shoqërore)*.

Këtu më përfaqësuesi është studimi mbi nyjën i vitit 1958. Asnjë nga përshkrimet moderne shqiptare të kësaj teme nuk mund të barazohet me Rizën si në interpretimin e procesit historik ashtu edhe në funksionet bashkëkohore dhe në përdorimin e nyjës. Autori fillon me kategoritë semantike, bën dallimin midis denotacionit dhe designacionit dhe në fund vjen te eksponentët gjuhësorë të kuantifikimit të grupit nominal. Pra, ky është lloji i kërkimit që filloi të praktikohet në Europë në një shkallë më të madhe vetëm në vitet shtatëdhjetë të sh.

XX. Në gjuhësinë shqiptare prodhohen vetëm përshkrime, të cilat dalin nga forma morfologjike. As para e as pas Rizës, askush nuk e ka thyer këtë traditë.

Koncepti semantik i kategorisë së kuantifikimit (përcaktueshmërisë?), të paraqitur këtu nga Riza, *mutatis mutandis*, korrespondon me sistemet aktualisht të zbatuara në këtë fushë. Dallimet janë në thelb formale, terminologjike. Riza prezanton si klasifikim universal të emërtimeve në fjalë që denotojnë (*apellativa*) dhe fjalë që “relativisht designojnë” (*pronomina*), ai rezervon një vend të veçantë edhe për *nomina propria*. Faza e parë në procesin e derivacionit të një thënieje është “gjenerimi” - zgjedhja e përfaqësimit gjuhësor; faza tjetër është “individualizimi”, pra – zgjedhja e një elementi të grupit (SET-it, shih set theory). Gjenerimi është një procedurë universale, është një zgjedhje e apellativum-i, ndërsa individualizimi mund të ndodhë në mënyra të ndryshme, ai mund të ketë një eksponent gjuhësor ose jo, këtu ka dallime midis gjuhëve të ndryshme, por edhe brenda një gjuhe, varësisht nga konsituata, konteksti dhe nëse emërtimi bëhet përmes deiksit apo indirekt përmes anaforës. Pastaj Riza diskuton eksponentë të ndryshëm gjuhësorë të kuantifikimit - eksponentë morfologjikë, kryesisht përemra dhe nyja. Duke folur për funksionet kryesore të nyjës - edhe pse në parim përdorimi i nyjës së pashquar lidhet me funksionin gjenerik – megjithatë tërheq vëmendjen për funksionin e saj individualizues. Ai e quan atë përcakim të jo-plotë, që përcakton një element nga klasa e dhënë, i cili, megjithatë, është “absolutisht i pacaktuar” ose “i caktuar subjektivisht”, dmth. i caktuar vetëm për autorin e komunikimit (ose për dërguesin të mesazhit?). Individualizimi përmes nyjës së shquar është i plotë - tregon një element specifik të një grupi të dhënë. Rrjedhimisht, Riza dallon dy lloje të emërtimeve gjenerik: i përshtatshëm dhe i jo-përshtatshëm. Kemi të bëjmë me emërtimin gjenerik të përshtatshëm kur një abstrakt gjuhësor i përgjigjet një abstrakti real, dhe me emërtimin gjenerik jo-të përshtatshëm, kur, sipas Rizës, në të vërtetë, nuk është fjala për një përfaqësues specifik e të detajuar të një klase të dhënë, por përfaqësimi gjuhësor ka karakter individual. Kështu, megjithë dallimet e kuptueshme terminologjike dhe disa ngathtësi në formulimin e teorisë, koncepti i kuantifikimit nominal i Rizës korrespondon në masë të madhe me modelet e përdorura sot, të cilat gjithashtu detajojnë emërtimin gjenerik dhe kuantifikimin e detajuar (dmth përcaktimin e një elementi të një grupi) dhe, brenda këtij të fundit, përcaktueshmërinë dhe papërcaktueshmërinë.

Më pas Riza vazhdon ta vendosë zhvillimin historik të nyjave shqipe. Diskutimi i tij shkon në tri drejtime: 1. dualizmi sintaksor i nyjës së shquar të shqipes (përdorimi “normal”, pas një emri, dhe përdorimi i paravendosur, para një mbiemri, si edhe rastet e përdorimit të mbijetuar të paravendosur me një emër), 2.

evolucioni fonetik, dhe 3. evolucioni funksional dhe ndryshimi i kategorisë morfologjike (zhvillimi nga përemrat dëftorë, përmes nyjës së paravendosur në nyjën e prapavendosur). Në ditët e sotme, shumica e përdorimeve të paravendosura të nyjës në shqipen, pra kryesisht para mbiemrit, janë semantikisht bosh, vlerë funksionale ka vetëm përdorimi i prapavendosur – pas emrit. Përdorimi i paravendosur i nyjave (përemrave) ka mbijetuar vetëm në shprehje të tipit të *mi vëllazën, të tu motra*, etj., këto përdorime janë shumë të rralla dhe i nënshtrohen një sërë kufizimesh, si formale ashtu edhe semantike. Përdorimet e paravendosura të përemrit të ruajtura sot janë vetëm një relike të një gjendjeje të mëparshme, kur ato kishin një funksion relativizues.

Zhvillimin e formave me nyjë Riza e diskuton në lidhje me zhvillimin e përemrave të sotëm dëftorë, të cilët janë etimologjikisht kompozita, të përbëra nga trajtat e vjetra dëftore. Nyjën e paravendosur Riza e përnxjerr (derivon) nga trajtat e rindërtuara të përemrave të vjetër dëftorë – kjo është rezultat i shpërbërjes (dez-integritit) fonetike dhe semantike. Kështu edhe nga përemrat e vjetër dëftorë ai rindërton trajtat e përemrave të sotëm pronorë, të cilët janë gjithashtu rezultat i aglutinimit të trajtave të vjetra dëftore dhe pronore. Në fund, Riza vazhdon të diskutojë format dhe përdorimin e nyjave të sotme. Ai i lidh ato në radhë të parë me kategorinë semantike të përcaktueshmërisë, duke i kushtuar vëmendje faktit, megjithatë, që kjo kategori nuk ka vetëm një eksponent morfologjik (nyjën), por që ajo komunikohet edhe nëpërmjet përemrave; ai terheq vëmendjen më tej mbi faktin që kjo kategori nuk merr gjithmonë eksponent morfologjik, dhe gjithashtu që disa përdorime të nyjave semantikisht janë bosh. Ai gjithashtu i diskuton të ashtuquajturat përcaktueshmëri subjektive dhe përdorimet e eksponentëve gjuhësorë të ndryshëm për të njëjtin lloj referimi përfshirë zgjedhjet e një nyjeje në varësi nga konteksti formal dhe semantik. Në fund, Riza diskuton përdorimin e nyjës vetëm me motivacion formal, veçanërisht rastet e përdorimit të nyjës së shquar në lidhje me kuptimin gjenerik (të përgjithshëm) dhe mundësinë e kuantifikimit formal të emrave të përveçëm (*nomina propria*), si dhe përdorime të tjera të tepërta të nyjës, p.sh. me mbiemrat. Për rastin e fundit, ai dallon tri funksione të nyjës: 1. Funksionin lidhës (*nyjë lidhëse*) - 2. tregues i numrit dhe i gjinisë, 3. funksionin derivativ (adjektivizimi i mbiemrave) - por në prani të treguesve të tjerë të këtyre funksioneve, çdo përdorim me mbiemër ai e konsideron të tepërt.

Riza diskuton këndvështrimet e shumicës së gjuhëtarëve shqiptarë që identifikojnë funksionin e nyjës së paravendosur me funksionin e të ashtuquajturit dëftorë (demonstrativunculum, që shfaqet në gjinore si element lidhës). Ai i vë në dukje dallimet thelbësore në përdorimin e të dyja këtyre formave, p.sh. mungesën e përkimit të dëftorëthit në numër dhe gjini me formën që del në gjinoren - përkimi ndodh midis dëftorëthit dhe fjalës, që përcaktohet kështu, sipas

mendimit të tij, këto nuk janë përdorime të paravendosura të kuazi-nyjës, gjë të cilën e tregon edhe trajta formale e kësaj kuazi-nyjeje; ai beson se kjo është një formë e veçantë dëftori, zhvillimi i së cilës lidhet me shfaqjen e trajtës së re të gjinores. Gjinatorja e re u formua ose si rezultat i pranisë së trajtave të dyfishta të përemrit dëftor, ose nyja e vogël është zhvilluar drejtpërdrejt nga trajtat e plota të përemrave vetorë të vetës së tretë, të cilat e kanë humbur funksionin e tyre dëftor, por e kanë ruajtur pajtimin formal me formën që përcaktohet duke përdorur gjinoren, dhe kështu ata janë bërë eksponentë të gjinores së re.

Kur flet për përdorimet e prapavendosura të nyjës së shquar, Riza i ndan ato në përdorime të motivuara semantikisht, sintaktikisht dhe formalisht (që lidhet kryesisht me një rasë specifike). Sa për këtë rastin e fundit, ai tërheq vëmendjen, që dukuria e nyjës është e obligueshme, ndërsa në rastin e motivacionit thjesht semantik, ekziston një opcionalitet i caktuar. Riza i shtjellon me hollësi rastet e lënies së eksponentit të referencës dhe rastet e paraqitjes së eksponentit kur referenca mungon. Për sa i përket përemrit të pashquar, ai e përshkruan përdorimin e trajtave njëjës dhe shumës veçmas, për shkak të zhvillimit të ndryshëm dhe përndarjes (distribucionit) së tyre moderne (në këtë aspekt gjuha shqipe sillet si gjuhë pa nyjë). Përdorimi i këtyre formave është kontekstual dhe korrespondon pak a shumë me përdorimin e përemrave të pashquar në gjuhë të tjera.

Lloji i prezentimit të paraqitur në studimin mbi nyjën është karakteristik për këtë autor - kjo është një përshkrim monografik i plotë i çështjes, duke marrë parasysh aspektin semantik dhe aspektin formal, si dhe zhvillimin historik brenda këtyre dy aspekteve. Sipas mendimit të recensentit, vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet atyre pjesëve të veprës në të cilat autori flet për zhvillimin e formave dhe të funksioneve individuale të nyjës, të cilat, për shkak edhe të kufizimit të hapësirës për një rivështrim, nuk mund të raportohen këtu (e njëjta gjë vlen edhe për pjesën e parë të librit, ku flitet për sistemin e rasave). Vlerë të madhe kanë edhe studimet kritike të Rizës mbi pikëpamjet e autorëve të ndryshëm për disa çështje të gramatikës historike të gjuhës shqipe. Në këtë aspekt monografia për përemrat pronorë (*Pronorët e shqipes*) është më përfaqësuese. Kjo monografi gjithashtu përmban një rishikim kritik të qëndrimeve mbi origjinën e këtyre formave. Korpusi kryesor i përemrave pronorë të vetës së parë dhe të dytë (*im, ime, jonë, jonë, yt, jotë, juaj*) është shpjeguar qartë – ato rrjedhin nga përemrat vetorë, origjina e përemrave të vetës së tretë gjithashtu nuk ngre asnjë dyshim. Paqartësia ka të bëjë me pjesën e parë të përemrave të vetës së parë dhe të dytë; ato fillojnë ose me një zanore ose me një zanore të prejotuar (j+zanorja), origjina e së cilës nuk dihet. Për këtë temë ka shumë pikëpamje, të cilat në mënyrë të thjeshtuar mund të grupohen në dy grupe: 1. pikëpamja për aglutininimin e morfemës së për-

emrit dëftor (P. Bopp) ose nyjës së paravendosur (Holger Pedersen) dhe këndvështrimi i dytë që sugjeron një protezë fonetike. Diskutimi i Rizës për këto pikëpamje ekzistuese është një shembull i një rindërtimi të shkëlqyer, të dokumentuar plotësisht. Në fund të fundit, Riza bën një argument bindës për origjinën e kësaj zanore misterioze; sipas tij ajo vjen nga forma gjinore/ dhanore e përemrit vetor, ndonëse ka disa dallime në derivacionin e trajtave individuale të përemrave vetorë (që ndër të tjera është shkaku i shfaqjes së pikëpamjeve të ndryshme për zhvillimin e përemrave pronorë). Ky fragment i morfologjisë historike të gjuhës shqipe është veçanërisht i ndërlikuar dhe raportimi i tij kërkon marrjen parasysh të kontekstit të gjerë të zhvillimit historik të trajtave të tjera përemërore. Riza diskuton në detaje gjenezën e secilës trajtë dhe përdorimin modern të përemrave pronorë. Ai trajton fonetikën, morfologjinë dhe ndarjen e këtyre trajtave, duke pasur parasysh edhe aspektin normativ, si dhe diskuton terminologjinë gramatikore që lidhet me këtë çështje. Vlen të përmendet veçanërisht pjesa e monografisë në të cilën autori shqyrton problemin e përndarjes (distribucionit) së përemrave pronorë në këndvështrimin historik. Në ditët e sotme, ata zakonisht shfaqen pas emrit dhe përdorimet e tyre të rralla të paravendosura janë rreptësisht të kufizuara si në aspektin semantik ashtu edhe në atë formal. Sintaksa e sotme prapavendosëse e mbiemrave është, sipas tij, efekti i përdorimit apozitiv dhe, rrjedhimisht, i substantivizimit. Pozita e nyjës, përemrit pronor dhe mbiemrit u ndryshua rreth shekulljve VIII/IX. Zhvillimi i ndryshëm i trajtave të vetës së parë dhe të dytë të përemrave pronorë, në krahasim me trajtat e vetës së tretë, pasqyron sot, ndër të tjera, përndarjen e tyre të ndryshme. Përemrat e vetës së parë dhe të dytë mund të ndeshen para emrit në një numër të kufizuar rastesh. Prandaj, Riza beson se në shqipen ekzistojnë dy sisteme sintaksore paralele në këtë drejtim: 1. sintaksa prapavendosëse dhe 2. Sistemi jo i plotë me sintaksën paravendosëse – rasti i fundit ka të bëjë vetëm me shfaqjen e përemrave pronorë me emrat që shprehin marrëdhënie inhereente, në radhë të parë farefisnore, dhe, për më tepër, kjo ka të bëjë vetëm me fjalë shqipe origjinale ose fjalë të huazuara më herët; sa u përket huazimeve më të reja turke përdoret vetëm sintaksa prapavendosëse.

Një vlerë shtesë e monografisë për përemrat pronorë është shtojca me shembuj të përdorimeve kontekstuale të këtyre trajtave nga tekstet më të vjetra shqipe (shek. XVI-XVII). Edhe pse libri i S. Rizës është veçanërisht i vështirë për t'u lexuar për shkak të gjuhës së tij të vështirë, drejtshkrimit të vjetër, si dhe terminologjisë së paarsimuar shkencore shqipe në fushën e sintaksës funksionale, rëndësia e tij për zhvillimin e gjuhësisë moderne shqiptare është e pamohueshme. Vlera e veprës së Rizës është veçanërisht e madhe në fushën e gramatikës historike dhe të zhvillimit të mendimit teorik. Interpretimet e tij sistematiko-funksionale janë përjashtim në sfondin e studimeve të mëparshme të problemeve të mëparshme të morfologjisë historike dhe moderne të gjuhës shqipe.

Selman Riza, i licencuar në drejtësi dhe filologji

MBI KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT DHE RENDIN
SHOQËROR QË I PËRGJIGJET

LETËR PËRCJELLËSE NË VEND TË HYRJES

Shok...

Një nga kolegët tuaj para disa muajsh më pat lutur të shkruaja – për interes të tij – diçka për Kanunin e Lekë Dukagjinit. Pranoj se në fillim i hyra punës me hezitim, por shumë shpejt ndjeva të hiqej çdo ndërdymje dhe të shtohesh një interesim gjithnjë e më i gjallë për gjithçka ndërlidhet me zakonet e malsorëve, saqë pa vonuar pashë që vrojtimet e mia mbi kanunin u zhvilluan deri në përmasat e një monografie të vërtetë – e cila, pos tjerash, më doli më parë e karakterit sociologjik sesa juridik. Në të vërtetë, kërkesat metodologjike më çuan përtej Kanunit të Lekës për të hulumtuar vetë thelbin e rendit shoqëror malsor-fisnor të cilit i përgjigjet. Megjithatë, i pakënaqur që këtë aspekt dytësor të temës sime ta studioj dhe ta interpretoj [në dritën e socializmit shkencor] sa më thellësisht që të jetë e mundshme, – u drejtova të sillja specificitetin e pareduktueshëm të rendit shoqëror te fiseve malsore dhe një vështrim vetjak për tërësinë e konceptit të shtetësisë dhe të përvojave, kështu që pastaj të zhvilloja gjithashtu teorinë e Marksit dhe të Leninit për shtetin për të dhënë një elaborim më të detajuar.

Gjithsesi, sapo hetoja se në këtë pikë po largohesha nga projektimi im modest nismëtar, në më shumë raste m'u desh jo vetëm të ripërkitja dhe më tej të mendoja vetë përmbajtjen e studimit tim, po edhe ta selitja me origjinalitet të dyfishuar paraqitjen e saj gjuhësore. Por, nëse tekstit të fillmë serbisht të këtij studimi i shtova dhe një përkthim në gjuhën frënge, këtë e bëra jo aq nga mangësitë e mia të njohjes së gjuhës suaj sesa nga konsiderata “intelektologjike” që me vetë faktin se është përthyer nëpër dy pasqyrime të ndryshme gjuhësore mendimi do të dalë më i qartësuar për vetë autorin – çka do t'i bëjë të mundur që ta përmirësojë ndjeshëm idenë e tij. Ndërkaq, studimi im u pasqyrua nëpër tri idioma të ndryshme, sepse e kam shkruar edhe përkthimin shqip.

Shok..., jam i lirë të ju bind se studimi im i pranishëm e vlen përprjekjen tuaj për t'ia paraqitur Akademisë së Shkencave të R.P.S. në Beograd. Ajo që më shtyn të ju lus më ngrohtësisht për këtë, pranoj se kjo nuk ka qenë vetëm dëshira e sinqertë për të ndihmuar për përparimin e teorisë së socializmit, po edhe shpresa e madhe që Akademia juaj do të mundet ndoshta të ndajë ndonjë shpërblim qoftë dhe të vogël monetar, për të cilin kam shumë nevojë.

Prishtinë, 17. IV. 1949

Me respekt

PËRMBAJTJA

- I Shënime për kanunin dhe për vehtjen e Lekë Dukagjinit
- II Pse karakterizimi sociologjik (i përgjithshëm) duhet t'i paraprijë hulumtimit (të veçantë) juridik
- III Rendi shoqëror malsor-fisnor – i pa-njësueshëm me asnjë prej pesë rendeve shoqërore të përgjithshme të vendosura nga socializmi shkencor
- IV Arsytet për të cilat janë lënë anash deri tash specifikat shoqërore të fiseve malsore dhe për dobinë që do të kishim nga theksimi i tyre
- V Transformimi i rregullt i komunizmit primitiv në shoqëri skllavopronare
- VI Transformimi i jashtëzakonshëm i komunitetit primitiv në fise malsore
- VII Federativiteti më konsekuentisht i realizuar – ja thelbi i fisit malsor. Vërejtje. Dy urdhëresa të Kanunit të Lekës
- VIII Meqenëse federativiteti malsor më vete është i paaftë që në çfarëdo shoqërie ta bëjë të disponueshëm aparatit shtetëror – cili është faktori tjetër që ia ka bërë të mundshme fisit malsor të mbijetonte pa një aparat shtetëror
- IX Çka mund të thotë e çka jo për një shoqëri mungesa e aparatit shtetëror
- X Çka mund të thotë e çka jo në fisin malsor mungesa e aparatit shtetëror
- XI Përrjashtueshmëria e ndërsjellë midis shtetit dhe lirisë
- XII Krahasim i pa-shtetësisë fisnore malsore me pa-shtetësinë komuniste. Vërejtje. Nuk duhet të indinjohemi me një krahasim të atillë
- XIII Kuptueshmëria konceptuale e shtetësisë në sociologjinë borgjeze ashtu si në socializmin shkencor mund të zbritet në të kuptuarit e qeverisjes. Prandaj pa-shtetësia e shoqërisë komuniste do të thotë vetëm pa-qeverisjen e saj
- XIV Pikëpamja jonë për vëllimin konceptual të shtetit si përbërës të rendit shoqëror plus çka e përmban. Katër pasojat kryesore të këtij vështrimi
- XV Edhe në komunizmin primitiv duhet të ketë mbijetuar një rend shoqëror që u shndërrua më në fund në pjesën e parë përbërëse të shtetit të pammë njësoj imperialist ashtu si kuazi-imperialist
- XVI Menjëherë pas formimit, shteti i pammë imperialist e pa pushtetin e vet të përkohshëm shoqëror të degjeneronte në qeveri të përhershme klasore, – gjë që nuk ndodhi me shtetin e pammë antiimperialist
- XVII Pse duhet të vendoset shtetësia primitive në shoqërinë komuniste
- XVIII Për çfarë motivesh dhe përmes çfarë mjetesh e reduktoi sociologjia borgjeze shtetësinë në qeverishmëri
- XIX Meqenëse themeluesit e marksizëm-leninizmit “qenë shtrënguar” ta përfshinin konceptin e shtetësisë në vëllimin që kishte në sociologjinë borgjeze – teoria e tyre për shtetin kështu të kishte të bënte jo me tërë shtetin po vetëm me pjesën e tij të dytë përbërëse madje me fazën dytësore të asaj pjese përkatësisht në qeverisjen e përhershme klasore të një shoqërie të ndarë në klasa
- XX Pikëpamja jonë për vëllimin konceptual të shtetit – elaborim më i detajuar i teorisë marksiste-leniniste për shtetin

MBI KANUNIN E LEKË DUKAGJINIT DHE RENDIN SHOQËROR QË I PËRGJIGJET

Kjo tërësi zakonesh quhet sipas emrit të Lekë Dukagjinit, i cili rreth mesit të shekullit XV ishte sundimtar jo vetëm i Dukagjinit po edhe i tërë krahinave të Gashit e Krasniqes, Gjakovës e Pejës,¹ dhe tek i cili Skënderbeu kishte një nga bashkëluftëtarët e tij më trima dhe këshilltarët më të urtë në luftërat kundër turqve.

I

Kanuni i Lekës apo Lekë Dukagjinit është tërësi e ligjeve të pashkruara civile, penale e kushtetuese, që deri vonë ishin ende në fuqi te të gjitha fiset malsore të Shqipërisë së Veriut.

Siç ka ndodhur dhe me sundimtarë të tjerë të shquar, sipas emrit të të cilëve janë quajtur përmbledhje të ngjashme kanunore: *Kanuni i Justinianit* në Perandorinë Bizantine, *Kanuni i Car Dushanit*, *Kanuni i Napoleonit* [“kodi” bashkëkohës civil frëng] – kuptohet që Lekë Dukagjini nuk ka qenë krijues i atij Kanuni në kuptimin e “shpikësit” të atyre zakoneve.

Traditat e lashta juridike të cilave u drejtoheshin malsorët shqiptarë në raportet midis tyre apo midis individëve dhe të jashtme apo midis fiseve – për shkak të vetë lashtësisë së tyre dhe sidomos për shkak të ekzistencës së një numri mjaft të madh fisesh pak a shumë të ndryshme duhej të paraqitnin disa vonesa lidhur me zhvillimin, sado i ngadalshëm që të jetë ai, edhe të rrethanave shoqërore dhe gjithashtu të shumë dallimeve të rëndësishme nga një fis te tjetri madje edhe nga një pleqnar² te tjetri brenda të njëjtit fis.

Në rrethana të këtilla roli i Lekë Dukagjinit lidhur me Kanunin, që mban emrin e tij,³ do të ketë qëndruar në të dhënë se ai, në saje edhe të pozitës politike si prijës i një numri të caktuar fisesh të fuqishme dhe në saje

¹ Kjo e shpjegon faktin se Malsorët tanë veriorë “*Metohinë*” edhe sot e gjithë ditën e quajnë “*Rrafshi i Dukagjinit*”.

² Në gjuhën shqipe “*me pleqnue*” do të thotë “*me gjyque*”, “*me nda drejtës*”.

³ Duhet të dihet se Kanuni i Lekës quhet edhe “*Kanun i Malevet*”.

të autoritetit të tij personal si njeri i urtë dhe njohës i mirë i dokeve e shprehive popullore dhe gjithsesi në bashkëpunim me pleqtë më të rëndësishëm nga ato fise, ia ka dalë që traditat fisnore juridike t'i sillte në harmoni me rrethanat bashkëkohëse shoqërore e sidomos të përkimet midis tyre dhe që në saje të të gjitha këtyre t'u jepte autoritetin dhe t'i promulgonte solemnisht.

Sa i përket vetë fjalës “*kanun*”, ajo vjen nga greqishtja e vjetër dhe domethënë “rregull”, “normë”, “ligj”. Malsorët shqiptarë do ta kenë huazuar përmes komunikimeve të tyre me predikuesit e krishterë përkatësisht nga kleri katolik. Vërtet, “e drejta kishtare”, që në fakt nuk paraqet gjë tjetër pos së drejtës së vjetër civile romake, të përshtatur për nevojat teologjike, edhe sot quhet e drejtë “kanonike”. Se “*kanuni*” i Lekës dhe “*kanoni*” kishtar, pos kësaj fjale, nuk kanë gjë të përbashkët, kjo kuptohet vetvetiu.

Me këtë rast, ndërkaq, do shënuar se, derisa hoxhallarët, edhe pse *Kanuni i Lekës* ishte në fuqi të të gjithë malsorët tanë myslimanë, kufizoheshin ta ushtronin në çështjet thjesht fetare dhe në propagimin e zbatimit të shariatit, përkundrazi kleri katolik i ka dhënë gjithnjë rëndësi të madhe këtij kanuni, jo vetëm me qëllimin fetar [duke interpretuar dhe përshtatur rregullat e pashkrara] që të ndikonin në të dhe përmes tij të bashkëfetarët, por edhe me një qëllim tjetër. Pikërisht me qëllimin politik që të gjitha prerogativat e tyre personale dhe pronësore të përfituara nga secili bajrak, përkatësisht secili fis, duke vepruar mu si shtete të vërteta të vogla, t'i shihnin të garantuara përmes konsakrimit të tyre të kanunit civil, penal e kushtetues të atyre bajrakëve, pikërisht në Kanunin e Lekës.¹ Dhe nuk ka gjë për t'u habitur që edhe përshkruesi dhe komentuesi më autoritativ i Kanunit të pashkruar të Lekës qe françeskani Àt Shtjefën Gjeçovi nga Janjeva e Kosovës.

¹ Sa i përket së paku këtij qëllimit të fundit nuk mund të kontestohet se e kanë arritur tërësisht.

Në të vërtetë: 1) vetë Kanuni i Lekës e mohon të drejtën e zbatimit në kishë, e cila e njëj vetëm juridiksionin e të parit të vet fetar, përkatësisht të ipeshkvit përkatës. Në rast të ngatërresës midis kishës dhe banorëve të parokisë, këta të fundit nuk kanë asfarë të drejte që mbi bazë të Kanunit të Lekës të ngrenë padi kundër kishës, por duhet të ushtrojnë ankesë para ipeshkvit, arbitrazhit të të cilit do t'i shtrohen edhe popullsia edhe kisha. 2) Derisa edhe vetë kryeparin e tërë fisit secili anëtar i fisit mund ta padisë para kuvendit të fisit, i cili ka tagër që në bazë të Kanunit ta gjykojë me gjobë, me djegie dhe shkatërrim të pronës së tij, me pushkatim dhe me përndjekje të të gjithë anëtarëve të shtëpisë së tij nga territori i fisit, përkundrazi personi parokial është i paprekshëm. Pa paragjykim të së drejtës së hakmarrjes private, vrasësi i personit parokial është në shënjestër të ndjekjes jo vetëm të tërë parokisë, po edhe të tërë bajrakut. 3) Ndodh shumë rrallë më parë përjashtimisht që parokiali të jetë i shtrënguar të betohet para kuvendit të fisit. Dhe nëse kjo ndodh, betimi që ai bën qoftë për shfaqësim të vetes apo si dëshmitar në një ngatërresë për të të huaj, vlen aq sa betimi i 24 dëshmitarëve laikë.

II

Thamë për Kanunin e Lekës se ai ka karakter të përgjithshëm juridik, përkatësisht se përfshin jo vetëm të drejtën civile, po edhe të drejtën penale e madje edhe kushtetuese. Para se të shqyrtohen në mënyrë të veçantë secila nga këto tri anë të Kanunit të Lekës, është e nevojshme të studiohet rendi shoqëror të cilit ai i përgjigjet. Me fjalë të tjera, është e nevojshme që paraprakisht të karakterizohen sociologjikisht fiset malsore të Shqipërisë së Veriut, duke i renditur në një prej pesë rندهve të përgjithshme shoqërore që ka vendosur socializmi shkencor dhe nëpër të cilat ka kaluar njerëzimi deri sot: 1) komuniteti primitiv, 2) shoqëria skllavopronare, 3) shoqëria feudale, 4) shoqëria qytetare-kapitaliste dhe 5) shoqëria socialiste. Precedenca e këtillë u bë domosdo evidentisht metodologjike qysh se materializmi historik përkatësisht socializmi shkencor ka dëshmuar pakontestueshëm se çelësi për ta kuptuar historinë e cilësdo shoqërie është pyetja e thjeshtë: *“kush punon dhe kush i përvetëson frytet e punës?”*, çka do të thotë se aspekti ekonomik i jetës shoqërore është edhe baza e të gjitha dukurive të tjera shoqërore. Në këtë kuptim thuhet se morali, feja, e drejta etj. formojnë vetëm superstrukturën e çdo shoqërie, bazën e së cilës e përbën ekonomiku.

Pra, duke qenë se as shoqëria socialiste si realizim i vetëdijshëm, racional, i planifikuar i socializmit shkencor, as shoqëria skllavopronare nuk mund të merren këtu asses në konsideratë, le ta shtrojmë menjëherë pyetjen: *“Cilit nga tri rendet e tjera shoqërore i përgjigjet Kanuni i Lekë Dukagjinit si superstrukturë e tij juridike?”*

III

Kur të kemi mësuar objektivisht se bashkësia fshatare me pronën e saj kolektive të tokave të punueshme për malsorët shqiptarë është fenomen i panjohur dhe kur, nga një aspekt subjektiv, do të kemi mësuar po ashtu, e *para*, se tek ata i zoti i shtëpisë, megjithëqë një shtëpi mund të përfshijë më shumë dhjetëshe anëtarësh, që ia detyrojnë dëgjueshmërinë formale të pakundërshtueshme, megjithatë është gjithsesi shumë larg, që, qoftë në raport me anëtarët e shtëpisë apo të mirat e shtëpisë, të ketë pushtet të pakufizuar të lashtoromakut “pater familias”, aq më pak të patriarkut të papërgjegjshëm të gjithpushtetshëm të bashkësisë primitive; *së dyti*, se ai, megjithëse në pozitën e tij arrin në cilësinë e prindit përkatësisht të afërmit më të vjetër nga

të gjithë anëtarët e shtëpisë, në një mënyrë ose në një tjetër do të jetë i detyruar që, në rast të drejtimit të padrejtë të anëtarëve përkatësisht të drejtimit të të mirave, që vendin e vet t'ia lërë ndonjë anëtarë më të ri, të cilin formalisht e cakton ai, por të cilin në të vërtetë do ta zgjedhin të gjithë anëtarët e tjerë, përkatësisht shumica syresh, dhe, *e treta*, se në kushte të tilla ky shef i bashkësisë së shtëpive në instancë të fundit nuk paraqet asgjë tjetër pos një drejtues të thjeshtë të të mirave të shtëpisë dhe drejtues të pranuar të anëtarëve të saj,¹ që, ashtu si ai vetë, sipas rregullave rreptësisht të caktuara, mund të kenë dhe ndonjë pronë personale dhe që, pos kësaj, kanë të drejtë këshilldhënieje për çdo çështje të një rëndësie të pazakonshme, madje edhe, në rast të mospajtimit të vazhdueshëm, me mundësinë e ndarjes nga bashkësia e shtëpisë [më parë do të thosha bashkësia familjare] për të themeluar votër të veçantë, kur të kemi mësuar gjithë sa u përmend më sipër, a nuk e shohim pastaj se rendi shoqëror i fiseve malsore të Shqipërisë së Veriut nuk mund të radhitet te bashkësia primitive e shoqërisë patriarkale?

Pastaj, kur të kemi mësuar se malsorët shqiptarë, megjithëse zakonisht njihnin një lloj protektorati të lehtë mbi ta të një perandorie, pushteti i drejt-përdrejtë i së cilës shtrihej mbi fushat e afërta e deri te rrëzat e maleve të tyre, – që ka ndodhur dhe ka bërë që ndonjë nga të parët e fiseve, në cilësinë e përfaqësuesit të malsorëve para syzerenit dhe në saje të pranimit të syzerenit të cilësisë së tillë të tyre, kanë arritur kështu në një pozitë kaq të shquar në raport me pozitën e të gjithë krerëve të tjerë fisnorë duke fituar dhe titullin e veçantë “sundimtar” përkatësisht “bajraktar”, – po them, kur të kemi marrë vesh se malsorët shqiptarë, përkundër gjithë kësaj, në strukturën politike-ekonomike të rendit të tyre të brendshëm shoqëror kurrë nuk kanë njohur diçka qoftë edhe larg të ngjashme me vasalitetin dhe robërinë (kmetstvo), – atëherë do të shohim po ashtu se rendi i tyre shoqëror nuk mundet assesi të shkrihet me feudalizmin?

¹ Nuk është pa interes të vërehet që ai drejton vetëm të mirat e pakonsumueshme dhe është drejtues i vetëm anëtarëve burra të bashkësisë shtëpiake, sepse drejtuese e të mirave të konsumueshme dhe drejtuese e anëtarëve femra të bashkësisë familjare është e zonja e shtëpisë, e cila mund edhe të mos jetë gruaja e tij, përkatësisht nëna, e që, përveç drejtimit të punëve të shtëpisë nga ana e grave, e ka për detyrë edhe të përgatisë dhe shpërndajë shujtat dhe të kujdeset për fëmijët nënat e të cilëve janë të zëna me punë, ndërsa ndaj vetë grave nuk guxon të sillat as me anim as në mënyrë despotike, po duhet të sillat si “*prima inter pares*”, përndryshe zotshpillëku i saj do të përfundonte shpejt.

Më në fund, kur të kemi mësuar se ndodh te malsorët shqiptarë që pabarazia ekonomike të shkojë nga pasuria e vërtetë te mjerimi i plotë, megjithatë kjo tek ata paraqet gjithsesi më parë rast sporadik sesa një fenomen të zakonshëm, e aq më pak rregull – çka mund të merret me mend fare lehtë sepse te ne pakësia dhe vogëlsia e sipërfaqeve të veçanta të punueshme e kanë bërë të pamundur përhapjen dhe përgjithësimin e praktikës shfrytëzuese të punës me mëditje dhe të punës përgjysmë – kur të kemi mësuar, pra, se dallimet pronësore, që tek ata gjithsesi ekzistojnë dhe janë larg së qeni të neglizhueshme, megjithatë nuk paraqesin diferencim të atillë ekonomik që do të mund dhe duhej ta sillte shoqërinë e tyre në rrafshin e një diferencimi me të vërtetë klasor, – atëherë do të kuptojmë se rendin e tyre shoqëror nuk guxojmë ta ngatërrojmë me kapitalizmin e tokave.

IV

Rendi shoqëror i fiseve malsore të Shqipërisë së Veriut, me specifikat e veta themelore, nuk mund të radhitet në asnjë prej shkallëve zhvillimore të shoqërisë njerëzore të vendosura nga socializmi shkencor. Shtrohet pyetja – athua themeluesit e marksizëm-leninizmit, të themi, me gabim nuk do ta kenë vërejtur rendin shoqëror që ne po e studiojmë këtu? – E vërtetë është e kundërta. Kuptohet, ata e kanë lënë anash qëllimshëm, e kanë përjashtuar me qëllim.

Themeluesit e socializmit shkencor me shkencat shoqërore nuk janë marrë për hirë të syve të tze të bukur, po për hir të dobisë së tyre. Në saje të njohjes së ligjësisë të zhvillimit shoqëror spontan ata në të vërtetë kanë dashur të ndërtojnë një teori të atillë me të cilën do të udhëhiqeshin me sukses në veprimtarinë e tyre në shoqërinë bashkëkohore me qëllim që ta nxirrnin nga spontaniteti i zvarritjes së ngadalshme dhe të rastit, përkatësisht të mundimshme dhe të pasigurt drejt shkallës vijuese të zhvillimit dhe t'i prinin fillimisht në ndërgjegjësim e pastaj edhe në realizim të transformimit sa më të shpejtë dhe më të sigurt, përkatësisht sa më të suksesshëm dhe të padhimbshëm të të prapambeturës në të përparuar dhe të përparuarës në më të përparuar.

Hulumtimet e shkencëtarëve socialistë prandaj është dashur t'u kush-tohen në tërësi pikërisht rreth të përgjithshme shoqërore që e kanë për-

fshirë fisin njerëzor në përmasa masive dhe zhvillimi përkatësisht transformimi i mëtejshëm i të cilit ka pasur rëndësi vendimtare. Vëmendja e themelesve të marksizëm-leninizmit, të këtyre njerëzve edhe të mendimit edhe të veprimit, që e kanë studiuar të kaluarën në funksion të së tashmes dhe të tashmen në perspektivën e së ardhmes, nuk ka mundur të mbahej për gjatë nga partikulariteti sociologjik i popullatave jo vetëm në numër relativisht pak të konsiderueshme, por edhe gati krejtësisht të izoluar në krahinat e tyre të largëta malore – siç ka qenë rasti i fiseve malsore të Shqipërisë Veriore, të Malit të Zi, të Vendeve Baske, të Tirolit, të Zvicrës, të Skocisë, etj.

Megjithatë, në gjendjen tonë aktuale të ideve dhe të gjërave, kur nga njëra anë socializmi qoftë si teori, është tashmë së paku në vija të trasha tërësisht i elaboruar, apo si praktikë po ashtu tashmë së paku në Bashkimin Sovjetik, tërësisht i realizuar, dhe që nga ana tjetër, fiset malsore të Shqipërisë Veriore etj. tashmë si të tilla kanë hyrë prej kohësh në rrugën e shuarjes – megjithatë, them, në gjendjen tonë aktuale të ideve dhe të gjërave a nuk do t'u përgjigjej që rendi shoqëror i këtyre fiseve të studiohej më në fund jo vetëm më vete e për vete, por po ashtu në vështrim të të gjitha përgjithësimve teorike, që do të mund të sillnin hulumtimet e tij?

Jemi të bindur se do t'u përgjigjej, sepse shohim se, pasi të jetë hulumtuar dhe interpretuar në mënyrë korrekte në dritën e marksizëm-leninizmit, rendi shoqëror i fisit malsor gjithsesi do të paraqiste interes vital për vetë shkencën socialiste. Studime dhe interpretime të tilla të një rendi të tillë shoqëror, përveç përparësive të tjera, do të siguronin konfirmimin brilant si të teorisë marksiste-leniniste për *Shtetin* përkatësisht për *pa-shtetësinë* e një shoqërie pa klasa, ashtu edhe për konceptin e Leninit për mundësinë e ekzistencës së një shoqërie progresive në rrethana të një rrethimi armiqësor retrograd. Ato studime do të rezultojnë jashtëzakonisht instruktive madje edhe për saktësimin e kushteve në të cilat do të ndodhte kalimi nga etapa e socializmit në atë të komunizmit, dmth. në thelb sërish në raport me problemin e Shtetit respektivisht të pa-shtetësisë komuniste.

V

Thamë tashmë se është e pamundshme që shoqërinë malsore-fisnore ta identifikojmë me bashkësinë primitive. Do të saktësojmë tani se midis

këtyre dy rendeve shoqërore – gjithsesi jo në linjën përgjithësisht revolucionare të transformimit shoqëror të njerëzimit, po gjithsesi përjashtimisht evolucionare të këtij transformimi – do të ketë pasur një raport zhvillimi shih madje të një lidhjeje bijërie. Shoqëria e fiseve malsore do të ketë lindur si një rast i veçantë në historinë e përplasjeve pak a shumë masive të popullatave të vjetra dhe prej atëherë do të jetë zhvilluar në pajtim me prejardhjen e vet me mbisundim revolucionar. E tëra apo një pjesë e një tërësie të bashkësive primitive, të lidhura midis tyre përmes prejardhjes së tyre dhe që përbëjnë atë që ne e shënojmë si grupim etnik, do të ketë mundur në fakt, përpara sprovave të pushtimit nga ana e një grupi të caktuar etnik të huaj, ta braktiste vendin e vet dhe të tërhiqej në ndonjë rajon tjetër që në çdo aspekt e bëjnë më pak të pushtueshme, duke e larguar kështu veten njësoj nga fati i skllëvëreve ashtu si i skllavëruesve, që kishte qenë fati i shumicës dërmuese të popullatave të vjetra, të cilat e kanë nënshtruar njëra tjetrën dhe rendi shoqëror prej komuniteti primitiv i të cilave për këtë shkak ishte transformuar në shoqëri skllavopronare. Do të shpjegohemi.

Grupimet e të afërtve me njëri tjetrin (limitrofe, fqinjësore) të bashkësive primitive, përveç diversitetit të tyre racial pak a shumë të theksuar, kanë dalluar nga njëri tjetri po ashtu nga aspekti i gjendjes së tyre materiale dmth njësoj nga aspekti i burimeve ekonomike të mjedisit të tyre gjeografik ashtu si nga aspekti i peshës numerike dhe i fuqisë fizike të pjesëtarëve të tyre – i vetmi mjet shpërthimi që kanë pasur në dispozicion për të përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Për arsye të ekzistencës së pabarazive të tilla grupimet etnike shpesh kanë ndërmarrë fushata pushtimi të njërit kundër tjetrit, – për çka është mirë të shënohet se, meqë të sulmuarit e parë zakonisht kanë kërkuar shpëtim për veten në ikje, për t’u shndërruar, pak më tej, në pushtues të rinj, kështu që agresioni i parë në këto rrethana i ka dhënë shkëndijën e tërë një vale pushtimesh midis popullatave limitrofe. Dhe rezultati i secilit prej këtyre pushtimeve, por sidomos i atij të fundit midis tyre ka qenë fillimisht ekstermini, ndërsa më vonë skllavërimi i grupimeve më të vogla, – gjë që shkaktoi ndarjen e parë të shoqërisë në klasa të skllëvërve dhe të pronarëve të skllëvërve (skllavopronarëve).

Të gjitha këto na i ka mësuar socializmi shkencor.

Megjithatë, një përjashtim nga rregulla e përgjithshme e këtij robërimi të ndërsjellë të popullatave të ndryshme, siç thamë më sipër, do të jetë formuar nga një pjesë e ndonjë grupimi etnik me mundësi mesatare, i cili – i

vendosur ta mbrojë lirinë, por i vetëdijshëm se qëndresa e tij në terma të gjatë do të rezultonte me mossakses – do ta ketë evituar njësoj fatin e skllavërisë së vet ashtu si të skllavërimit të tjetrit duke braktisur vendin e lindjes, me burime natyrore për jetë, por të privuar nga pozitat strategjike për mbrojtje në shumicën e rasteve [në shumicën e rasteve një fushë të plleshme] dhe duke u vendosur në ndonjë rajon tjetër gati krejtësisht të pabanuar, mangësitë ekonomike të të cilit do të kompensoheshin nga përparësitë strategjike [zona malore pak a shumë të skajuara] dhe prej nga me siguri do të mund të zmbropste çdo sulm të ri nga ana e agresorëve të huaj, rendi shoqëror i shoqërisë primitive i të cilëve do të jetë shndërruar ndërkohë në shoqëri skllavopronare përkatësisht feudale.

VI

Shtrohet pyetja: – Në kushtet e një rrethimi të tillë së pari skllavopronar, pastaj feudal, më në fund kapitalist, bashkësitë primitive të një grupimi të caktuar etnik, të cilat përjashtimisht i kanë shpëtuar fatit shoqëror të skllavërimit pasiv ashtu si aktiv, si do të zhvillohen më tej për t’u shndërruar përfundimisht në të tilla bashkësi fisesh malsore çfare kanë arritur deri në epokën tonë? Kallimi i tyre mbisundimisht evolucionist përkatësisht spontan nga rendi shoqëror i bashkësisë primitive në atë të fisit malsor do të ketë ndodhur përmes rrugës së çnyjtimit të një bashkësie të vetme primitive në dy, tri, e më shumë bashkësi të shtëpisë tërësisht të pavarura nga njëra tjetra. Në mënyrë sporadike, një çnyjtim i tillë do të ketë ndodhur pa dyshim në gjë të disa bashkësive primitive para shpërnguljes së tyre nga vendi i prejardhjes. Por vetëm pas imigrimit të tyre në rajonin malsor çnyjtimi i një bashkësie primitive të vetme në më shumë bashkësi të shtëpisë do të ketë gjetur kushte të qëndrueshme objektive e subjektive të përshtatshme për përgjithësimin dhe konsolidimin e tyre.

Përgjithësimi dhe konsolidimi në rajonin malsor i procesit të zbërthimit të një bashkësie unike primitive në më shumë bashkësi shtëpiake ndodh jo vetëm për shkak se pakësia dhe vogëlsia e burimeve kryesore të jetesës përkatësisht tokave të punueshme do ta ketë bërë të papërshtatshëm tubimin në të njëjtin vend të një grumbulli njerëzish, po edhe për faktin se rezistenca e deritashme ndaj tentativave për skllavërim nga ana e agresorëve të huaj dhe mundësia ende ekzistuese thuaja rreziku iminent nga një pushtim i ri nga ana e tyre – do ta kenë zhvilluar vetëdijen për veten e prej andej dëshirën për pavarësi personale nëse jo të të gjithë pjesëtarët-kushërinj të çdo bashkësie primitive së paku tek ata nga

ta që deri tash do të jenë më të shquar për guximin dhe zgjuarësinë e tyre. Prandaj kreu i vetëm i bashkësisë së deritashme, në pajtim me ndryshimin e madh të kushteve objektive dhe subjektive të ndodhura në jetën e këtyre njerëzve pas imigrimit të tyre në rajonin malsor, ose nuk do të donte¹ ose nuk do të mundej ta kundërshtonte vullnetin e disa pjesëtarëve-kushërinj të bashkësisë së tij për t'u pavarësuar nga ajo. Në rastin e kundërt, këta të fundit do ta shtynin efektin e qëllimit të tyre deri te rasti i parë i favorshëm.

Zbërthimi i një bashkësie primitive në më shumë bashkësi të shtëpisë do të ketë pasur dy pasojat kryesore vijuese:

1) shpërqëndrim i gjithpushtetshmërisë së kreut “primitiv” në një numër të caktuar krerësh të shtëpisë, që, megjithë mundësinë e mbijetesës së disa dallimeve honorifike, do të drejtonin kolegialisht, përkatësisht mbi bazë barazie, punët e përbashkëta të tërësisë së tyre shtëpiake (të fisit të tyre të rishtformuar malsor) dhe do ta përfaqësonin gjithashtu në raport me formacionet e tjera shoqërore analoge etj.;

2) reduktim paralel i pozitës së kreut të bashkësisë së shtëpisë në diçka të ngjashme me një përkujdesës për të mirat dhe një direktoriat (drejtorat) të anëtarëve punues të asaj bashkësie.

Para se të kalojmë në seksionin vijues të studimit, do ta theksonim nevojën e një dallimi, që tashmë e kemi lënë të parandjehet, të zbërthimit të një bashkësie primitive në më shumë njësi të “gjinisë” (progéniture), që është sigurisht e njohur dhe në gji të fisit jo-malsor apo të bashkësisë fshatare me pronë të përbashkët të tokës. Por kushtet e qëndrueshme që “njësi” të tilla *fisnore të kalonin në bashkësi të shtëpisë u krijuan vetëm pasi rendi shoqëror i komunitetit primitiv u transformua rregullisht në shoqëri skllavopronare dhe përjashtimisht në fis malsor.*

VII

Për ta karakterizuar më nga afër do të bëjmë dy vërejtje të tjera për shoqërinë e fisit malsor. *E para.* Megjithë pavarësinë e plotë ekonomike, secila

¹ Nëse krerët e kohëve të paqes që pak a shumë zakonisht janë sjellë me absolutizëm e madje edhe me despotizëm, krerët e kohërave të luftës apo të rrezikut nga lufta, për të cilët ka shumë rëndësi të mos tëhuajësohen për shkak të një egoizmi eksziv nga simpatitë e bashkëluftëtarëve të tyre, njerëz me temperament luftarak dhe me ndjenjë të rrëmbyeshme e të menjëhershme të hakmarrjes, janë përkundrazi shumë më të afërt me shpirtin e egalitaritetit, me një ndjenjë shoqërie (camaraderie) nëse jo ndaj të gjithë atyre, së paku ndaj më të merituarve përkatësisht më të frikshëmve midis tyre.

prej bashkësive të shtëpisë që kanë prejardhje nga e njëjta bashkësi primitive do ta ndjejë gjallërisht dhe do ta shfaqë efektivisht solidaritetin e vet me to ndaj dhe kundër bashkësive shtëpiake që vijnë nga një tjetër bashkësi primitive e të njëjtit grupim etnik. E vlen të theksohet se emërtimi *shoq* (lat. *socius*) te malsorët tanë rezervohet ekskluzivisht për ata që i përkasin të njëjtit fis. Përkërisht në këtë lloj patriotizmi tepër të ngushtë konsistonte baza kolektive psikike e formacionit të ri shoqëror – *fis malsor*. E dyta. Meqë asnjë bashkësi primitive nuk ka qenë plotësisht e izoluar, e ndarë nga të gjitha bashkësitë e tjera primitive, por ka pasur kontiguitet gjeografik dhe afinitet historik dhe prandaj lidhje territoriale e tradicionale me disa prej tyre, me të cilat do të ketë formuar pikërisht një grupim etnik – gjithashtu të gjitha fiset malsore të dala prej gjithë atyre bashkësive primitive të të njëjtit grupim etnik do të kenë formuar njërat me të tjerat një kompleks më të gjerë, por edhe më të shllirshëm, një lloj *fisi të fiseve** apo *bashkëfisni* (*tribu de tribus* apo *contribu*).¹ Prandaj në shoqërinë e fisit malsor, përveç solidaritetit midis bashkësive të të njëjtit fis ndaj dhe kundër të gjitha të tjerave ka ekzistuar edhe tradita e një aleance të përzetshme të të gjitha fiseve të të njëjtës “bashkëfisni”² ndaj dhe kundër rrethimit të tyre imperialist.

Nga gjithë çka u tha del se rendi shoqëror malsor-fisnor i tëri dhe gjithandej është përshkruar nga një frymë e gjithpranishme e *federativitetit*. Dhe vërtet, përveç konfederimit të fiseve përbërëse të një bashkëfisnie, a nuk e paraqet secili prej këtyre fiseve, vetë, një federatë tipike të një numri bashkësish shtëpiake (*domesques*) përmdryshe tërësisht të pavarura nga njëra tjetra? Por ka edhe më. Secila prej këtyre bashkësive të shtëpive (*domesques*, që mund të përfshijë më shumë dhjetëra pjesëtarësh dhe kreu i së cilës është vetëm konsignorator i të mirave dhe drejtues i anëtarëve-punues) a nuk mbështetet edhe ajo në bazën e paritetit federal të të gjithë kushërinjve të asociuar në gjirin e saj?

Se tërë ky paritet karakteristik i rendit shoqëror të fisit malsor, megjithë të tëra dallimet shpesh të konsiderueshme të gjendjes ekonomike dhe të fuqisë efektive midis bashkësive të veçanta shtëpiake të të njëjtit fis, kurrë nuk është reduktuar – siç ka qenë rasti me shoqërinë borgjeze-kapitaliste me

¹ Të gjithë termat e shënuar me asterisk janë neologjizma që më është dashur të farkoja vetë. Shih *domesque* që e kam farkuar me analogji me *grotesque*, *livresque*, *romanesque*, etj.

² Bashkëfisnia (*contribu*) duhet të konceptohet në shumicën e rasteve si një komb i vogël që më vonë do të bashkohet me banorët – njësoj etnikisht të afërt, më parë të skllavëruar si etnikisht më herët skllavërues – të rrethimit të tij për të formuar një komb të tërë, – regjimet qendëruese të të cilit nuk do të kenë qetësi derisa t'i kenë dhënë fund partikularizmit dhe autonomisë së tërë fisit malsor.

barazinë e saj politike të të gjithë qytetarëve pa dallim klase – në një fjalë të kotë, në një formulë të zbrazët, po efektivisht i është përgjigjur një realiteti shoqëror,¹ për këtë dëshmon pa dyshim një e dhënë unike por vendimtare – e dhëna e mos-ekzistencës në fisin e malsorëve të një aparati të shtetit.

VIII

Por, meqenëse federativiteti më vete nuk është në gjendje që në cilëndo shoqëri ta bëjë të disponueshëm aparatin e Shtetit – cili është faktori tjetër që ia ka bërë të mundur fisit malsor të mbijetonte pa një aparat të tillë?²

¹ Në këtë aspekt dy dispozita të Kanunit të Lekës janë posaçërisht karakteristike. Në rast të vrasjes Kanuni i Lekës ka fiksuar të njëjtën shumë, pa marrë parasysh të vrasin, sepse “*Në kandarin e tij çdo njeri peshon 400 dërhem*”.

Dispozita tjetër ka të bëjë me *ndoren*. Ai që me përgjegjësi të veten apo për solidaritet shtëpiak përkatësisht të kushërinisë me vrasësin ka rënë në gjak përkatësisht do t'i shtrohet hakmarrjes private nga ana e bashkësisë shtëpiake përkatësisht kushërinisë së personit të vrasarë, ai gjithnjë mund të gjejë strehë të përkohshme në të qenit mik apo thjesht vetëm shoqëruet rruge i një të treti. Ata që kanë të drejtë për hakmarrje private nuk do të munden ta dhunojnë jetën e përfituesit të një mbrojtjeje të atillë pa u bërë vetë ipso facto nga ana e tyre detorës të gjakut ndaj të tretit. Në fakt, duke mos e marrë parasysh *ndoren* e tij, ata do ta çnderonin rëndë, e çnderimi i rëndë është i barabartë me vrasje. Kjo e drejtë e strehimit, që është kryesorja ndër ato që hyjnë ndër beneficionet e përfaqësuesve të Shteteve të huaja, godinat e të cilave sipas një rregulli juridik publik ndërkombëtar hyjnë në sovranitetin jo të Shtetit mikpritës, po të Shteteve përkatëse – them pra kjo e drejtë e strehimit i përket cilitdo individ përkatësisht bashkësisë shtëpiake ndaj dhe kundër çdo individi tjetër përkatësisht bashkësisë shtëpiake qoftë të të njëtit fis apo të një fisi të huaj.

Por mund të ndodhë që tërë një fshat [që në shoqërinë e fisit malsor nuk duhet të konceptohet si ndonjë aglomerim i thjeshtë demografik, po më parë si organizim politik i mbyllur, përkatësisht si një hallkë e ndërmjetme midis bashkësisë shtëpiake dhe tërë fisit], apo tërë një fis, madje tërë një bashkëfisi të bjerë në hasmëri me dikë. Në atë rast është e vështirë të gjendet një person privat që t'ia jepte *ndoren* një “fajtori” në luftë me të gjithë nga koektivit. – Vështirë, por jo e pamundur.

Gjatë Lidhjes së Prizrenit 1879-81 Abdullah Dreni në kullën e tij në Gjakovë i kishte ofruar mikpritje Mehmet Ali Pashës hungarez që ishte dërguar nga Stambolli me mision që t'i bindte shqiptarët se duhej që, në pajtim me vendimet e Kongresit të Berlinit, malaziasve t'u cedohet Plava e Gusia – çka gjithsesi kishte bërë që mbi të të binte urrejtja vrasëse nga ana e qytetarëve dhe e malsorëve, që duke e pas rrethuar në kullë kishin kërkuar nga A. D. që t'ua jepte të gjallë apo të vdekur emisarin e Sulltanit. A. D. nuk kishte dashur të dëgjonte as për përpjekjet e pajtimit të parisë së qytetit dhe të bajraktarëve malsorë, të cilët, të vetëdijshëm për angazhimin e tij të nderit dhe për të drejtën për të mbrojtur përkohësisht mikun e tij, i kishin ofruar që mund ta përcillte pa pasoja për të jashtë Gjakovës drejt Prizrenit. – Kokëfortësia e Abdullah Drenit solli një betejë të vërtetë e të tmerrshme ku gjetën vdekjen, pos tij dhe pashait turk, qindra njerëz.

² Por meqë federativiteti më vete është i paaftë që në cilëndo shoqëri aparatin shtetëror ta bëjë të vlefshëm, – ç'është ajo tjetra që ia ka bërë të mundur shoqërisë fisnore malsore mosekzistencën e aparatit shtetëror, përkt. e ka penguar tek ajo lindjen e këtij aparati?, sipas versionit serbisht.

– kjo ka qenë pikërisht *modus vivendi* i përhershëm i vendosur midis shoqërisë fisnore të maleve dhe rrethimit imperialist.

Pas gjithë armiqësive të tyre pa rezultat, por jo pa dëme në fillim, malsorët tanë dhe rrethuesit e tyre në fakt u detyruan të jetonin në paqe njërët pranë të tjerëve megjithë kundërvënien e vazhdueshme të interesave të çdo lloji dhe për shkak të kësaj së vërtete evidente që bashkon vetëpërmbajtjen nga njëra palë dhe nga tjetra dhe tolerancën e ndërsjellë, që gjithsesi paraqesin të keqe më të vogël sesa konflikti i përjetshëm. Siç kemi thënë tashmë me një rast tjetër, njai *modus vivendus* zakonisht konsistonte në këtë që fiset malsore të merrnin përsipër të njihnin syzerenitetin e një Shteti të madh, pushteti i drejt-përdrejtë i të cilit kishte depërtuar deri te këmbët e rajonit të tyre malsor, – çka në shoqërinë e fisit malsor krijon hapësirë për një shkallë të caktuar komunikimi midis banorëve të fiseve dhe banorëve të jo-fiseve dhe mundësoi infiltrimin të ndryshme në shoqërinë fisnore nga rrethimi jo-fisnor, por që ishte e pafuqishme për ta ndryshuar thelbin e saj prej shoqërie malsore fisnore.

Nga njëra anë, federalizmi eminentisht karakteristik i shoqërisë së fisit malsor, së pari me mos-ekzistencën midis këtyre bashkësive shtëpiake të një disnivelimi të tillë ekonomik që të mundej e të duhej ta çonte te një ndarje e vërtetë në klasa të ndryshme dhe, së dyti, me ekzistencën e një solidariteti të plotë ndër-shtëpiak (ndër-domestik) brenda të njëjtit fis dhe të një aleance të përhershme ndër-fisnore* në gji të bashkëfisnísë dhe nga ana tjetër *modus vivendus* me rrethimin e vet imperialist që shoqëria e fisit malsor ia ka siguruar vetes *së pari* në saje të mos-agresivitetit të vet, *së dyti* në saje të karakterit të vendosur të vetëmbrojtjes së vet, dhe *së treti* në saje të rrethanave natyrore të territorit të vet, përshtatshmëria strategjike e të cilit për mbrojtje do të ketë ndihmuar fuqishëm për ta bindur rrethimin imperialist të heqë të dorë nga çdo politikë agresioni në këtë rast të veçantë, dhe pakësia e burimeve ekonomike e të cilit nuk do ta ketë stimuluar në mënyrë të veçantë lakminë e një rrethimi të atillë – janë këto dy lloje faktorësh konvergjentë që ia kanë bërë të mundur shoqërisë në fjalë të mbijetonte pa një aparat Shteti përkatësisht që e kanë penguar tek ajo vendosjen e një aparati të atillë.

IX

Por çka paskësh qenë puna e njasaj mungese të një aparati të Shtetit në shoqërinë e fisit malsor? – Mungesa e aparatit të Shtetit në shoqërinë malsore

të fisit përkatësisht të bashkëfisnisë do të thoshte po ashtu mungesën e personit përkatësisht të personelit të *përhershëm* që do të kishte pushtetin diskret për të marrë vendime publike ashtu si të çdo force dhe mjetesh të *përhershme* në dispozicion për të siguruar ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre vendimeve. Mosekzistenca e ta e aparatit të Shtetit nuk do të thoshte assesi mungesën gjithashtu të rendit shoqëror përkatësisht të të drejtës dhe të moralit.

Ekzistenca e çfarëdo shoqërie parasupozon domosdo ekzistencën e një rendi shoqëror, i cili, nga ana e tij, është i pakonceptueshëm pa një të drejtë dhe pa një moral. Në të vërtetë, madje edhe në rastin e hipotezës më të mirë përkatësisht në rastin kur humori paqësor dhe vullneti i mirë¹ i të gjithë pjesëtarëve të shoqërisë nuk do të mohohej asnjëherë, megjithatë ata jo më pak shpesh do të ndodheshin në mosmarrëveshje dhe pra konteste, që do të duhej të zgjidheshin – çka nuk do të mund të bëhej ndryshe pos duke iu referuar rregullave të vendosura paraprakisht dhe të vlefshme për të gjithë [e drejta civile]. Përkundrazi, në rastin më të keq midis pjesëtarëve të së njëjtës shoqëri do të ndodhnin jo vetëm shkelje pak a shumë të rënda me paramendim, madje edhe mosmarrëveshje personale të dhunshme... deri edhe atentate ndaj jetës së njëri tjetrit – raste në të cilat do të duhej gjithashtu t'u referoheshin rregullave tashmë ekzistuese dhe të vlefshme për të gjithë për të ndërmarrë sanksionimin e keqbërjeve, përkatësisht zhdëmtimin e viktimave dhe ndëshkimin e kryesve të veprës, sepse siguria shoqërore do të ndodhej në kob të zi [e drejta penale].

Përveç këtyre dy rendeve të rasteve, të cilët, në çdo shoqëri e prandaj edhe në atë që mbahet pa një aparat të Shtetit, e bëjnë të domosdoshme ekzistencën e një të drejte të vendosur, ka dhe një rend të tretë rastesh që çon tek e njëjta domosdoshmëri. Konkretisht, rrjedha normale e jetës shoqërore që karakterizon mungesa e arsyeve të veçanta të preokupimit për fatin e vetë shoqërisë e që pjesëtarëve të saj u lejon që krye më vete të rregullojnë punët e veta, nganjëherë mund të jetë në situatë të ndërprerjes së papritur nga ndonjë ndodhi e që do të vinte në lojë këtë apo atë interes përkatësisht vetë ekzistencën e kësaj shoqërie, çka do të kërkonte domosdo bashkëpunimin e organizuar të të gjithë pjesëtarëve të saj. Ndërkaq, qoftë dhe një improvizim gjenial i for-

¹ Fakti apo cilësia e të qenit vullnetmirë, shih i bazuar.

mës së përgjithshme organizative nuk do të mund të vrente asnjëherë sa përgatitja e tyre me arsye modeste por me maturi të theksuar, apo fakti i ekzistencës së njerëzve të aftë për të drejtuar të tjerët do të bëhet realitet shoqëror veprues vetëm pasi që këta në cilësinë e tyre prej të drejtuarish do të kenë legjitimuar ata në cilësinë e tyre prej drejtuesish – dhe një akt ashtu eminentisht politik, në mënyrë që të jetë publikisht i shëndoshë, duhet të përmbushet në pajtim të plotë me parimet themelore dhe me procedura të formës para-prakisht të vendosura dhe të vlefshme për të gjithë [e drejta kushtetuese].

Nga konsideratat e përshtatshme për të dëshmuar se një rend shoqëror presupozon gjithnjë, përveç një të drejte gjithashtu edhe një moral, ne do të vëmë në pah vetëm dy vijueset. *E para*, e drejta themelohet në një moral, sepse, në gjenezën e saj, e drejta gjithmonë si pikënisje e ka pasur moralin e së drejtës, mund të thuhet, në pikë të fundit paraqet një lloj “kraft-extrakt” të moralit, – me çka duam të themi sa vijon: disa rekomandime morale, konkretisht ato që ndërgjegjja shoqërore e epokës do t’i ketë lejuar dhe përhapur në mënyrën më unanime dhe më të njëzëshme, pas saktësismit përkatësisht ngushtimit të kuptimit të tyre, do të shndërroheshin në po aq rregulla drejtësie, në po aq urdhra të përherëshëm të pushtetit publik, – që do të ndërmernte kundër-masa shtesë përkatësisht represive kundër çdo shkelësi të tyre, ndërkohë që shkelja e rekomandimeve morale, të pambuluara juridikisht, do të tërheqë mbi autorin e saj vetëm një mosaprovim nga ana e *opinionit publik*, vetëm një zhvlerësim në gjendjen e tij shoqërore. Megjithë këtë dallim thelbësor midis moralit dhe të drejtës, megjithatë mbetet e dhëna jo më pak e vërtetë se sikur të mos kishte moral, me këtë e drejta do të ndodhej e ndarë nga burimi i saj ushqimor.

E dyta, nëse kundër rrezikut për të qenë, në raportet e punës dhe të bashkëpunimit të tyre në përgjithësi, të mashtruar dhe të dëmtuar nga njëri tjetri, nuk do të ishin të mbrojtur nga asgjë tjetër pos nga një zbatim i detyruar shpesh inefikas dhe gjithnjë joekspeditiv i së drejtës detyruese, nëse në vend se, në çdo raport pune dhe bashkëpunimi në përgjithësi, të mbështeteshin në një minimum ndershmërie elementare të ndërsjellë, do të duhej të jetonin vazhdimisht në frikën nga *dol*-i famoz, njai kombinim perfid i së drejtës formale me padrejtësinë thelbësore, shkurt, nëse siguria aprioristike morale kundër çdo rreziku të madh do të binte në mundësinë pak a shumë problematike të një

reparacioni a posteriori të dëmeve tashmë të pësuar – atëherë, pashmangshëm, do të prevalonte paragjykimi më i pafavorshëm dhe madje neveria më e vendosur kundër çdo raporti pune dhe çdo bashkëpunimi në përgjithësi në kundërshtim të madh me interesin e gjithkujt dhe në kundërshtim me vetë arsyen e çdo bashkëjetese shoqërore, do të zbritej për këtë arsye në vëllimin madje të rregjuar në masën e hiçtë të minimumit të domosdoshëm.

Por, meqenëse, nga njëra anë, rendi shoqëror është i barasvlefshëm me binomin e drejtë plus moral dhe se, nga ana tjetër, vetë e drejta nuk është më shumë se moral i mbuluar juridikisht – në këto rrethana, moraliteti dhe socialiteti a nuk do të ishin një e tërë? – Sa na përket ne, jemi të bindur – bindje në të cilën na ka prurë pikëpamja vijuese për origjinën e moralit.

Procesi i moralizimit tim ka nisur me vetëdijësimin tim për një të vërtetë faktike: nëse do të shihja që ndaj të mive po ndodhnin inkonvenienca të mëdha madje rreziqe fatale, nëse ndaj të mive, bashkëshoqëruesve të mi, pjesëtarëve të kolektivit tim do të bëja po atë që bëj ndaj pjesëtarëve të një kolektivi të ndryshëm, të huaj, armik, përkatësisht pa asnjë konsideratë për nevojat e tyre dhe për asfarë mëshire për dobësitë e tyre. Mandej, vetë ky vetëdijësim do të ndodhë nga ana e tij vetëm me rastin e ndeshjes së parë qoftë me të huajt-armiqtë, qoftë me elementet kundërshtare me ç’rast do ta kem matur tërë distancën që ekziston midis... nesh... dhe tyre... Më tutje, ky vetëdijësim për këtë të vërtetë do të shkojë duke u mprehur dhe fuqizuar me nxitjen e burimeve të njëjta vetëm në favor të vetë këtyre rasteve. Më në fund, kur, nga njëra anë, të jem aftësuar për të kuptuar se, në përgjithësi, një e keqe më e vogël është një e mirë e vërtetë dhe, në veçanti, se përparësitë e jetës së përbashkët janë shumë më qenësore se sa disavantazhet dhe që për pasojë ekzistenca dhe mirëqenia e secilit prej të mive larg së përjashtuari apo vetëm së komprometuari ekzistencën dhe mirëqenien time, përkundrazi e favorizojnë dhe në pikë të fundit edhe e kushtëzojnë e që, nga ana tjetër, klithja sa e natyrshme dhe sa e lashtë: vae voli – mjerë për atë që në vuajtjet e gjallnimit, në luftën për jetë, do të gjendet pa ndihmë, pa përkrahjen e askujt! – dhe, kur, nga ana tjetër, them unë, kjo klithmë të ketë jehuar deri në shtresat më të thella të qenies sime më të drejtpërdrejtë, kur t’i ketë bërë të dridhen njësh të gjitha fijet e vitalitetit tim më pasionant – shkurt, kur bindja ime intelektuale se vullneti im për të jetuar mëvetësisht gjen arsyen e vet të mbarë në detyrimin e të qenit kolektiv të jetë më në fund siguruar pajtimi im emocional që të superohet individualizmi im

parësor, përkatësisht i përfshirë dhe i tejkaluar nga kolektivizmi im dytësor, edhe më shkurt, kur vetëdijësimi im (intelektologjik) i përmendur më sipër të jetë bërë “ndërgjegjja” ime (morale), atëherë tek unë do të ketë përfunduar në parim i tërë procesi moralizues.

Në këto rrethana, a nuk është më legjitime të pohojmë se moralizimi dhe socializimi në pikë të fundit janë një e tërë? – Vërtet, në fillim solidariteti i përmendur shoqëror do të vrente vetëm për kolektivin më të afërt, të themi, për familjen. Por në rrjedhën si të zhvillimit të njeriut si individ ashtu dhe të historisë së tërë njerëzimit, solidariteti i përmendur shoqëror ka shkuar dhe do të shkojë duke u përhapur gjithnjë e më shumë derisa ta përfshijë tërë njerëzimin të kuptuar jo vetëm në brezat bashkëkohës, por edhe në ato që do të vijnë. Pikërisht këtu ka qëndruar dhe do të qëndrojë progresi moral i njerëzimit.

Në dritën e gjithë asaj që u tha mbi lindjen e mundimshme, gjenezën antagoniste të moralit dhe për pasojë të shoqërisë, a nuk bëhet evidente që nga jo-shtetësia e një shoqërie ta deduktosh... vetë jo-socialitetin e saj – çka vjen me thanë se eliminimi në një shoqëri i çdo aparati të Shtetit të përherëshëm do të sillte ipso facto atë, nëse jo të çdo rendi shoqëror, së paku të çdo gjëje që do të jetë menduar për ta mbajtur përkatësisht për ta bërë të përparojë ai rend.

X

Thamë tashmë se mungesa në shoqërinë e fisit malsor e një aparati të përherëshëm të Shtetit nuk do të thoshte assesi mungesë po ashtu e një rendi shoqëror përkatësisht e një morali dhe e një të drejte. Le të studiojmë tani se si kjo shoqëri, gjithë duke mos pasur në përherëshmëri funksionarë dhe ushtarë, gjyqe e burgje, gjindarmë dhe xhelatë etj., megjithatë ia ka dalë ta ruante rendin e vet në përgjithësi dhe zbatimin e së drejtës të formuluar në Kanunin e Lekës në veçanti.

Ngatërresat civile gjykohen nga njerëz të mirë përkatësisht pleqnarë njohës të Kanunit që palët në konflikt i zgjedhin ad hoc (pra vetëm për konfestin e dhënë) dhe gjykimi i të cilëve, duke qenë ekzekutiv, zakonisht ekzekutohet realisht jo vetëm në saje të pengut që palët ia besojnë për këtë qëllim një të treti, i cili do t’i mbajë derisa të jetë përmbushur gjykimi, po edhe në saje të angazhimit të nderit që palët përkatësisht garantuesit e tyre përkatës

do t'i kenë marrë mbi vete për këtë shkak. – Nëse gjithsesi ai që pritet të veprojë nuk i shtrohet këtij formacioni vullnetmirë të raportit ndëshkues, thënë ndryshe nëse i akuzuari refuzon t'i japë pengjet dhe i ndan pleqnarët e tij, atëherë akuzuesi e ka mundësinë të paraqesë kundër tij ankesë para Kuvendit të bajrakut, i cili ose do ta rregullojë ngatërresën e tyre ose do t'ia imponojë të akuzuarit ta pranojë procesin në formën e parashikuar me Kanun.

Për çështje penale siç janë rrahja, plagosja, vrasja, çnderimi¹ Kanuni i Lekës i është përmbajtur ligjit të *talionit* (“krim për krim”), zbatimi i të cilit i lihet nismës së vetë viktimës. Kështu vrasja ose do të përfundojë me pajtim për një pagesë të një sasive parash (*wergeld*), që do t'i jepet bashkësisë shtëpiake të të dëmtuarit, shumata e të cilave është e njëjtë për të gjithë pa përjashtuar rastet e qenieve ende të palindura por tashmë të nxëna, ose me gjakmarrje private nga ana e kushërinjve pak a shumë të afërt të viktimës kundër jo vetëm vrasësit po edhe të gjithë meshkujve të rritur të familjes së tij. Dhe derisa kjo gjakmarrje, që përbën jo vetëm një të drejtë private por edhe një detyrim moral, nuk do të jetë përmbushur ende, vrasësi dhe prindërit (kushërinjtë) e tij solidarë do të jenë vazhdimisht në rrezik nga vdekja, përveç në ndërmjetëzat e shkurta në të cilat ata mund të përfitojnë qoftë nga një kohë që do të kenë marrë nga ana e atyre që kanë të drejtën e gjakmarrjes (besë), apo nga mbrojtja që do t'u jetë dhënë nga një i tretë (ndore).

Sa i përket së drejtës kushtetuese të përfshirë në Kanunin e Lekës, ajo ka një vështrim të dyfishtë: fisi si lidhje farefisnie (gjaku), në bazë të së cilës do të përcaktohen shkallët e solidaritetit midis pjesëtarëve të shoqërisë së fisit malsor dhe ngrihet ndalesa ndaj martesave “ndër vete”, dhe fisi si *organizim shoqëror*, në fakt, do të funksionojë vërtet vetëm përkohësisht, por që si kompleks formash, si kuti të zbrazëta, do të jetë i përhershëm për të siguruar vetë ekzistencën e një shoqërie, që assesi nuk ka qenë rezultat i ndonjë “vetëlindjeje” dhe që nuk mbahet nga ndonjë forcë inercie. Para se të shqyrtojmë fisin – organizim shoqëror, do të flasim për fisin – lidhje gjinie.

Pjesëtarët e një fisi nuk i lidh vetëm prejardhja e tyre nga një origjinë etnike, por edhe një raport i vërtetë farefisnie sa më i vonë aq më i ngushtë në

¹ I çnderuemi – derisa të mos jetë rehabilituar – mbahet i vdekun – kështu që nuk është çudi që çnderimi barazohet me vrasjen.

shkallën që çdo martesë midis tyre do të përbënte rast incesti dhe që, si e tillë, është rigorozisht e ndaluar nga Kanuni i Lekës. Por ja si shprehet vetë Kanuni lidhur me gjenealogjinë e fisit: “*Familjen e perbâjn gjindja e shpís; si të shtohen këta, dahren në vllazní, vllaznija në gjiní, gjinija në fise*”. Kjo do të thotë se, pasi pjesëtarët e një bashkësie shtëpiake të jenë shumë përtej çdo mase të përshtatshme për të jetuar nën të njëjtin kullm, ajo do të ndahet në një numër të caktuar shtëpish të reja, të cilat së bashku do të formonin një vllazní, e cila do të ketë dalë nga e njëjta votër. Me kohë, vetë këto bashkësi të reja do të ndahen, nga ana e tyre, secila në një numër të caktuar bashkësish edhe më të reja, përkatësisht të formojnë secila nga një vllazní të tërë, – me çka pjesëtarët e vllaznisë së deriatëhershme do të gjindeshin të larguar për një shkallë dhe vllaznia e tyre të shndërrohet në gjiní. Me përsëritjen vijuese të të njëjtit proces të çnyjëtimit brenda bashkësive më të vona, vllaznitë e deriatëhershme do të bëhen gjiní dhe gjinitë fise, – me çka fisi i deriatëherëshëm do të ndahet në dy a më shumë fise të reja.

Duke përcaktuar, si më sipër, raportet e gjinisë në gjirin e shoqërisë të fisit malsor, Kanuni i Lekës na ka bërë të mundur, të themi kështu, të jemi të pranishëm në aktin e lindjes së një fisi të ri. Prej kësaj del se fiset duhet të konceptohen si formacione shoqërore jo më të pandryshueshme, të dhëna një herë e përgjithmonë, po përkundrazi si krijesa shoqërore që siç mund të lindin mund edhe të shuhën posikurse të përtërihen.¹

Lidhur me fisin – organizim do të nisim me vrojtimit që vijojnë.

Ashtu si një bashkësi shtëpiake nuk është një grumbull i vogël i etër-

¹ Me vetë këtë shpërfaqet si e bazuar teza që Milan Šufflay e ka paraqitur në veprën e tij “Serbët dhe shqiptarët” dhe sipas së cilës fiset bashkëkohëse të Shqipërisë Veriore, larg së qeni trashëguese të drejtpërdrejta të fiseve ilire, përkundrazi, paraqesin vetëm formacione dytësore dhe madje edhe tretësore. Nuk ka dyshim se kur e kishte paraqitur këtë tezë, autori ynë e ka pasur parasysh dhe momentin politik të simbiozës, përkatësisht ‘osmozës diaetnike’*. Por edhe në këtë rast, teza e tij nuk mundet asesi të refutohet kaq lehtë, sa kanë përfytyruar se mundet bashkëpunëtorët e revistës *Leka* në botimin e tyre “Të drejtat e Shqipnisë etnike”, sepse historia e fiseve të përmendura nuk është kushtëzuar vetëm nga të dhënat gjenealogjike të fisit – lidhje gjaku, por edhe nga faktori politik i fisit – organizim shoqëror apo i bajrakut, i cili, siç do ta shohim, mund të jetë po ashtu plurifisnor*, përkatësisht të përfshijë pjesëtarë të dy a më shumë fiseve, – çka në zonat kufitare ka mundur të ndodhte fare mirë përmes shkrirjes së elementeve të ndryshme përnga prejardhja e tyre etnike, por identike përnga mënyra e tyre e jetesës, botëkuptimi i tyre dhe organizimi i tyre shoqëror. –

bijve dhe kushërinjve, po përbën një qelulë të organizuar, e cila e ka drejtuesin e vet në personën e kreut të shtëpisë; – dhe që “vllaznía” nuk është një turmë më e gjerë farefisnorësh pak a shumë të afërt, po përbën një grupim qelulash shtëpiake, të cilin e drejton këshilli i krerëve të atyre qelulave me në krye “kreun” të vllaznísë; – po ashtu fisi nuk është shumësi kushërinjsh të largët, po përbën një lidhje më të organizuar dhe më të karakterizuar grupimesh vllazniore, të cilin e drejton kuvendi i fisit, përkatësisht i të gjithë krerëve shtëpiake nën kryesinë e kreut të fisit dhe “të krerëve” të vllaznive.

Mirëpo, çdo tërësi e organizuar, përveç efektivave njerëzorë, presupozon gjithashtu një bazë territoriale. Ashtu siç nuk mund të ketë bashkësi shpiake pa një “kulm” të përbashkët, po ashtu nuk mund të ketë bashkësi fisnore pa një territor të përbashkët. Por, nëse zakonisht secili prej fiseve të ndryshme e ka territorin e tij, përkatësisht krahinën e tërësishme të veçantë, jo rrallë ndodh edhe ndryshe. Me fjalë të tjera, mund të ndodhë po ashtu që në të njëjtin territor të ketë bashkëjetesë të pjesëtarëve të dy a më shumë fiseve (pa e përmendur praninë e pakicës së anasve apo autoktonëve para-fisnorë) – ashtu si të një fisi të vetëm që mund të okupojë një rajon të tërë që përfshin sipas konfigurimit gjeografik dy territore të ndryshme, edhe pse në vazhdim me njëri tjetrin. Prej gjithë kësaj del se koncepti gjeografik i fisit – organizim shoqëror, të mos përputhet me konceptin shoqëror të fisit si organizim, që mund të përfshijë pjesëtarë të dy a më shumë fiseve apo edhe vetëm një pjesë të të gjithë pjesëtarëve të një fisi të vetëm dhe që për këtë shkak në Kanunin e Lekës mban emërtim të veçantë “bajrak”.¹

I njëjti parim, sipas të cilit çdo tërësi e organizuar përveç një kolektivi njerëzor ka domosdo edhe një bazë territoriale, e shpjegon po ashtu faktin se, derisa bashkësia shtëpiake përbën njësinë e parë, njësoj të fisit² si të bajrakut, përkundrazi vllaznía formon njësi të dytë të të njëjtit fis. Në të vërtetë, njësia e dytë e bajrakut formohet jo nga vllaznía po... nga katundi, banorët e

¹ Hartuesit e botimit “*Të drejtat e Shqipnís etnike*”, që e kemi konklutuar në mungesë të plotë të Kanunit të Lekës nga Shtjefën Gjeçovi, lidhur me citimet e tyre dhe interpretimet lidhur me atë tekst – kanë pohuar se bajraku paraqet “mbijetesë” të syzerenitetit turk. Ky pohim është thellësisht i gabuar, sepse, nëse “emri” *bajrak* është huazim, përkundrazi vetë gjëja – “organizim shoqëror në shoqërinë alpino-fisnore*” – është gjithsesi prodhim vendor.

² Prej tash ky term do të përdoret vetëm në kuptimin e fisit – lidhje gjaku.

të cilit u përkasin vllaznive të ndryshme dhe madje edhe “farefisnive” të ndryshme. Kjo provon se vllaznia përbën jo një njësi të vërtetë të organizimit shoqëror, po vetëm një shkallë konsanguiniteti. Pa dyshim “krerët” e vllaznive marrin pjesë në kryesinë e Kuvendit të Bajrakut. Por lidhur me këtë është mirë të bëhen dy vërejtje: në të vërtetë kryesia e Kuvendit të bajrakut nuk ka asesi pushtet politik, gjyqësor dhe administrativ, që i takojnë ekskluzivisht Kuvendit të përgjithshëm dhe, nga ana tjetër, përveç të parëve të vllaznive në këtë kryesi mund të ulen edhe krerë të zakonshëm të bashkësive shtëpiake, të shquar për urtësinë e tyre dhe për përvojën në shqyrtimet gjyqësore.

Se kryesia e Kuvendit, në thelb, është aty vetëm për të drejtuar diskutimin dhe kontestimet midis gjithatyre anëtarëve dhe prandaj reduktohet më parë në një zyre honorifike – për këtë, ndër të tjera, dëshmon fakti gjithashtu se të gjithë burrat e mbledhur në kuvend “i mbajnë me vete armët e tyre”.

Sipas natyrës dhe peshës së çështjeve për t’u shqyrtuar, përkatësisht për vendimet që duan marrë, do të mblidhet herë kuvendi i katundit, herë kuvendi i bajrakut. “Pleqtë” e katundit kanë tagër të thërrasin krerët e bashkësive shtëpiake, përkatësisht përfaqësuesit e tyre, por nuk përjashtohen as nga punët e përbashkëta as nga shërbimi ushtarak.¹ Të vetmet masa që mund të marrë kuvendi i katundit ndaj banorëve të tij janë gjoba dhe bojkotimi. Përkundrazi, kuvendi i bajrakut brenda kufijve të territorit të vet është kompetent të shqyrtojë dhe të marrë vendime për çështje politike, por po ashtu edhe të ndajë drejtësi dhe të shqiptojë verdikte që mund të shkojnë deri te ndëshkimi i fajtorit me pushkatim, te djegia me zjarr e pronës së tij, etj. Në rast të rrezikut publik, burrat e bajrakut mblidhen në kuvend për të lidhur besën jo vetëm midis tyre, por edhe me pjesëtarët e bajrakëve të tjerë për të lënë anash për një kohë të caktuar ushtrimin e çdo të drejte për hakmarrje private. Dhe kushdo që do ta thyejë këtë besë jo vetëm që e tërë gjinia e tij nga brezi në brez do të mbetet më e pafismja (ignoble) e bajrakut, por edhe prona e tij do të zhduket me zjarr dhe pjesëtarët e bashkësisë së tij shtëpiake do të jenë të dëbuar nga territori i bajrakut për 15 vjet.

Në vend të përfundimit mbi gjithë çka u tha më parë dhe para se të

¹ Pos atyre që nuk janë të aftë për shërbim ushtarak, të gjithë pjesëtarët e tjerë meshkuj të bajrakut janë të detyruar të armatosen me shpenzimet e tyre dhe t’i përgjigjen menjëherë çdo urdhëri për mobilizim të dhënë nga kuvendi i bajrakut.

parashtrijmë pikëpamjen tonë mbi moralin alpin-fisnor, nuk do të mundemi të mos e shtrojmë çështjen vijuese: një organizim i tillë i bajrakut, a nuk përbën një Shtet... pa aparat të përhershëm shtetëror, një tip Shteti karakteristik për shoqërinë e fisit malsor? – Në të mirë të përgjigjes sonë pohuese për një pyetje të tillë do të kushtohet i tërë zhvillimi i mëtejshëm i kësaj monografie, e cila Kanunin e Lekës dhe shoqërinë përkatëse i studion jo vetëm më vete dhe për vete, por gjithashtu në perspektivën e ndihmesës për një zgjidhje gjithnjë e më të kënaqshme përkatësisht më përfshirëse të problematikës së Shtetit në përgjithësi.

Lidhur me moralin fisnor malsor do të themi se dy janë tiparet e tij mbisunduese: pikërisht pohimi i jetës dhe pohimi i vetes. Ekzistenca tyre e vështirë u ka mësuar malsorëve që ta vlerësojnë lartësisht po aq jetën materiale sa edhe vlerën personale. Sëmundjet intelektive* dhe psikike të asketizmit dhe të servilizmit janë të panjohura për ta.

Me këtë personalizëm të malsorëve duket të jetë në kundërshtim tradicionalizmi i tyre. Në të vërtetë nuk është ashtu. Format tradicionale në shoqërinë e fiseve malsore kanë qenë ashtu të përhershme jo për shkak të ndonjë respekti frike për brezat suksesivë për lashtësinë e tyre, po sepse shpirti i lirë i brezave të rinj i ka gjetur të mbështetur në arsye, sepse ndjenja kritike e këtyre brezave nuk ka mundur të bëjë gjë kundër tyre. Shkurt, konservatizmi i tyre nuk mund të jetë përjashtues për progresizmin për njerëzit që urrejnë hiçin dhe adhurojnë jetën.¹

Merret vesh, një jetë që të jetë i lirë jo vetëm nga çdo shërbim i huaj, por edhe nga çdo zhvlerësim shoqëror. Në një shoqëri ku mungesa e aparatit të Shtetit dhe pamjaftueshmëria e burimeve jetësore e bëjnë sigurinë personale problematike dhe mbajtjen e shtëpisë të vështirë, nuk mund të ketë rrezik më të madh për ju vetë as për mirëqenien e shtëpisë suaj sesa po të vihet në dyshim vlera juaj dhe po iu ul besimi fjalës suaj.²

¹ Si prelude për çdo këngë kreshnike, ja sesi e shprehin ata përmes falënderimit për krijuesin gëzimim të tyre për jetën, fatlumësinë e tyre që janë gjallë:

*të lumit na i lumi Zot,
që s'kemi qenë ai na ka bërë.*

² Ky paragraf serbisht është formuluar si vijon: “Jeta, pra, jo vetëm e lirë nga të huajt, por edhe e respektuar nga të vetët. Në një shoqëri në të cilën – për shkak të mos-ekzistencës së një aparatit të përhershëm shtetëror dhe për shkak të pamjaftueshmërisë së burimeve

Këto të mira të domosdoshme shoqërore të prestigjit dhe të kreditit, njeriu i maleve nuk ka mundur t'i siguronte për veten ndryshe pos duke e nderuar me çdo çmim fjalën e vet dhe duke treguar se është i zoti të sakrifikojë të gjitha për të mbrojtur jo vetëm të drejtën po edhe dinjitetin e tij. Gjithashtu respekti për veten dhe besnikëria ndaj angazhimeve të veta, larg së paraqituri në shoqërinë fisnore malsore ndonjë stërhollim të moralit të lartë apo ndonjë kult të ndonjë uni romantik, përbëjnë vetëm cilësi të zakonshme që u përgjigjen nevojave elementare.

Përkundrazi, kur këto dy cilësi përndriten, të themi kështu, me një të tretë, atëherë kemi të bëjmë me tipin më të lartë të shoqërisë fisnore malsore, pra me *burr-in*; i denjë në raport me më të fortit se ai, i barabartë me të barabartit me të dhe... i mëshirshëm ndaj të dobëtve. “*Burrnía*” nuk ka të bëjë gjë me idealin e krishterë të altruizmit për altruizëm, me njatë mohim të vetes të zhveshur nga çdo kundërvlerë, duke shkuar krejtësisht kundër natyrës. Ajo do t'i ngjante më parë idealit njëherësh të burrnisë e të njerëzisë të Romës së lashtë republikane, përkatësisht idealit njëherësh të pohimit e të kufizimit të vetes.

Respektim rigoroz i vetes, besnikëri ndaj çdo sprove për angazhimet e marra, njerëzi – ja tre lajtmotivet e moralit heroik të shoqërisë fisnore malsore.

XI

Thamë tashmë se për barazinë reale, për pasojë për lirinë reale në shoqërinë fisnore malsore, dëshmon pa dyshim vetë fakti i mos-ekzistencës tek ajo të çdo aparati të Shtetit. Në të vërtetë, shteti dhe liria përjashtohen reciprokisht. Pos tjerash, ekzistenca në një shoqëri e një aparati është gjë kaq vendimtare për lirinë individuale të pjesëtarëve të asaj shoqërie, saqë thelbi i

jetësore – siguria personale është problematike, ndërsa mbajtja e shtëpisë së vet e vështirë; – në një shoqëri të atillë të jesh objekt përçmimi përkatësisht mosbesimi paraqet rrezikun më të madh personal përkatësisht kobin më të madh për shtëpinë. Por meqenëse të mirat shoqërore të vlerësimit personal dhe të kreditit nuk sigurohen ndryshe pos me mbrojtje me çdo flijim të së drejtës personale dhe të fytyrës dhe vetëm me mbjatjen me çfarëdo çmimi të fjalës së dhënë, besës së lidhur, – prej këndeje edhe del se te njerëzit malsorë-fisnorë respektimi i vetes dhe besnikëria ndaj detyrimeve të veta nuk paraqesin “luks” përkatësisht “delikatasa”, po detyrime të mirëfillta kështu që për ta paraqesin veçori të zakonshme.”

çdo kontraverze filozofike mbi përparësitë e individualizmit dhe papërshtatshmëritë e kolektivizmit dhe e kundërta reduktohet në çështjen e dëmshmërisë apo e dobisë nga Shteti.

Do të shikojmë shpejt e shpejt qëndrimet kryesore filozofike ndaj realitetit të Shtetit. Derisa filozofët reaksionarë apo pesimistë e kanë zmadhuar Shtetin si pjesë përbërëse të përhershme dhe të pamungueshme të çdo rendi shoqëror, shih madje të çdo qytetërimi njerëzor, përkundrazi të gjithë mendimtarët subjektivisht progresivë e kanë dënuar këtë Shtet për arsye kryesisht për parazitizmin e tij ekonomik ashtu si për favoritizmin, përkatësisht servilizmin ndaj kësaj apo asaj klase të shoqërisë dhe për iliberalizmin, shih madje despotizmin ndaj të tjerave.

Përnga qëndrimet e tyre të përgjithshme ideologjike, këta mendimtarë subjektivisht progresivë do të paraqitnin, u mor vesh, dallime thelbësore në dënimin e tyre të përbashkët të Shtetit. Ideologët anarkistë janë për likuidimin ekspeditiv të çdo aparati të Shtetit, të çdo pushteti politik. Liberalistët konsekuentë kërkojnë suprimimin e çdo kufiri ndërkombëtar dhe reduktimin e rolit të burrshtetasit në rolin e një vepruesi policesk, përkatësisht të një “prodhuesi” të sigurisë për personin dhe të mirat e individëve të bashkuar, që duhet të gëzojnë një liri të pakufizuar. Pozitë e ndërmjetme midis këtyre dy skajeve është mbajtur nga të gjithë ata që Shtetin e konsiderojnë si “një të keqe të domosdoshme” (pa pas saktësuar për kënd është posaçërisht e keqe) dhe ia njohin të drejtën e ekzistencës me kusht që të kufizohet në të gjitha mënyrët e mundshme ngushtimi i lirisë individuale.

Dobësia përkatësisht paqëndrueshmëria e këtyre pikëpamjeve të gjithë këtyre mendimtarëve të progresivitetit vetëm subjektiv mbi Shtetin nga kjo që ata e kishin konceptuar Shtetin sikur ai të mos ishte i kushtëzuar nga asgjë, sikur ai të përbënte një gjë metafizikisht absolute më vete, derisa në fakt ai është vetëm një pasojë, përkatësisht bashkëpërcjellëse (konkomitancë) e këtij apo atij rendi shoqëror historikisht të dhënë – zbulim për të cilin i detyrohemi marksizëm-leninizmit, i cili na ka treguar sesi Shteti në fakt është vetëm një prodhim i ndarjes së shoqërisë në klasa antagonistë, për çka ai qëndron vetëm në një organizim të klasës mbisunduese për të shfrytëzuar klasat e mbisunduara dhe për çka ai do të ekzistojë derisa të mos eliminohet ndarja e shoqërisë në klasa, me fjalë të tjera, derisa të mos jetë rivendosur shoqëria e dikurshme

pa klasa në një nivel superior dhe mbi një bazë më të gjerë; me fjalë të tjera, ende derisa të mos jetë realizuar shoqëria komuniste pa klasa... e cila – përveç shtrirjes, numrit të pjesëtarëve të saj, nivelit të kulturës së saj dhe përmasave të prosperitetit të saj – në jo pak gjëra do t’i përngjajë shoqërisë gjithashtu pa-shtetërore fisnore malsore.

XII

Vërtet, jo-shtetësia komuniste do të thoshte mungesën si të pushtet-
mbajtësve për llogari të klasës së tyre shoqërore dhe në dëm të klasave të
nënrenditura ashtu si në dëm të të përhershmeve e pra shpesh funksionarëve-
veprues formalë; por nuk do të thoshte assesi mungesën edhe të drejtuesve
teknikë të paprivilegjuar, përkatësisht që përmbushin funksione të ndrysh-
me, por me të drejta identike me punuesit e drejtuar. Por tashmë kemi parë
se në shoqërinë e fisit malsor kreu i shtëpisë, larg së pasuri një pushtet politik
për të përfituar prej tij personalisht, është vetëm bashkëdrejtues i të mirave
dhe drejtues teknik i pjesëtarëve punues të bashkësisë shtëpiake përkatësisht
të të vetmit prodhim të të mirave në kuadër të një kolektivi të familjarëve
shumë të afërt.

Vërtet, parimi komunist: “Nga çdokush – sipas aftësive të tij, secilit –
sipas nevojave të tij” në shoqërinë fisnore malsore gjen zbatim vetëm midis
pjesëtarëve të të njëjtës bashkësi shtëpiake, ndërkohë që midis bashkësive
shtëpiake të të njëjtit fis mbretëron një pavarësi e plotë ekonomike përkatë-
sisht regjimi i pronësisë ekskluzive. Por një parim i tillë, më saktësisht pjesa
e dytë e tij, nuk do të mund të gjente zbatim as në shoqërinë komuniste pava-
rësisht nga çdo përkatësi e individit në një kolektiv të caktuar.

Ideja sipas së cilës në bashkësinë komuniste do të sundojë begati e
atillë e çdo lloji të mirash, saçë askujt nuk do t’i shkonte ndër mend të pyeste:
Kujt i përket kjo? – reflekton, si duket, iluzionin e lashtë për vendin e dembe-
lëve, ku ka gjithë ç’ të duash. Sido që të jetë, ajo nuk ka asgjë të përbashkët
me socializmin shkencor, me të vërtetë, nëse është e vërtetë se ekonomia e
planifikuar e shoqërisë komuniste nuk do të prodhojë kurrë për të derdhur e
aq më pak për shpërdorim, është jo më pak e vërtetë se në cilëndo etapë të
shoqërisë socialiste llojet e ndryshme të të mirave, me vetë fuqinë e rretha-

nave, do të jenë ndonjëherë ashtu të bollshme. Më tej, pa-shtetësia komuniste do të thoshte, vërtet, mungesën e forcave dhe të mjeteve të disponueshme përhershëm për të detyruar vullnetin e tjetrit, por, përkundrazi, ajo nuk do të thoshte aspak mungesën po ashtu të normave juridike, të formave institucionale, përkatësisht të parimeve themelore dhe të procedurave (përherë të pranishme dhe të vlefshme për të gjithë) të destinuara për të zgjidhur çdo ngatërresë të paevitueshme civile midis pjesëtarëve të veçantë, përkatësisht njësisive kolektive të shoqërisë me qëllim që ta mbrojnë shoqërinë nga çdo befasi paralizuese në rast të shpërthimit* të një situatë kritike me kohë gjithashtu të paevitueshme. – Po ashtu pa-shtetësia e fisit malsor, larg së përyshuarit në parim – në thelb dhe për procedurë (gjithnjë e pranishme dhe valide për të gjithë), përkundrazi i presupozon në Kanunin e Lekës, i cili, gjithë duke mos qenë i shoqëruar nga organe të përhershme të sanksionimit, nuk është ndërkaq i privuar nga zbatimi efektiv.

Më në fund, shoqëria komuniste që do ta kishte bërë të mundur eliminimin e çdo klase shoqërore (dhe të çdo rrethimi armiqësor) e që për çdo pjesëtar do të siguronte shkallën më të lartë dhe masën më të madhe të lirisë, do të jetë e qëndrueshme vetëm nëse një liri e tillë individuale shoqërohet nga një vetëdije përkatëse kolektive. Por ne tashmë e dimë mirë se pavarësia absolute e bashkësive shtëpiake të të njëjtit fis nuk e përjashton, po përkundrazi e supozon solidaritetin e tyre të pakushtëzuar.¹

¹ Gjithsesi, një paralele e ngjashme midis shoqërisë fisnore malsore, prejardhja e së cilës ngjitet në një të shkuar të largët, dhe shoqërisë komunistike, realizimi i së cilës do të jetë i mundshëm vetëm në një të ardhme shumë të largët – na bën të zymtë dhe madje na revoltin, një reagim i atillë sentimental nga ana jonë duhet t'i imputohet jo vetëm idesë më parë absolutiste që do të kemi, po edhe për diçka tjetër. Konkretisht për shkak të tendencës sonë spekulative të nënvlerësimit të vështirësive kolosale që ndeshen gjatë transponimit të cilitdo rend shoqëror progresiv nga një kolektiv pjesëtarësh më të paktë në numër dhe të territorit me shtrirje të vogël (siç ka qenë rasti i fisit malsor) në një shoqëri me popullatë masive e me territor të pafund (siç do të jetë rasti i shoqërisë komuniste). Le të marrim, në fakt, në shoqërinë tonë bashkëkohëse rastin e rrallë madje eksepsional të një bashkësie “të lumtur” shtëpiake të katundit apo të rrethinave të qytetit të përbërë nga pjesëtarë-punues të shumtë dhe që jetojnë me kamje relative. A nuk paraqet ky rast i veçantë një analogji goditëse me shoqërinë komuniste? – Por le të provojmë ta përgjithësojmë ngapak konkretisht për kolektive gjithnjë më të gjera, përkatësisht me pjesëtarë simpatia e ndërsjellë midis të cilëve do të jetë gjithnjë e më pak e drejtpërdrejtë. Po t'u besohet disave, shoqëria komuniste do të përfaqësonte diçka mezi të konceptueshme si diçka gati të mbinatyrshme, diçka që njerëzimi ende asnjëherë nuk do ta ketë parandjerë as për së largu historikisht. Qëndrimi i tillë nuk dëshmohet vetëm jokritik

XIII

Pra, pa-shtetësia komuniste, ngjashëm me pa-shtetësinë fisnore mal-sore, do të thoshte thjesht eliminim të parazitizmit permanent të mbajtësve të pushtetit për vete përkatësisht për klasën e vet, ashtu si për funksionarët dhe agjentët e tyre. Por, kur të kemi mësuar se në shoqërinë komuniste “pa-shtetërore” do të mbijetonin patjetër, *e para* kompetencat e hierarkizuara teknike për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave, *e dyta* institucionet dhe mjetet juridike, që gjithë duke mos qenë të shoqëruara nga organe të përhershme të sanksionimit, megjithatë nuk do të jenë të privuara nga zbatimi efektiv dhe, e treta, forumi moral i vetëdijes kolektive, për të cilin mund të pohohet se asnjëherë nuk do të jetë një dhuratë e gatshme e natyrës njerëzore, por përkundrazi duhet të kultivohet në mënyrë të veçantë (por jo ekskluzivisht) te të gjithë brezat e rinj që do të vijnë; – kur të kemi, them unë, mësuar se në komunizëm do të mbijetojnë të gjitha këto fenomene dhe funksione kolektive, të cilat jo vetëm se gjinden në çdo shoqëri shtetërore, por edhe përbëjnë gjithashtu pjesë integrale pikërisht të Shtetit të asaj shoqërie, a nuk është më e saktë të flasim jo më për “pa-shtetësinë” e shoqërisë komuniste, po vetëm për mos-qeverisshmërinë e saj përkatësisht për mos-ekzistencën tek ajo të një aparati të përhershëm qeverisës?

Për kujdesin gjithnjë vëzhgues të njatyre kundërshtarëve të papajtuashëm me çdo lloj iluzioni shoqëror që ishin themeluesit e marksizëm-leninizmit, nuk ka mundur gjithsesi t’u shpëtonte pa vërejtur mirëthemelimi i një dallimi të tillë midis ‘pa-shtetësisë’ dhe pa-qeverisshmërisë. Por në kohën e tyre, periudhë heroike në historinë e socializmit shkencor, një dallim i tillë do të ketë qenë i padobishëm, thuaja madje i dëmshëm sepse atëherë fjala ishte për një luftë të përgjithshme kundër borgjezisë në tërësi, përkatësisht kundër

[përkthimi serbisht – *filozofikisht jokritik*]. Mund të na çojë madje deri te gërditja para realitetit shoqëror bashkëkohës. Qëndrimi i tillë është, pra, i rrezikshëm edhe nga aspekti shoqëror.

Madhërimi i një rendi shoqëror tashmë pak a shumë përcaktimisht të konceptuar por të konceptuar për t’u realizuar në një të ardhme pak a shumë të largët paralelisht me nënvlerësimin e progresit historik që ka realizuar deri tash njerëzimi, të arritur qoftë përmes rrugës së përgjithshme të revolucionit qoftë përjashtimit përmes evolucionit, – mund t’u krijojë hapësirë për të lindur jo më komunistëve autentikë, përkatësisht dialektikë, po më parë romantikëve të rinj të dëshpëruar nga jeta shoqërore bashkëkohëse dhe të çmësuar për të marrë pjesë në aktivitetin gjallërues publik për shkak, kësaj here, jo më të një të kaluarë të largët pa kthim, po më parë të një të ardhme – së paku për ata – të paarritshme.

Shtetit të saj të tërë dhe jo të hyhej në konsiderata jo vetëm joaktuale, por edhe të rrezikshme për dallimin midis shtetësisë dhe qeverisshmërisë.

Por në ditët tona, kur Bashkimi Sovjetik, megjithë kushtet e rrethimit kapitalist, ndodhet madje në prag të etapës komuniste, a nuk është e përshtatshme të ndërmerret, jo vetëm duke përfituar nga mësimet teorike dhe nga përvoja e realizuar prej atëherë, por edhe duke mbledhur këtej andej arritjet teorike mbi një domen jo mjaftueshëm të eksploruar nga socializmi shkencor dhe sidomos pasaktësisht të interpretuar nga sociologjia borgjeze e zhvillimit përjashtimor të shoqërisë njerëzore, – për të paraqitur një elaborim të mëtejme të çështjes së Shtetit përkatësisht të “pa-shtetësisë” komuniste.

Se është e përshtatshme jemi aq më shumë të bindur sepse kemi parasysh mundësinë që në gji të shoqërisë socialiste të manifestohet gjithnjë e më shumë një varietet politik i futurizmit, një tendencë për të koketuar me ideologjinë anarkiste nën egjiden e besnikërisë ndaj teorisë së Marxit dhe të Leninit mbi “pa-shtetësinë” e shoqërisë komuniste.

XIV

Tashmë kemi vërejtur se është legjitime të dallohet shtetësia nga qeverisshmëria. Dallimi teorik midis Shtetit dhe qeverisë, formë materije preliminare e mësimdhënies për të drejtën publike, dallimi i tyre praktik është diçka që ngjet zakonisht në jetën publike. – Dallimi ynë në thelbin e tij ashtu si në orientimin e tij kushtëzohet nga momente dhe pikëpamje krejtësisht të tjera. Në fakt, ne do të dallonim shtetin nga... Shteti. Nuk ka dyshim se të gjitha shtetet janë identike sipas njërit prej dy elementeve apo pjesëve të tyre përbërëse, përkatësisht sipas rendit shoqëror që duhet të mbahet. Sipas elementit tjetër, përkatësisht sipas atij që është i destinuar ta mbajë atë rend shoqëror, – Shtetet përkundrazi janë aq të ndryshme midis tyre sa që ndahen në dy forma të pareduktueshme në njëra tjetrën, që i bie:

- a) formë shtetërore me pushtet shoqëror të përkohshëm për të vendosur rendin shoqëror pas çdo dhunimi faktik, – që është rasti i shoqërisë pa klasa,
- b) formë shtetërore me qeveri të përhershme klasore për të parandaluar çdo dhunim eventual të rendit shoqëror – i tillë është rasti i shoqërive të ndara në klasa.

Nga një dallim i tillë i një forme shtetërore nga tjetra rezultojnë katër konsekuenca kryesore:

E para. Derisa në një shoqëri pa klasa rendi shoqëror mbijeton duke përdorur pushtetin e përkohshëm të shoqërisë në tërësi, përkundrazi, në një shoqëri të ndarë në klasa mbijeton duke përdorur qeverinë e përhershme të klasës sunduese.

E dyta. Derisa rendi shoqëror i një shoqërie pa klasa paraqet një organizëm të shëndoshë, të cilit herë pas here i ndodh gjithsesi të bjerë i sëmurë, – çka do të kërkonte një ndërhyrje mjekësore përkatësisht kirurgjike në personin e pushtetit shoqëror të përkohshëm; përkundrazi, rendi shoqëror i çdo shoqërie të ndarë në klasa paraqet një organizëm të pashëndoshë, të cilit kohë pas kohe mundet po ashtu t’i ndodhë të mos jetë posaçërisht i sëmurë, – kohë për të cilat trupit mjekësor dhe kirurgjik, në personin e qeverisë së përhershme klasore, i lejohet të përtacohet.

E treta. Derisa binomi rend shoqëror plus pushtet shoqëror i përkohshëm jep formën shtetërore primare, përkundrazi binomi rend shoqëror plus qeveri e përhershme klasore jep formën shtetërore dytësore.

E katërta. Derisa dallimi i zakonshëm jo vetëm në praktikën juridike, po edhe në teorinë sociologjike, të shtetit nga qeveria është vulgar, përkundrazi dallimi i Shtetit me pushtet të përkohshëm shoqëror nga Shteti me qeveri klasore është shkencor.¹

XV

Duke renditur komunizmin primitiv ndër rendet shoqërore nëpër të cilat ka kaluar deri tash njerëzimi, – socializmi shkencor me vetë këtë fakt ka pranuar se edhe në një shoqëri pa klasa gjithsesi duhet të ketë një rend.

¹ Për një të tillë dallim mund të thuhej madje se është ilogjik. Në të vërtetë, të dallosh dy gjëra do të thotë ... të veçosh konceptin “me nda”, nga ana e tij, dhe perfektin e sinonimit “me dyfishue”, që do të thotë “nga një tërësi me ba dy njësi”. Por koncepti i kësaj tërësie që është Shteti dhe koncepti i qeverisë, që është një nga elementet e tij përbërës, – këto dy koncepte a mund të formojnë dy njësi të po kësaj tërësie?! E gjithë kjo a nuk rikthehet tek analiza e tërë Shtetit në një prej pjesëve të tij integrale dhe në një ... vetë atë. – Me qëllim që ta zhbënim lexuesin nga çdo mendim eventual se pas të gjithave këtu do të ishte fjala vetëm për një subtilitet pak a shumë të deplasuar nga ana jonë, do ta paraqesim arsyetimin tonë në një mënyrë tjetër. – Ta dallosh të tërën nga pjesët e saj – kuptohet, jo në kuptimin e zakonshëm të një veçimi praktik, por përkundrazi teorikisht, sistematikisht – a nuk do të thotë të shprehësh paralelisht tipare të ndryshme të tërësisë dhe të pjesës, të thuash ta sjellësh pjesën në rangun logjik të tërësisë, të thuash edhe ta bësh logjikisht të të njëjtit rang? – A thua mbi dallimin midis tërësisë dhe një prej pjesëve të saj mund të themi diçka më shumë e më ndryshe se kjo: “Tërësia është më e madhe se secila prej pjesëve të saj dhe e kundërta?”

Kjo është gjithsesi evidente, sepse asnjë shoqëri njerëzore pak a shumë e qëndrueshme nuk mund të merret me mend në mungesë të çdo rregulli të përgjithshëm që paracakton raportet e ndërsjella të individëve të bashkuar në të, përkatësisht të drejtat dhe detyrat e tyre ndaj njëri tjetrit. Prandaj as në komunizmin primitiv jeta e përbashkët nuk ka mundur të mbështetet ekskluzivisht në... rëren e lëvizshme të vetëm arbitraritetit patriarkal. Do të ketë pasur aty njëfarë rendi shoqëror, bartës dhe gardian i të cilit do të ketë qenë vetë patriarku, i cili, nga ana e tij, mund të ketë klithur: “*Shteti jam unë*”.

Nga ana tjetër, midis bashkësive primitive, për të cilat dimë se asnjëra nuk ka qenë krejt e izoluar nga të tjerat, po përkundrazi me shumë prej tyre ka formuar një grupim etnik – është dashur të ketë pasur komunikime dhe raporte. Dhe, nëse është e vërtetë se ato raporte është dashur edhe tek ata të jenë objekt i njëfarë rregullimi, atëherë më shumë që pronësia kolektive e tokave të punueshme të një bashkësie primitive në kuadër të grupimit përkatës etnik ka përbërë një regjim të vërtetë të pronësisë ekskluzive – është jo më pak e vërtetë se një rregullim i tillë nuk ka mundur të lihej në dorë vetëm të mëshirës së bashkësisë së më të fuqishmëve ndaj më të dobëtve, sepse atëherë do të sundonin në mënyrë absolute paligjësia dhe pasiguria – që padyshim do të ketë qenë rasti i raporteve midis dy grupimeve të huaja etnike, por jo brenda të njëjtit grupim etnik, brenda të të cilit do të ketë gjallnuar gjithsesi njëfarë rendi shoqëror ndërkolektiv, i cili, krejt e besueshme gjithnjë ende i privuar nga një organ sanksionimi i përqëndruar në personin e një këshilli patriarkësh, përkatësisht gjithë duke mos u pas shndërruar ende në përmbajtjen e një forme të qëndrueshme shtetërore, patjetër do ta ketë pasur efektin e vet përmes veprimit në njëfarë mënyre me vetë praninë e vet gjatë tërë periudhës kohore, gjatë së cilës do të ketë përbërë material shtetëror në pritje të një rasti për t’u formuar përfundimisht në fazë nistore të një Shteti të vërtetë.

Dhe ky rast iu dha menjëherë sapo grupimi i parë etnik në histori u bë gati ta braktiste vendin e vet për të pushtuar një tjetër. Vërtet, athua krerët e bashkësive të ndryshme deri edhe krejtësisht të pavarura primitive të këtij grupimi etnik do të kenë mundur, bashkë me të gjithë burrat, të ndërmerrnin një fushatë pushtuese pa e pas transformuar paraprakisht grupimin e tyre etnik në një tërësi pak a shumë të organizuar? – Më tej, një transformim i tillë a do të ketë mundur të ushtrohej ndryshe pos përmes rrugës së federimit, përkatësisht të një angazhimi që këta krerë do të kenë marrë mbi vete vullnetarisht dhe

më plastikun e artit: skulptura.

¹ Selman Riza ka lënë dorëshkrimin *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme* në 13
Fletore si një rrjedhë e vetme të menduarit, u botua përgatitjurgu R. Ismajli, Dukagjini,
Pejë, 2009.

195. Fakti se i njëjti kumtim as përsëlargu nuk është barabar i qartë për kuptimmarrësin sa për vetë kumtuesin a nuk provon se kumtuesi mjaft pjesë të pashprehura e për pasojë gjuhësisht të paformuluara të objektit të kumtuar i ka prapëseprapë të pranishme e madje të qarta në mendjen e vet.

266. Kundërndejtimi: *logjikë/ gjuhë* qëndron gabimisht për kundërndejtimin: “*logjikë*” (siç çfaqet në gjuhën e folur të këtij apo atij grupi etnik) *logjikë* (siç realizohet në nivelin epror të mendimtarisë shkencore ndërkombëtare).

296. Në çdo gjuhë letrare mund të shprehet gati gjithëçka, por vetëm në letrarishtet lartësisht të lavruara gati gjithëçka të shprehur qoftë nga artisti i fjalës qoftë nga prozatori shkencor lexuesi e kupton me lehtësi, shpejtësi dhe siguri, e për pasojë pa qenë i detyruar të lexojë mbarë periudhën, e madje mbarë paragrafin e madje madje mbarë tekstin për të gjetur kuptimin e përpiktë të kësaj apo asaj fjale, fjalie a periudhe.

323. Shpërdorues i të folurit për të kumtuar më se një herë apo në më se një mënyrë ata çka qoftë sepse dihet tashmë qoftë sepse vetëkuptohet, apo ata çka nuk ia vlen të kumtohet fare, ja përkufizimi i fjalës “*Fjalaman*”, të cilën Fj. i Inst. e ka përkufizuar krejt ndryshe e pikërisht kështu: “*Fjalaman*”: i thonë atij, të cilit *s’i pushon goja*” (S.R. p.sh. së ngrëni, së piri, së përtypuri etj.).

324. Cili dhjamë është më i majmur: ai i – gjalpit apo ai i – vajit? (këtë pyetje marroqe ma sygjeroi përkufizimi prej Fj. të Inst. i fjalës: “*lyrë-a ef. dhjami i gjellës, i gjalpit a i vajit:...*”).

346. Variantin gojor gati të çdo gjuhe kombëtare e komprometon keqas prirja iracionale për të shprehur pikë së pari procesin e vetëm pastaj bartësin e tij, madje mundësisht për të mos shprehur fare këtë të fundit.

347. Kumtuesi objektin e kumtimit duhet jo vetëm ta shprehë në “*gjuhën*” e kumtimarrësit, por edhe ta *përcaktojë* nga pozitat e këtij të fundit.

348. Gjuha e *shkrimit*, me të drejtë, e *lavrimit refleks* dhe gjuha e *të folurit*, me të drejtë, e *të zhvilluarit spontan* sa shmangen njëra nga tjetra aq përdorimi *gojor* i së parës dhe përfaqësimi *shkrimor* i së dytës ndryshojnë njëri nga tjetri.

354. Në përkthim e sipër nga një gjuhë në tjetrën, pabashkëmatshëmenia e *elementeve* që janë domethëniet e fjalëvevet dhe vetë nocionet aspërsëlargu nuk pamundëson bashkëgjegjësimin e kombinimevet të tyre në *trupat* përkatës dmth. në fjalitë dhe periudhat (shih 51).

376. Ndërgjegjja (jo psikologjike, por intelektologjike a ndërditja) nuk është veçse qoftë lashtësisht qoftë pandërmjetësisht e mëparshëmja kujtesë në

funksionim e sipër. Anasjelltas kujtesa është ndërgjegjja potenciale.

382. Të rikujtuarit e fjalëvet të një kënge *vetëm* gjatë këndimit të saj përbën një rasje konkomitance gjuhësoro – muzikore.

383. Tipin funksional të superfluidit ndërgjegjor e përbën qarkullimi i tij pa ndërprerje nëpër rrjetat qelizoro-trunore përkatëse.

385. Mosngulitja e anaptistit në trajtat e prapanyjzuarra dëshmon kundër tezës së hershmërisë së prapanyjzimit. Kundër së njëjtës tezë dëshmon gjithashtu trajta joprimare – *t* e nyjës së prapme në rasën rrjedhore.

396. Thirrorja bën punën e një pasthirmje.

399. Teoria e “pastërtisë gjuhësore” jo rrallë zvetënohet në praktikën e pauperizmit gjuhësor.

405. Lakonizëm gjuhësor, ekonomi mendore.

413. Riprodhimi i vullnetshëm i parafytyrimevet “per-se-stantë” [përvehte-qëndruës] është skajshmërisht i pavështirë e gati automatik në krahasim me rikujtimin e jopersestantëvet.

421. “Lapsus linguae”-t a nuk bashkëvërtetojnë tezën mbi dualizmin e mendim - ligjërimin.

426. Në letrarizim e sipër të gegërishtes së Fishtës “taravol” Gjon Buzukut të “farizej-farizell”-it nuk do t’i ketë bërë syri bef përpara asnjë rreziku sado qafëthyerës.

434. Kalimi nga shqiptimi i domosdoshëm i gjuhës gojore në leximin potencialisht pa zë të së shkruarës redukton konsiderueshmërisht materialitetin masiv të “signologjisë” fonetike.

451. Gjatë qoftë ripranishëmimevet qoftë ndijimevet truri punon me absolutisht të njëjtin burim energjie a superfluid i ndërgjegjës ndijimoro-ripranishëmimore. Prandaj ndijimet tepër të fortë mund të pezullojnë ripranishëmitet e anasjelltas.

458. *Të dëgjova* (\equiv mora kumtim nga ato që më the e që nuk paraqesin ndonjë vështirësi për t’u riprodhuar në ndërgjegjen time) \neq *të kuptova* (\equiv mora kumtim nga ato që më the duke kapërcyer pengesat e riprodhimit të tyre në ndërgjegjen time, duke ndërmarrë çvendosjen pozicionale të rastit, duke plotësuar unë vetë zbrazësirat e kumtimit tënd, etj.).

459. Praktikën e shoqërimit të të menduarit nga të ashtuquajturit të folur të brendshëm do ta ketë bashkëshkaktuar edhe fakti se mbresat ndëgjimore përmbeten në tru më gjatë se jondëgjimoret.

465. Faiku, Noli, Çajupi, Kuteli etj. të mërguar së lashti si familje a së

vogli si individë, e kështu të detyruar që letrarishten kombëtare ta nxënë si një gjuhë gati të huaj, u bënë mëpastaj mjeshtrit më të mëdhenj të fjalës shqipe.

530. Të kuptuarit e një teksti vështirësohet jo gjithaq nga vështirësitë e tij, sa shumë më tepër nga nënvleftësimi i tyre.

606. Përfaqësimi (vizatimor) i vëtë të menduarit duke abstrahuar nga të folurit quhet shkrim ideor a *ideografi*. Përfaqësimi (vizatimor) vetëm i të folurit në tri njësitë e tij themelorë që janë periudha (si grupim fjalish) fjalia (si grupim fjalësh) dhe fjala (si grupim tingush të nëngrupuar në rrokje) quhet shkrim zanor a *fonografi*; kurse drejtshkrim orografik quhet përfaqësimi shkrimor më i rregullt dhe i njësisishëmuar i drejtshqiptimit të një gjuhe, i cili përveç përbërjes tingullore të fjalëvevet, përfshin: kufinjte e fjalëvevet brenda fjalisë, të fjalisë brenda periudhës dhe tipet e këtyre të fundit. Por këto tri çfaqje të fundit kanë një karakter zanor mezi të përkapshëm; prandaj përfaqësimi i tyre drejtshkrimor praktikisht bëhet nga pozitat jo të fonetikës, por të leksikologjisë dhe sintaksës.

607. Shqipfolësit nuk *nxënë* dot shkrimin e drejtë pa pasë *çnxënë* shqiptimin e shtrembër.

673. Studimet shkollorë të letrarishtevet kombëtare kanë nga një objekt të dyanshëm, e pikërisht nga njëra anë zgjerimin e inventarit leksikoro-gramatikor tashmë praktikisht të përvehtësuar të gojarishtevevet amëtare, dhe nga ana tjetër ripërvehtësimin analitiko-sintetik e për pasojë rreptësisht shkencor të këtij inventari gjuhësor kështu të zgjeruar.

674. Në gjuhësinë e përgjithshme dhe në gjuhësitë e veçanta, i ashtuquajturit “drejtshkrim-fonetik” në fakt është fonografiko-ideografik e madje ideografiko-fonografik. Themi kështu, sepse kur dy parimet ideografik dhe fonografik të drejtëshkrimit të çdo gjuhe vijnë në kundërshtim njëri me tjetrin, atëherë ideografiku mbizotëron fonografikun – çka kryesisht ndodh në këto tri situata:

a. kur njësitë ideore dhe togjet tonikë të një fjalie nuk përputhen në kufinjte e tyre, atëherë drejtshkrimi gjoja frontalisht fonetik fjalinë e përfaqëson të ndarë në njësi ideore ose fjalë, e jo në togje fonetikë ose togje fjalësh;

b. të njëjtat pjesë fjalësh apo fjalë po ky drejtshkrim i përfaqëson si fonetikisht identike edhe atëherë kur ndonjë tingull i tyre ndryshon ndieshëm për shkak të ndryshimit të pozicionit të tij brenda fjalës apo fjalisë; dhe

c. kur dy fjalë të ndryshme kanë të njëjtën përbërje fonetike, atëherë drejtëshkrimi gjoja fonetik mund t'i diferencojë me ndonjë shenjth marrveshjeor.

675. Të ashtuquajturit drejtshkrime historikë dhe etimologjikë janë variante të thjeshtë të anës fonografike të drejtëshkrimit (ideografiko-fonografik).

676. Normalisht, nxënia e anës ideografike, e për pasojë më teorike së përfaqësimit ideografiko-fonografik ose drejtshkrimit të një gjuhe paraqet më shumë probleme se sa nxënia e anës së tij fonografike e për pasojë më teknike.

677. Anomalia, e papërgjithësuar në të kaluarën dhe në zmbropsje në të tashmen, e lëvisjes masive së gjinisë gramatikore nga njëjisi mashkullor në shumësin femëror, përse vallë të kodifikohet normë unike e së ardhshemes?

678. Lavruesin artistik të një gjuhe mund ta udhëheqë më fort *ndjenja* gjuhësore se sa *kuptimi* gjuhësor; por përcaktuesi normativ i një gjuhe duhet të anasjellë rendin e këtyre dy faktorëve.


699. Të operuarit me “njësitë *gjuhësore* e për pasojë zanoro-kuptimore” përbën një shtrembërim metodologjik, sepse njësitë e anës zanore dhe ato të anës kuptimore nuk përputhen gjithandej në kufinj të tyre.

700. Ndajmveshja një ontomeni (fenafori) e njërit nga fenomenet e tij potencialë përbën një *mendim* (në kuptimin e *njësisë së të menduarit*).

701. *Përemërat jovehtjorë* janë fjalë kontekstualisht përfaqësimitare fjalësh, togfjalëshash dhe fjalish.

705. Në fillim qe NDIJIMI, të cilit pastaj iu shtua MENDIMI, të cilëvevet më në fund iu stërmbishtua FJALA.

718.

EKZISTENCË**[Teza e Pavlovit]**

740. Teza e veçantë e Pavlovit mbi *fjalët si signale signalesh* duhet shqyrtuar në dritën e tezës më së përgjithshme të tjetërkujt mbi *dallimin e ripranishëmimevet* (përfytyrimevet, parafytyrimevet, paraprumjevet) në: *qëndrues-për-vetëvehte* (*per-sè-stante*) dhe në: *qëndrues* (jopërvetëvehte, por) –*për* – *thetërçka* (*per-aliud-stante*).

Signali apo (më përgjithësisht) *shenji* është një *e dhënë materiale*, **perceptimi** i së cilës (për efekt të një përvoje vehtjake apo stërvitjeje nga tjetër-kush) jep shkas **ripranishëmimit** të një së dhëne tjetër. Pra, një e dhënë materiale vetëm mbasi të jetë perceptuar një herë në vetëvehte dhe për vetëvehte, mund pastaj të japë shkas **ripranishëmimit** të një së dhëne tjetër dmth. të funksionojë pikërisht si shenj i kësaj së fundit. Por të dhënat materiale të dobishëmuara si shenja – zakonisht trillohen vetëm për hir të këtij shërbimi të tyre indirekt ose konvencional, e jo për të sjellë njëherazi edhe ndonjë shërbim real direkt. Prandaj të dhënat materiale *shenjuese* perceptohen si të thuash fluturimthi, sepse ato, gjithë duke u perceptuar në vetëvehte, nuk perceptohen për vetëvehte, por vetëm për të dhënë shkas ripranishëmimit të të dhënave materiale të *shenjuara*. Për pasojë, nga dy komponentet ndijimore dhe ripranishëmimore të perceptimit të një së dhëne materiale shenjuese, komponentja e dytë përbën një ripranishëmim per-aliud-stante. Përmëtepër, edhe atëherë kur si të dhëna materiale shenjuese shërbejnë sende a veprime për ndryshe të një shërbimi real direkt, prapëseprapë komponentja ripranishëmimore e perceptimit të tyre është gjithashtu një ripranishëmim per-aliud-stante.

Në dritë të analizës intelektualgjike së sipërme, anët zanore të fjalëvet të një shërbimi vetëm konvencional ose indirekt, dhe ngacmuesit të një shërbimi njëherazi edhe real direkt në eksperimentimet e Pavlovit për formimin e reflekseve të kushtëzuar – janë të një funksionaliteti absolutisht identik.

Apo që ta themi ndryshe, anët zanore të fjalëvet dhe ngacmuesit krejt të thetërllojshëm të Pavlovit për formimin e reflekseve të kushtëzuar janë barabar signale ose shenja.

Së këndejmi rrjedh domosdoshmërisht se teza e Pavlovit mbi “fjalët si signale signalesh” është kryekëput e pambrojtshme.

Edhe me të vërtetë, ana zanore e një fjale në përdorjen e saj si shenjuese *qoftë* e tërë një klase sendesh *qoftë* vetëm e njërit nga ekzemplarët e kësaj klase – është përhershmërisht dhe pandryshueshmërisht vetëm e vetëm signal a shenj.

Signal signali a shenj shenji apo, më përgjithësueshëm, signal a shenj të një shkalle së caktuar kemi vetëm atëherë kur një e dhënë materiale nga shenjuese shdërrohet në të shenjuar. P.sh. shkrimi i shifruar i shkrimit botor të përbërjes zanore së një fjale shenjuese së një koncepti a nocioni do të përbente një signal a shenj së shkallës së tretë.

Pavlovin te teza më e veçantë mbi fjalët si signale signalesh e ka shpënë teza më e përgjithshme mbi “përshtypjet, ndijimet, përfytyrimet” si

signale të parë; - tezë më e përgjithshme këjo, që nuk i qëndron dot kritikës.

Edhe me të vërtetë, sikur përfytyrimet e veçantë të ishin signale të sendeve të veçantë të realitetit (objektiv), atëherë edhe përfytyrimet e përgjithshëm do t'ishin signale të përkatësevet klasa sendesh; kështuqë atëherë çdo koncept do t'ishite një shumë signalesh të veçantë, e për pasojë çdo përfytyrim qoftë i veçantë qoftë i përgjithshëm do t'ishite një përfytyrim per-aliud-stante.

Gjenetikisht çdo ndijim është jo signal i një sendi të veçantë, por pasqyrim i këtij të fundit. Këjo vlen edhe për përfytyrimin e veçantë që është riaktivizim i mbresës së një ndijimi. Madje këjo vlen edhe për përfytyrimin e përgjithshëm a konceptin, me të cilin bashkëgjegjësohet një klasë sendesh.

Përkufizimi i ynë i signalit apo shenjtit si diçka materiale, *perceptimi* (*ndijim-përfytyrimi*) i së cilës jep shkas përfytyrimit të një diçkaje tjetër, duhet pasur vazhdimisht parasysh në këte mes dhe zbatuar me rreptësi.

Kështu, është e vërtetë se në masën në të cilën ndijim-përfytyrimi i një-rës nga anët e një sendi jep shkas përfytyrimit të anëvevet tjerë të tij, ndijim-përfytyrimi i kësaj ane mund të pandehet se përbëka përfytyrim per-aliud-stante e për pasojë se këjo anë përbëka signal a shenj të anëvevet tjera. Por këjo pandehje është e pathemeltë, sepse tërë arësyeja e qenies e një signali duhet të jetë thjeshtë dhe vetëm funksionale; çka nuk ndodh në rasjen e shqyrtuar, ku ana e perceptuar megjithëse jep shkas përfytyrimit të anëvevet tjera, mbetet që mbetet e përfytyruar për vetëvehte. Mësa në mjekësi simptomi i një sëmundjeje mund të mbahet si signal a shenj konvencional a artificial a arbitrar i kësaj sëmundjeje, aq edhe komponentja përfytyrimore e perceptimit të një ane së një sendi, për efekt të së cilës (anë) përfytyrohen anët tjera të këtij të fundit, mund të vështrohet si per-aliud-stante.

Zhvillimevet të mësipërm u duhen shtuar edhe këto vërejtje:

Vërte Pavlovi gjithandej ka operuar me terminin *signal*, e jo *shenj*. Por prej *shenjtit* signali ndryshon vetëm për rrethanën se zakonisht signali jipet nga një farë largësie çka nuk ndodh me shenjtin. Përndryshe dmth. për nga mekanizmi fiziologjik dhe funksionaliteti intelektualgjik, signali dhe shenji janë absolutisht të njëjtë.

E meqë i njëjti identitet ekziston edhe midis shenjtit dhe simbolit, Pavlovi, duke marrë “përshtypjet, ndijimet, përfytyrimet” si signale të realitetit (objektiv), në fakt është vënë kështu këmbë e krye në pozitat e “materializmit heroglifik”, të cilin Lenini qysh më 1908 e pati bërë objekt të një kritike, e cila nuk mund të bëhej më dërmuese. (Materializëm i empiriokritizëm, “teorija simvolov” f. 215-222).

Vlen të vërehet se literatura sovjetike filozofike, psikologjike, gjuhësore etj. vlon jo vetëm nga operimet me tezat (përgjithësisht joshkencore, dhe veçanërisht aspak marksiste), të Pavlovit qoftë mbi “ndijimet dhe përfytyrimet si signale” qoftë mbi “fjalët si signale signalesh”, por njëherazi edhe nga një konfuzion terminologjik mezi i besueshëm.

Kështu në “*Kratkij filozofski slovar*” (1955), “ngacmuesit” ngatërrohen me “ngacmimet” dhe këta të fundit me “ndijimet”. Po aty “reagimet” ndaj “ngacmimevet” identifikohen me “signalet”, etj.

Kalimi (iradiues, e për pasojë i dobësuar) i ngacmimit të një grupthi qelizotrutor tani të ngacmuar te një tjetër vërte dikur e bashkëngacmuar por që tani nuk është më objekt bashkëngacmimi – përbën kalim nga një grupth qelizotrutor në gjendje ndijimore te një tjetër në gjendje jondijimore, e për pasojë përfytyrimore.

Edhe vetë ndërlihdja midis dy grupthesh qelizotrutorë të bashkëngacmuar, e rimëkëmbur *mbas një numri bashkëngacmimesh*, aspërsëlargu nuk është aq lehtësisht e përshkueshme nga rryma e energjisë mendore *alias* përfytyrimore sa “udhët përsjellëse” brendatrutorë të ngacmimevet shqisore.

[Për nocionin, shenjën, të menduarit, intelektologjinë...]

748. E ashtuquajtura “mendje”, më drejtë, të ashtuquajturat “mend” janë kujtesa *plus* ndërgjegjja e jo anasjelltas. *E jo anasjelltas*, sepse është pike-riht nëpër kujtesën që ndërgjegjja ndijimore ose e ndijimevet shndërrohet në ndërgjegje përfytyrimore ose të përfytyrimevet (dmth. të mbresavet të riaktivizuara të ndijimevet).

749. Ndërgjegjja ndijimore (ose “ndjenjat”) është primare jomendore; kurse ndërgjegjja përfytyrimore është sekundare mendore.

754. Karakteri homogjen i strukturës gjuhësore çenohet: 1. nga zbatimi i kushtëzuar gati i që të gjithë ligjevet fonetikë, 2. nga çfaqjet jotëpërgjithësuar të riformimevet analogjikë.

763. Gjuha e njerëzvet pa kulturë luhatet midis “të folurit” klithës dhe të klithurit “ligjërues”.

767. Ata që shpërdorjnë të folurit për të fshehur qoftë hipokritçe të menduarit ndryshe nga ç’flasin qoftë sharlatançe të mosmenduarit fare – më kanë bërë urrejtës kaq të paarësyeshëm të vetë gjuhës saqë kur ata thonë: “gjuha ose të folurit”, unë dëgjoj: “llapa ose të llapurit”.

790. Për gjuhëtarët e pararojës tashmë ka ardhur koha e kalimit nga pozitat e linguistëvet *poliglotë* në ato të linguistëvet *polifilologë*.

812. Vënia e shenjtit të barazisë midis *konceptit a nocionit* dhe *fjalës* do

të përbënte një pasaktësi aspak më shumë trashanike nga ç'përbën barazimi i *parandejtimit* si brendi konceptuale a nocionale e *fjalisë* me vetë këte të fundit si bashkim fjalësh.

822. Në stadin epror të funksionimit integral, gjuha është e destinuar që të kumtojë të veçantat nëpër të përgjithshëmet përkatëse. Por qartësisht të ndërgjegjshëm për këto të fundit bëhen vetëm gjuhëtari dhe logjicieni, si të këtillë. Kur të veçantat kumtohen pa u bërë folësi dhe dëgjuesi aspak të ndërgjegjshëm për të përgjithshëmet përkatëse, atëherë gjuha shndërrohet në një mjet kumtimi vetëm e thjeshtë konkret, siç ndodh me mjetet përkatës në artet figurativë.

865. Ja vetëm disa nga mospërputhjet thelbore të të menduarit me të folurit dhe të të folurit me të menduarit:

a. përvehtësim i plotë i anës shqiptimore së fjalës shumë kohë para përvehtësimit të plotë të anës së saj kuptimore;

b. përvehtësim i njërit nga zbatimet “e përveçëm” të kuptimit “të përgjithshëm” të një fjale shumë kohë para përvehtësimit të këtij të fundit;

c, ç. tejndryshëmim në individin prkt. kolektivin i nocionit a konceptit kundrejt mostejndryshëmimit të anës shqiptimore së fjalës përkatëse; dhe anasjelltas;

d. zhvillim zakonisht aspak paralel i aftësivët mendore dhe atyre gjuhësore gjatë procesit formativ të të njëjtit individ;

dh. mundshmëri e harrimit të anës shqiptimore së një fjale [e për pasojë së vetë kësaj fjale së marrur vetëm si shenj e jo njëherazi edhe si send i shenjuar] pa pasë harruar anën e saj kuptimore; apo e harrimit të emrit të një personi gjithë duke pasë për-ruajtur aftësinë për të rikujtuar këte person;

e. asinkronizëm relativ midis të menduarit dhe të folurit;

ë. pabarazi e thekësuar e shpejtësisë së të menduarit me të të folurit;

f. pabarazi e strukturës “monomiale” së të menduarit si përfytyrim patjetër me strukturën “binomiale” të të folurit si përfytyrim zanor *plus* materializimin e këtij përfytyrimi;

g. tjetërllojshmëri e natyrës së të menduarit si pasqyrim subjektiv *sui generis* dhe *unius specimenis* i objektives (prkt. së objektivizuarës)

nga natyra e të folurit si vërte më i rëndomti dhe i përsosurueshmi,

por jo njëherazi edhe i vetmi mjet përfaqësimi i këtij pasqyrimi;

gj. fiziologjikisht, ndërsa pasqyrimi subjektiv i çdo objektivje lokalizohet në zonën trunore përkatëse, përkundrazi përfytyrimi zanor i anës zanore së të folurit lokalizohet në të vetmen zonë trunore zanore;

867. Në qoftë e vërtetë, siç është e vërtetë, se toni i fjalës jo rrallë bën më shumë efekt e për pasojë ka më shumë rëndësi se vetë fjala, atëherë si mund të mbrohet teza se të folurit përfaqësuaka vetëmjaftueshmërisht të menduarit?

870. Në fakt e ashtuquajtura “fjalë” është vetëm ana e saj zanore në funksionin thjesht signologjik të përfaqësimit të një nocioni.

894. Ripranishëmimi vetëm i njëhershëm i një së pranishëmje do t’ishite praktikisht i barasvlefshëm me asnjë ripranishëmim të saj. Pjelloria mbishtuese dhe krijuesia kombinuese apo më shkurt, vitaliteti i mendjes detyrohet faktit se ripranishëmimi i një së papranishëmje është i mundshëm vërte në një mënyrë jo të pakushtëzuar, por prapëseprapë për një numër të pakufizuar herësh. Madje sa më i lartë të bëhet numri i ripranishëmimevet të së njëjtës së papranishëme, aq më të lehtë, të qartë dhe të sigurtë bëhen këta të fundit. Përmëtepër ripranishëmimet e njëmbasnjëshëm të së njëjtës së papranishëme ndryshojnë kurdoherë midis tyre për nga konteksti ndërgjegjor përkatës.

896. Gjatë ndijim-ripranishëmimit ose përkapjes, objekti i ripranishëmimit ose e ripranishëmuara vërte është materialisht e pranishëme, por gjatë thyesës së çastthit kur përkryhet komponentja ripranishëmimore e përkapjes përkatëse papranishëmohet dmth. shndërrohet në materialisht të papranishëme *alias* të parrokur nga shqisa përkatëse.

987. Në qoftë “intelektologjia” shkencë e ripranishëmimit *imedi*at dhe *persestant* të një së papranishëme, anasjelltas “signologjia” është shkencë e ripranishëmimit të saj mediat nëpërmjet përkapjes së shenjit përkatës.

898. *Shenji* është një diçka, përkapja e së cilës shkaston ripranishëmimin e një diçkahe krejt së tjetërlllojshëme.

920. Me dorëshkrimet kishtarë në shqipen gjërësisht parbuzukjane, pas-taj me botimet mësimorë dhe artistikë gjatë epokës së Rilindjes, e më në fund me shqiptarizimin gjuhësor të Kishës ortodokse, jugorët ortodokso – mysli-manë kanë dhënë kontribute kuantitativisht më të rëndësishëm dhe kualitativisht më pozitivë për letrarizimin e shqipes gojore se sa katolikët dhe mysli-manët jojugorë.

921. Çdo mendim mohues është i barasvlefshëm me pranimin makar të heshtur se mendimi i mohuar ekziston përkt. mund të ekzistojë në kokën e ndonjë menduesi. Me fjalë tjera, mohuesi i një mendimi mohon vetëm vërtetësinë e këtij të fundit, e jo njëherazi edhe ekzistencën prkt. mundësinë e ekzistencës së tij në kokën e ndonjë menduesi. Madje sugjerimi më i riholluar, minuimi më delikat i ekzistencës prkt. i mundësisë së ekzistencës në kokën e ndonjë menduesi së një mendimi është pikërisht mohimi sa më i haptë dhe

energjik i vërtetësisë së tij. P.sh. “Tezën mbi afinitetin e posaçëm të shqipes me rumanishten E. Ç. kursesi nuk e ka mbrojtur me aq forcë për të bërë qejfin rumunëvet” (S.R.).

986. Nga problemet praktikë të leksikologjisë më themelori është ai i dy a më shumë kuptimeve të së njëjtës fjalë në dy a më shumë kontekste. Tani, e njëjta fjalë, në fillim të bisedës, u takon, dy “kontekstevet” ende pamjaftësisht të paralelizuar në dy kokat plotësisht të veçantë të folësit dhe dëgjuesit. Prandaj edhe mosmarrëveshjet e pjesshme e madje keqkuptimet tërësorë midis folësit më të kujdesshëm dhe më të vemendshëmit dëgjues mësëforti ndodhin pikërisht në fazën fillestare të bisedës së tyre.

992. Kur të parën fazë të dukshme të një procesi sëmundjor vrojtuesi e shndërron në sinjal a shenj të fazave pasuese të këtij të fundit, atëherë ai vepron si specialist i *simptomologjisë* që është një nënndarje e *signologjisë*.

1129. Metafora gjoja terminologjike “pasqyrim mendor” është dyfish e pasaktë. Edhe me të vërtetë, ndërsa pasqyra paraqet të *pranishëmen* në një pozicion *simetrik* me pozicionin e saj real, përkundrazi mendja ripranishëmon të *papranishëmen* në pozicionin që e pranishëmja përkatëse ka pasur në *realitet*.

1133. Pargjykimi vulgar mbi pamundshmërinë e të menduarit në mungesë të të folurit nga njëra anë shpërnjeh këto dy të vërteta elementare: 1) se tërë të menduarit përbëhet vetëm nga të ripranishëmuarit e të papranishëmet, 2) se tërë veprimin e vleshëm të të folurit e përbën vetëm kumtimi i të menduarit; e nga ana tjetër ushqen këta dy kundërkuptime teknikë: 1) se i njëjti formulim gjuhësor (për të mos thënë: e njëjta kallëposje gjuhësore) vлека gjithmonë për të njëjtin mendim pamvarësisht nga rrethanat e ndryshme të kumtimdhënies dhe personat e ndryshëm të kumtimarrjes; 2) se shnërrimi gjoja i të natyrshëmit e përndryshe të pamungueshëmit të folur me zë në të ashtuquajturin të folur të brendshëm, menduesvet u kursyeka vetëm energjinë fizike të të shqiptuarit...

1153bis. Studimi sado sistematik i të komunikuarit midisndërgjegjor nëpërmjet vetëm veprimtarisë së të folurit (gjuhësi) nuk do të mund të shkencorizohet pa u pasë kushtetuar më parë një komunikativistikë e përgjithshme e komunikimevet midisndërgjegjorë nëpërmjet edhe veprimtarish tjera siç janë: të vizatuarit skematikisht, të imituarit trupërisht, të demonstruarit materialisht etj.

Nga Fletore II

1352. “Prandaj ai (S.R. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe”) do të zbatojë rreptësisht “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes” të botuara nga Universiteti

Shtetëror i Tiranës e të *miratuara përfundimisht nga organet shtetërore përkatëse*” (Androkli Kostallari, Studime Filologjike, 1968/2).

1425. Zhvillimet e kuptimevet të fjalëvevet nuk kushtëzohen nga zhvillimet tingullorë të këtyre të fundit. Prandaj semnatika në parim është një disiplinë intelektualgjike, e jo gjuhësore.

1426. Gjuhësisë nuk i takon të tregojë as përse ky apo ai tog tingujsh *alias* këjo apo ajo fjalë ka këte apo ate kuptim, as përse kuptimi i së njëjtës fjalë shumë a pak ndryshon gjithmonë gjatë kohës.

1427. Nga nr. 1425 dhe nr. 1426 del qartë se objekti i gjuhësisë përbëhet vetëm nga *fonetika përfaqësuese e semantikës*, e jo njëherazi edhe nga këjo e fundit; dhe rrjedhimisht se gjuhësia (*stricto sensu*) është një teknologji vërte skajshmërisht e ndërlikuar, por prapëseprapë vetëm një teknologji, e pra kurrësesi dhe kurrësesa jo njëherazi edhe një shkencë.

1428. Proceset psikologjike aspërsëlargu nuk janë aq të mëvetimshëm sa ata fiziologjikë, e aq më pak sa ata intelektualgjikë.

1429. Pseudodublimi jomaterial i së *pranishëmes* përbën pseudodublimin fiziologjik ose *ndijimin*; kurse pseudodublimi jomaterial i së *paparani-shëmes* përbën pseudodublimin intelektualgjik ose *mendimin*; mendim ky, i cili në fazën priamre është global, kurse në sekundaren bëhet *analitik-sintetik*.

1430. Signologjikja nga një mjet i thjeshtë për të kumtuar intelektualgjiken është shndërruar në një kusht të domosdoshëm për të superpotencializuar këte të fundit.

1437. Mendja \equiv kujtesa *si e këtillë* (dmth. si ideotekë ose fond ripranishëmimesh jo aktivë por të riaktivizueshëm të së kaluarës) + kujtesa *në veprim* (ose ndërfgjegja, sepse deri ripranishëmimet e tashëm gati në të njëjtin çast bëhen të së kaluarës).

1562. Shkencat përcaktohen nga objektet e tyre, që duhen klasifikuar gjenetikiisht: *materialogji*, *biologji*, *intelektologji* dhe *signologji*, duke vështuar *matematikën* si shkencë ndihmëse të që të gjitha tjerave.

1571. Signologjia vashdon pandërmjetshëm intelektualogjinë; sepse objekt i signologjisë janë ripseudodublimet materializues të pseudodublimevet jomaterialë, objekt i intelektualogjisë.

Gjithashtu vazhduese e pandërmjetshëme e materialogjisë është biologjia që trajton vetëm komponenten jetësore të materies, tashmë së trajtuar nga materialogjia.

1573. Intelektologjia është shkencë e ripranishëmimevet të ndërlidhur.

1597. Intelektologjia normative duhet të formulojë rregullat njëherë të

futjes së komponenteve të veçanta të çdo mendimi në të përgjithshmet përkatëse (*identifikimi konceptual*), e vetëm pastaj të nxjerrjes së një mendimi nga një ose më se një mendim tjetër (*silogjizëm ose bashkëmendim*).

1661.1802. Shumica e pjesëtarëve të çdo brezi, deri në etapat e vona (aq më fort të hershëme) të zhvillimit njerëzor, do të kenë qenë jo gjithaq edhe gjuhëfolësa dmth. praktikuesa aktivë të të folurit, pra, formuluesa gjuhësorë të mendimeve vehtjakë sesa vetëm gjuhëkuptuesë dmth. njoftimmarrësa pasivë të kumtimeve gjuhësorë e, pra, riprodhuesë të mendimeve të tjetërkujt. Ende sot e kësaj dite, zotërimi aktiv dhe njohja pasive e cilësdo gjuhë, (e për pasojë edhe e gjuhës amëtare) janë gjithmonë mjaft të pabarabartë, jo vetëm tek të parriturit por edhe tek tashmë të formuarit. Më përgjithësisht, shenjdhënia është pakrahasim më e ndërlikuar dhe e vështirë sesa shenjmarrja, kështuqë askush nuk bëhet dot shenjdhënës pa u pasë bërë shenjmarrës.

1808. Me përvehtësimin e shkallëzuar të mjetit mbizotërisht gjuhësor për kumtimet midis individëve të të njëjtit kolektiv njerëzish, një e dhënë e vetme objektive ardhni gati kurdoherë e u bë kundranë e dy ripranishëmimeve rrënjësisht të tjetërlllojshëm: e ripranishëmimit *intelektologjik* të së dhënës objektive, dhe e ripranishëmimit *signologjik gjuhësor* të atij thjesht intelektologjik; - me çka nga njëra anë u dyfishua sipërfaqja ndërgegjore bashkëpranishëmenisht funksionuese e çdo individi, e nga ana tjetër zonat ndërgegjore alternativisht funksionuese të të njëjtit individ u shumëfishuan gati në pambarim nëpërmjet shkëmbimesh mendimorë me individë tjerë.

1852. Që të gjitha fjalët e çdo gjuhe *lakuese-zgjedhuese*, me të vetmin përjashtim të të pandryshueshëmeve të thjeshta, kanë nga një strukturë të analizueshme në togje tingulloro-kuptimorë. Dhe është pikërisht analizueshmëria tingulloro-kuptimore e shumicës dërmuese së fjalëve të çdo gjuhe lakuese-zgjedhuese që shpjegon entuziasmin akritik e madje rënien në ekstazë jo vetëm të shkrimtarëve diletantë të gjuhësisë por edhe të vetë gjuhëtarëve pa ndonjë formim signologjik përpara gjuhës njerëzore si përpara gjoja një mashtrimi të mrekullueshëm të organicitetit më rajonal e madje plasticitetit më artistik. Përkundrazi profesionistët e gjuhëve të përbëra nga fjalë të analizueshme vetëm tingullorisht, praktika e ideografisë qoftë së vetmjaftueshme qoftë së bashkëdyzuar me fonografinë duhet t'i ketë lënë të painfektuar nga kulti parshkencor e madje fetishizmi antifilozofik për "LOGOS"-in, *alias* për "FJALËN-ARËSYE" të mendimtarëve lashtogrekë, të cilët, duke mos u mjaftuar me perëndizimin e greqishtes, në mbarë gjuhët e popujvet fqinj nuk shihnin veçse "belbëzime" barbarësh!

1893. “koha e kaluar” dhe “e ardhshëmja” janë vetëm kohëra brendamendore *alias* jashtëlëndore. Si domosdoshmërisht e pakushtëzuar prej së kaluarës dhe së ardhshemes, deri e tashëmja është gjithashtu kohë brendamendore *alias* jashtëlëndore. Për pasojë, e kaluara, e ardhshëmja dhe e tashëmja, larg së qeni pasqyrime pasivë ndjenjimore të dhënash të gatshme lëndore, janë anasjelltas prodhime të mvehtësishëm të një mendimtarie shumëvijëra-vjeçare gjithënjëzore, e cila ka operuar e do të vazhdojë të operojë, jo pandërmjetshëm me vetë stërpak ndijimet e çastmbasçastshëm dhe të parikthyeshëm të të dhënave të gatshme të lëndës, por përkundrazi ndërmjetshëm me “gjurnat” e tyre brenda rikujtesës, praktikisht të panumërta, sepse të përruajtura dhe të mbishtuara brez mbas brezi, sidhe gjërësisht e ndryshueshmërisht të ribashkëpranishëmueshëme brenda ndërgjegjes.

2052. Nëse të menduarit shoqërohet domosdoshmërisht nga të ashtuquajturit të folur të brendshëm, vetë të folurit qoftë edhe të zëshëm qoftë vetëm të brendshëm nuk u përsjellka nga të gjestikularit e jashtëm? Pra, sikundër të miturit nuk shkruajnë dot pa tendosur njëkohësisht sa e sa muskuj pa asnjë lidhje me kryerjen e veprimit përkatës, ashtu edhe të rriturit, që të mund të mendojnë (*alias* të bëjnë të papranishëmen për shqiset të pranishme për mendjen) qenka e domosdoshëme jo vetëm të flasin brenda-përbrenda, por njeherazi edhe të gjestikulojnë jashtëpërrjashtë...

2120. Tri teza mbi çështjen gjuhësore:

1. Dy kryedialektet toskërisht e gegërisht të gjuhës shqipe procesi progresiv i konvergimit të tyre reciprok – filluar nga Gjon Buzuku, Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Frang Bardhi e Pjetër Bogdani; i ndërkëputur brutalisht nga Ejëll Radoja i rifilluar nga Kostandin Kristoforidhi, Sami Frashëri, Vaso Pasha, Luigj Gurakuqi, Aleksandër Xhuvani, Kristaq Cipo, Dilo Sheperi, Eqerem Çabej, Justin Rrota, Selman Riza etj; dhe i zyrtarizuar nga Konferencat gjuhësore të Tiranës (1952) dhe Prishtinës (1953) – i ka shndërruar mënëfund në dy variantet e sotëm të letrarishtes kombëtare shqiptare: në variantin jugor dhe jojugor.

2. Shqiptarët jojugorë variantin vehtjak të letrarishtes kombëtare më së sakti teorikisht dhe më së sigurti praktikisht do ta përvehtësojnë vetëm e vetëm nëpërmjet përvehtësimit të mëparshëm të variantit të saj jugor; - e vërtetë teoriko-praktike këjo që do të vlejë në një masë vër ... (???ndërprerë)

3. Qysh më se prej dy dhjetëvetshash e tëhu, në Republikën Popullore të Shqipërisë, varianti jugor po praktikohet me sukses si gjuhë zyrtare e Shte-

tit Shqiptar, më shkurt, si zyrtarishte shqiptare; - zyrtarishte këjo, tejshtirja e përgjithësuar e e përherëshëmuar e së cilës edhe në Kosovë do të jetë, në historinë e zgjidhjes së çështjes gjuhësore, një çfaqje e lartë homazhi spontan që pakicës gjuhësisht më meritore së kombësisë shqiptare do të bëjë shumica bujare e së njëjtës kombësi.

2157. Tri teza intelektologjike:

Me ende gjithënjë më të papërcaktuarit e koncepteve, siç janë p. sh. *kategorialiteti, qenia, mohimi* etj., filozofët, logjicianët dhe gjuhëtarët kanë operuar si me nocione tashmë prej kohësh të trajtuar në mënyrën më shkencore dhe përfundimtare.

Gati çdo filozof, logjician dhe gjuhëtar edhe atëherë kur ka pretenduar shprehimisht se po trajton një të tërë, në fakt ka trajtuar vetëm një pjesë të saj, e për më tepër vetëm atë pjesë të saj, ku ai vetë ka bërë ndonjë zbulim.

Gati çdo filozof, logjician dhe gjuhëtar ka pasur prirje të trajtojë sa më insistueshëm dhe specifikueshëm problemet sa më të paveshtirë, kurse anasjelltas të vështirët.

2187. Silogjistika e Aristotelit, larg së qeni ndonjë pjesë verevërte përbërëse e vetë teorisë së logjikës së tij është përkundrazi vetëm një *teknologji kazuistike*: teknologjia kazuistike nga njëra anë e *identifikimit konceptual* të të veçantave (jo të njohura më parë) me të përgjithshmet përkatëse, e nga ana tjetër e *eksplicitimit* njësitomendimor të një njësitimendimor të implicituar brenda një tjetri.

Gjithashtu “teoria” e konversionit aristotelian është përkundrazi vetëm teknologjia kazuistike e ndërkëmbimit subjekt-*kallëzues* (në fakt: *pjesë emërore e kallëzimit*) për të parë nëse kështu nga një njësitimendimor i vlefshëm del një tjetër qoftë barabar i vlefshëm qoftë aspak i këtitillë.

2200. Ndërsa intelektologjia do të jetë shkencë tërësore (inkuadruese) mbi vetë të menduarit ose ideuarit të realitetit nga njerëzimi, përkundrazi logjika prej më se 2000-vjetsh është shkencë pjesore (e inkuadruar) mbi vërtetësinë dmth. bashkëgjegjësinë e ideimit të realitetit me këte të fundit.

Nga Fletore III

2319.2360. I ashtuqëuajturi “redaktim” i një teksti tashmë të hartuar – në të vërtetën është një punë shumë më pak prej gjuhëtari sesa prej stilisti e sidomos intelektologu.

2363. Sintaksa (jo thjeshtë nomenklaturiste) është njëra nga paradhomat e stilistikës.

2373. Analiza prej nesh e *përkapjes* në *ndijim + ri(bashkë)pranishëmim* paraqet këta avantazhe:

a) shpjegon gjenezën ri(bashkë)pranishëmimit nga komponentja ri-(bashkë)pranishëmimore e përkapjes, e për pasojë mëvehtësimin funksional të ri(bashkë)pranishëmimit nga ndijimi;

b) për analogji me përmbetjen (persistencën) e mbresavet shqisoro-ndijimore dhe dobësimin e tyre kohësisht të shkallëzuar, përbën një fillim shpjegimi të fenomenit të kujtesës;

c) përbën një provë më shumë të tezës “sonë” mbi identitetin e rrymës ndërgjegjore për që të dyja veprimtaritë të ndijimevet dhe ri(bashkë)pranishëmimevet;

ç) zbulon arësyen e qenies të ndijimit në destinacionin e tij për t’u shndërruar drejtfilli në komponenten ri(bashkë)pranishëmimore të përkapjes, kurse ndërmjetshmërisht në vetë ri(bashkë)pranishëmimin;

d) mënjanon absurditetin e vështrimit të përkapjes si ndijim (jo i një ane së vetëme, por) i tërësisë së sendit;

dh) jep arësyen e kalimit nga përkapja e një ane së një sendi në ri(bashkë)pranishëmimin e tërë sendit;

e) mënjanon presupozimin e papranueshëm, simbas të cilit një përqëndrim sado i gjatë i resë mbi të njëjtin ngacmues shqisor, nëvendqë të japë alternativisht një numër ndijimesh dhe ri(bashkë)pranishëmimesh, dhënka një ndijim të vazhduarsuar.

2378. Duke mos zbuluar se ndijimet dhe ri(bashkë)pranishëmimet, si të thuash, ushqehen nga i njëjti superfluid ndërgjegjor, më saktë, ndërditjor, Bergsoni: ka operuar me dualizmin e pa qenë të “kujtesavet”, ka absolutizuar materialitetin e njëres dhe immaterialitetin e tjetrës, ka stërthekësuar ansamblizmin e ardhjebërrjës, ka përjashtuar tepër kategorikisht çdo ekzistencë sado relative të të qenurit etj. Pastaj, i njëjti filozof ka çpërfillur faktin evident se kujtesën e përbëjnë mbresat, vërte të çaktivizuara por ama të riaktivizueshëme, të aktivitetetevet ndërditjorë. Mënefund, duke mos pasë analizuar përkapjen në dy të sajat komponente ndijimore dhe ri(bashkë)pranishëmimore, e pra askuptuar se na të njëjtin ngacmues në të njëjtët çaste edhe e ndijojmë edhe e ri(bashkë)pranishëmojmë, gjithë po ky filozof nuk ka arritur të shpjegojë gjenezën e ri(bashkë)pranishëmimit si mvehtësim të komponentes ri(bashkë)pranishëmimore nga komponentja ndijimore e së njëjtës përkapje.

2379. Keqkuptimi i mohimit si mohim jo i *tërë një njësiti mendimor*, por vetëm i bashkëpërkatësisë së predikatit dhe predikandumit ka përbërë burimin e sa e sa jo vetëm tezave të veçanta të gabuara, por edhe doktrinave të përgjithshme të rreme.

Bota parmenidiane e qenësit (ens, 08), në fakt është bota “materialo-ideale” ende e paçdyfishuar në botën materiale dhe ate ideale a objektive dhe subjektive.

Për Parmenidin, kontradiktë përbën deri vetë shtruarja e pyetjes nëse predikati *takon* apo *nuk* takon predikandumit (simbas meje: nëse njësi mendimor primaro-naiv është për t’u pohuar apo mohuar e pra për t’u shndërruar në sekundaro-kritik).

2410. Vetëm atëherë kur një *fjale* qoftë së thjeshtë qoftë së pathjeshtë arrijmë, qoftë nga konteksti qoftë nga analiza, t’i gjejmë (të ashtuquajturin *kuptim*, në të vërtetën) *vlërën përshenjuese*, na lejohet të themi se e “*kuptuam*”; përndryshe, fjala ja *nuk* dihet ja *dihet*. Anasjelltas, *fjalìa*, si përshenjuese e një njësi të të menduarit, i cili normalisht përbën një kombinim të *pahasur më parë* elementesh mendimorë përkundrazi *tashmë të nxënë* edhe në vetëvehte edhe në fjalët përkatëse, ja *nuk* kuptohet (; - të moskuptuar këta, për shkaktimin e të cilit mjafton *mosditja* qoftë e vetë *një* elementi mendimor qoftë e fjalës përkatëse), ja *kuptohet* (; - të kuptuar këta që parkërkon ditjen e që të gjithë elementeve mendimorë dhe fjalëve përkatëse; - dhe ditje këjo, që jo kurdoherë mjafton për sigurimin e këtij të kuptuari si një veprim ripranishëmimor global i njëhershëm).

2442. E ashtuquajtura “paqartësi thjeshtë gjuhësore”, në analizë të mbrame, është *dy a mëshumë*–kuptueshëmëria e së njëjtës fjalë brenda së njëjtës fjali.

2515. T’ashtuquajturën *mënyrë të të shprehurit* mësëforti e përbën vetëm *lloji figurativ* a *krahasimor* i mjeteve të të kumtuarit.

2446.2519. Logjika “spontane” a gjuhësore, e realizuar jo pa variante në secilën nga gjuhët historike, dhe logjika “refleksive” a formale, e përpunuar në gjoja “shkencën e të menduarit rregullisht” – janë dy parshkencat vërtë të njëmbasjetërshëme por të përbashkëta të mbarë shkencave të veçanta.

Konceptet, të ndëralluar dhe ndër-renduar herë jo mjaft herë jo saktë, të logjikës spontane të gjuhëve historike – logjika formale e “shkencës së të menduarit rregullisht” i bën kundranë të një ndërallimi dhe ndër-rendimi të mëtejshëm më pak të paplotë dhe të pasaktë, duke lënë trajtimin e tyre pakrahasim më shterrues dhe rreptësues shkencave të veçanta, por pa lejuar këtyre të mbramevet çpërfilljen e rregullave vehtjake, si të një parshkence jo vetëm domosdo së përbashkët së që të gjithave, por njëherazi edhe barabar së detyrueshëme për secilën.

2573. Ndejtimet (e, pra, edhe gjykimet) karakterizohen nga tërësia e

konsistencës vehtjake, e jo nga ndonjëra prej gjymtyrëvet përbërëse. Prandaj, klasifikimit *logjik-sasior* të gjykimevet: në të përgjithshëm, të përdisashëm dhe të përnjëshëm i mungon çdo bazë shkencore dhe çdo dobi praktike. Aspak çuditërisht bashkëpalësi gjuhësior i logjikës sintetike *alias* sintaksa nuk njih kurrëfarë klasifikimi sasior të *fjalivet*.

2584. La *langue*, tout comme l'objet de n'importe quelle *signotechnie*, est (non une "substance" ni une "forme", mais) une activité *mentalo-matérielle*, ayant pur fin la communication médiante entre deux consciences (et non "l'organisation d'une *pensée chaotique* par une *matière amorphe*").²

2447.2734. Sihariq i parkohshëm i një punimi të ardhshëm :

TRE

KONTRIBUIME ALBANISTIKË

I. Shkronjat dhe *shenjëzat e tyre* – Drejtshkrimi dhe shenjëzat e tij.

II. Varianti i mbërthyer dhe i zbërthyeri të drejtshqiptimit.

III. 1. PARALELIZIMI, KONVERGIMI DHE INTEGRIMI NDËRKRYE-DIALEKTORË.

2. DOBISHËMIMI STILISTIK I NËNPJESËVET TË PAINTEGRUESHËME.

3. LAVRUESHËMËRIA E PAMBARIMTË E SHQIPTARISHTES SË MBAS-ÇLIRIMIT.

(me një brendaprimje polemiko-kritike)

2735. Punimi i ardhshëm "Tre kontribuime albanistikë" do të përbëjë një *rishikim ideopolitik* plus një *azhurnim tekniko-shkencor* të punimit (**hartuar këtu e plot tridhjetë vjet më parë**): "Tri monografina albanologjike".

2740. Dallimi i mangtë i ripranishëmimevet në: 1) "*ripranishëmime për-vehte-qendruet*" dhe 2) "*ripranishëmime për-jetër-qendruet*" duhet plotësuar kështu: 1) "*ripranishëmime të dhënash për-vehte-qendruese*", dhe 2) "*ripranishëmime të dhënash për-jetër-qendruese*".

2748. I dashmirësuari bashkëkrahinas,

Gjätë (apo? shkurt) vitevet të ardhshëm të jetës sime, të premttonj se *krahas* ushqimit të ambicionit për të hedhur themelet e parë "*Intelektologjisë*" dhe "*Signoteknisë*", do të ushqenj aspiratën që të mbetem *për ty*, nëmos edhe një shembull pozitiv, së pakti një mbrojtës i vendosur.

S. R.

² [Gjuha gjithë sikur objekti i çfarëdo *signoteknie*, është (jo "substancë" as "formë", por) veprimtari *mendoro-materiale*, që ka për qëllim komunikimin e ndërmjetshëm midis dy ndërgjegjeve (dhe jo "organizim i një të menduari kaotik nga një *matërie amorfe*)]

2777. Ndërsa “Gramatika” është vetëm *gramatikë* (dmth. vetëm “ri-mësuese” më drejtazi e tashmë e të nxënave dosido); përkundrazi “Fjalori” është *edhe* fjalor (dmth. mësues zanafillazi i ende të panxënave), *edhe* logjikë (makar vetëm e raporteve ndërkonceptore) *edhe* enciklopedi (makar nga më të kufizuarat). Prandaj, më së lart-ushtueshëmi, të brohorasim: (Ngordhshin Gramatikat!) Rrofshin Fjalorët!

2809. Vetëm atëherë kur e vetëm atje ku, vendi ynë nga e kaluara para çlirimit nuk kishte trashëguar gjë prej gjëje, partia e jonë, dashur pa dashur është nisur nga hiçi. Përndryshe edhe ajo trashëgimia më modeste është çfrytëzuar prej saj si një fillim i parë për t’u vazhduar e përkryer. Tani, kur dihet mirëfilli se “Fjalori i Institutit” doli në dritë plot dhjet vjet mbasçlirimit, atëherë pretendimi i A. K. për të zënë fill leksikografinë tonë vetëm nga vehtja e tij a nuk vjen e bëhet ende më i padenjë e madje më i dënueshëm?!

2854. “Këtu u *thā*, këtu u *lā*” ≠ “Këtu u *thā*, këtu u *lā*”. (Kr. “Këtu qe *thënë*, këtu qe *lënë*” – “Këtu qe *tharë*, këtu qe *larë*”).

2921. Selman Riza, më pak gjuhëtar sesa kritik gjuhësor, e ende më pak kritik gjuhësor sesa ekspert në redaktim...

[*Dy pasionet e jetës sime*]

3000. Dy pasionet (tejet heterogjenë, por barabar mbizotërues) të jetës sime kanë qenë:

GRAMATIKA dhe KOSOVA.

GRAMATIKA

Jo vetëm gjatë gjithë formimit tim shkollor, por edhe tërë kohërat mbas atij e deri më sot, Gramatika (jo e veçorivët të një gjuhe së vetme, por e përbashkësivët të një numri gjuhësh), me brenditë e saja teorike (paralelizuese gjuhësore, vërte vetëm të përafërta, por prapëseprapë paralelizuese të atyre të *Logjikës formale*), si edhe me shërbimet e saj praktikë (gjuhët e veçanta, deri ato të ashtuquajturat amëtare, e aq më fort të huajat, qysh u mësuan e u nxënëkan dot në mungesë të një teknologjie sado elementare mbi përgjithësitë e të folurit njerëzor, përfaqsim vërte *lloj-më-vehte*, por prapëseprapë përfaqësim i të menduarit po njerëzor) - kudo e kurdo më ka interesuar kaq gjallërisht, e tërhequr kaq pandërprerazi, saqë, në Ventotene, Loni Kristoja më pati mbiquajtur “Zonja Gramatikë”.

E qe familiarizimi gati gjymsëshkollor (si liceist, student, mësues, studiues e punues shkencor) me gramatikat tradicionale të një numri të mirë gjuhësh të veçanta, në gjendjen më së forti vetëm bashkëkohore, që më në fund më aftësoi për të tentuar nga njëra anë dy kritikantë jodiletanteske të *Logjikës së*

Aristotelit dhe Gjuhësisë sosyriane, e nga ana tjetër dy themelime joiluzorë të një “*Intelektologjie*” dhe të një “*Signoteknie*”. E që të dyja këto kritika dhe që të dy këta themelime për t’i tentuar në një punim të vetëm, lëndët e para dhe tezat kryesore të të cilit i kam tashmë të mbledhura dhe të formuluar; kësh-tuqë, siç tregojnë se paska thënë Zhâ Rasini për njëren nga tragjeditë e veta, këtë punim tani edhe mua “më mbetet vetëm për ta - shkruar”. E për ta shkruar, vetëkuptohet, jo si Rasini tragjedinë, për dy-tri javë përderdhesh të frymëzuara, por paksëpakti për katër-pesë vite distilimesh trunorë...

Ndërkaq, sa për të fiksuar idetë mbi fondin përmbajtësor dhe frymën metodologjike të të njëjtit punim, ja vetsioni i dytë i parthënies përkatëse:

“Në punimin e pranishëm, *veprimtaria e mendjes a të menduarit* nuk do të trajtohet vetëm në fazat e mbrame të formimit të vet, e pra vetëm në funksion të pyetjes së dyfishtë *nëse* dhe *prejse* një mendim është i parregullt apo i rregullt, i pavlefshëm apo i vlefshëm, i pavërtetë apo i vërtetë; - të menduar këta, të cilët, siç dihet, përbën kundranën praktikisht ekskluzive të *Logjikës së Aristotelit*.

Përkundrazi, aty do të trajtohet mbarë të menduarit, e pra të menduarit në që të gjitha fazat formative dhe në që të gjithë tipet funksionale të tij; - të menduar këta, të cilët autori ka synuar ta bëjë kundranë të një shkence, simbas atij, ende së paqenë: shkencës mbi MENDJEN a INTELEKTIN, të cilin ai prandaj edhe e ka emërtuar: INTELEKTOLOGJI (paroherazi përdorur prej tij në botimin: “*Fillimet e gjuhësisë shqiptare*”, Prishtinë, 1952).

Në të njëjtin punim, të folurit a *veprimtaria gjuhësore*, kundranë e *Gjuhësisë së përgjithshme*, ka për t’u trajtuar jo shkëputurazi nga trajtimi i llojeve tjerë të mjeteve të mundshëm për kumtimin e të menduarit, por përkundrazi bashkërisht me ata, brenda një disipline vërtë *kazualisht* (për të mos thënë: *aksidentalisht*) edhe shkencore, por *gjenetikisht* e, pra themelisht, vetëm teknologjike (e madje thjesht teknike) mbi SHENJAT (lat. *SIGNA*) ose *SIGNOTEKNË*, pagëzuar kështu nga i njëjti autor.

Pra, në këtë punim, Logjika e Aristotelit dhe Gjuhësia e përgjithshme do të trajtohen vetëm si dy pjesë përbërëse të Intelektologjisë dhe Signoteknisë, e pikërisht vetëm si Intelektologji *normative* dhe Signotekni *gjuhësore*, duke zënë ato aty nga një ndejtim aspak prioritar, dhe nga një hapësirë aspërsëlargu automatikisht mbizotëruese ndaj hapësirave të pjesëve tjera.

Tërë punimin e pranishëm e përshkon një e vetme tezë themelore: teza se veset organike e madje impotencat kongjenitale nga njëra anë të Logjikës, e nga ana tjetër të Gjuhësisë do të mundnin nëmos edhe të mënjanohej krejt, së pakti të reduktohen në minimum vetëm atëherë, kur:

së pari, këto dy disiplina më të ngushta të kenë gjetur inkuadrimet teorikë bashkëgjegjës dhe orientimet metodologjikë adekuatë në dy disiplina pakrahasim më të shtrira, e pikërisht Logjika në shkencën mbi mbarë të menduarit ose në Intelektologjinë, dhe gjuhësia në “tekninë” mbi të kumtuarit, me mbarë llojet e mjeteve të mundshëm, të të njëjtit të menduar ose në Signotekni;

së dyti, kur vetë këtyre dy disiplinave më të shtrira t’u jenë synuar saktë dhe zbuluar vlefshëm raportet reciprokë dhe karakteret komplementarë.

Dhe ka qenë pikërisht bindja e pashkulshme e autorit për vërtetësinë e rreptë e kësaj teze së tij që ka përbërë edhe stimulim më të fortë për të tentuar stërgximshëm, edhe mbështetjen më besnike për të vazhduar kryeneçshëm, ai, fillthi vetëm, hedhjen njëherazi të themeleve të parë të që të dyja këtyre dy disiplinave pakrahasim më të shtrira se Logjika dhe Gjuhësia. (vazhdon në dy orvatje [4]-[27]).

Në kuadrin e kësaj parthënieje, nga inovacionet e konceptonit tonë mbi të menduarit, po signalizojmë këta pesë:

1) *Të menduarit* është ajo veprimtari vërtë materialo-biologjikisht e kushtëzuar, por ama gjithandej prerazi mbas-materialobiologjike, e cila *pasqyron*, më saktë, *dublton (dublikon) modo sui generis*, më shkurt, *idiodublton*: fillimthi *vetëm* materialen, vazhdimthi *edhe* biologjikën, mbarimthi *deri* vetëvehten.

2) Këta të *idiodubluar*, në parim, nuk është asgjë tjetër veçse, e asgjë më shumë se sa pikërisht *të ripranishëmuarit e të papranishmevet*.

3) Gjenetikisht, edhe vetë *të ripranishëmuarit e të papranishmevet* paraqet vetëm *mvehtësimin* (jo krejt të pakushtëzuar) të komponentes ripranishmimore së ndijim-ripranishmimit (a *përkapjes*).

4) Në një masë gjërësisht të shkallëzuar por të pamungueshme, me çdo proces intelektualgjik, më saktë, intelektual është konkomitant përkatësi proces psikik; kështuqë të ashtuqajturit “të menduar (*pa tjetër*), në të vërtetën objektive, është përkundrazi një “të menduar (*të bashkëndier*)”.

5) Hipoteza eventuale se, krahas “të menduarit *për të jetuarit*” ekzistuese edhe “të menduarit *për të menduarit*” do t’ishite një iluzion intelektualistik, themi kështu, sepse të menduarit është tejrritje e të ndijuarit, të cilët (të ndijuar) tërë arsëyen e qenies mund ta ketë vetëm në të shërbyerit jetës. *Gjenetikisht*, të menduarit nenrendohet pra të “vullnetuarit” biologjik.

Asgjëmangu, *funksionalisht*, mendimi, sa çshoqërohet nga ndijimi, aq mund të pamvarësohet nga vullneti jetësor. Si rrjedhim, kur vullneti jetësor

(në vetëvehte nëmos edhe krejt i verbër, së pakti tepër i njëanshmuar nga stërngutja), nëvendqë.....

KOSOVA

Qysh në bangot e Liceut Kombëtar të Korçës, hyra, ende çunak, në polemikë me goxha Pater Ashikun, i cili, në një artikull programatik (botuar në gazetën “Shqipëria e Re” të Konstancës, Rumani, gjatë vitit 1930) mbi gjoja rishëndetshmimin e marrëdhënievet jugosllavo-shqiptare në emër kinse të solidaritetit ndërballkanik pati predikuar shpërnguljenn masive në Shqipëri e sidomos në Turqi të shqiptarëvet nga Kosova.

“Këtu po shënoj vetëm këtë detal stili së kundërartikullit tim, firmuar: “një djalë kosovar”, qe pikërisht anasjellja e pjesshme e vargut dantesk “Lasciate ogni speranza voi ch’entrate”, në “*Leni çdo shpresë ju që dilni*” – që i shërbente (nuk më kujtohet), edhe si *titull* apo vetëm si *motto*.

Kështu, unë qysh atëherë problemin kombëtar e ndërballkanik të Kosovës e bëra preokupim politik (jo numër *një*, por) *të vetëm* të krejt jetës sime.

As detyrës *elementare* për të mbrojtur (jo pa ndonjë vetërrezikim) kreditin *moral* të emrit *kosovar* mund të pohoj lirisht se kurrë nuk i kam bërë bisht.

Kundër një grupi të tërë (me në krye nipin e tërthortë të një majori legjendar) konviktorësh, që një “dezertim” nga ekipi *i ynë* i futbollit në të qytetit të Korçës pati revoltuar me të drejtë, por që pa të drejtë vendosnë të ndëshkojnë “dezertorin” me një të rrahur *shkinisht* faqe shokëvet, mora (vërte fillthi vetëm, por ama jo pa sukses) përsipër parmbrojtjen thjesht fizike të fajtorit – kosovar.

Në njërën nga ditët fill mbas 7 Prillit të 1939-ës, një oficer i ynë nga më të rinjtë, i dëshpëruar nga pushtimi i vendit, i turpëruar nga mosrezistimi i ushtrisë, dhe personalisht jo i pavarur në ndërgjegje për martesën me një italiane, ia hoqi vehtes në Leksovik për të vdekur mbas dy-tri javësh nga plaga në Korçë.

Në ceremoninë e varrimit, organizuar nga kaporionët italianë, por kryesuar nga kukllat “shqiptare”, me një pjesmarrje – për numër dhe përbërje – mizerabel të banorëvet të qytetit, një nga shokët e armëvet (të pazbrazura) të të ndyerit mbjati një fjalim...

Një fjalim, të cilin në e donje pa dinjitet moral, e kishe edhe kombëtarisht diskreditues: “*jò mosha e re, jò nervat e dobta, jò sentimentalizmi i tepëruar*”, jò tërt-mërt! Shkurt, një fjalim të konceptuar tamam sipas midesë së

kaporionëvet të huaj e kukllavet vendase; e (vetëkuptohet) të programuar si të vetmin e ceremonisë.

Ja përse, ende pa u pasë shuar mirë jehona e fjalisë së fundit së këtij fjalimi të kësaj fryme, katër ushtarë u turmë drejt arkivolit për ta ngritur nga blloku i gurtë i varrezavet myslimane e rivendosur mbi shtratin e topit.

Por unnë, bashkëkrahinasi (nëmos edhe i heroit, së pakti) i dëshmorit Xhemali Rexha – vigjëlonja. Me të parë se ç'po ndodhte, në çast ngrita krahun e, me një tingull zëri që më tromaksi edhe mua, klitha dy herësh me sa fuqi pata: “kam për të folur edhe unë! Kam për të folur edhe unë!” – Ushtarët, në pritje të një urdhëri të ri, shtangnë, duke mbajtur pezull arkivolin. Kaporionët dhe kukullat, vështro njëri-tjetrin në sy, e vështro mua me një copëz letër në një dorë jo krejt të padridhur, e me një fytyrë domosdo të prishur, e sidomos-sidomos me *babanë* dhe *nënë* të të përtuvarrosurit, të cilët – *në demonstrim solidarizimi* – më kishin marrë mu midis tyre. Më në fund, të njëjtët kaporionë dhe të njëjtat kukulla, dashur padashur, bënë (gati së toku) shenj ushtarëvet për të rilëshuar arkivolin mbi bllokun e gurtë...

Atëherë, unë, vërte me një zë të ngjirur, por ama me tonin e një të vetëbinduri dhe drejtshqiptimin pedant të një mësuesi, lexova faqen e vetme (*jo të fjalimit*, por) të *kundër-fjalimit* tim. Them: të kundërfjalimit: sepse tërë tekstin e këtij e përshkonte lajtmotivi e madje refreni “*situatë falco! Situatë falco!*”. E sepse, në konkluzionin e tij, atentati i gjakovasit kundër – jetës së vet jo vetëm njëhej si një akt i lartë moralo-etik, por njëherazi edhe si një gjest patriotik kuptimplotë: “*Nga një situatë falco një ushtarak i virtytshëm mund të dalë vetëm me një plumb në krahëror*”.

Provat më të vogla janë shkolla e më të mëdhavet. Tani për mua, ish-antifashistin disident sepse pikërisht irridentist kosovar, prova të një graviteti në çrritje qenë ato të tri periudhavit pa ndërvise: *korrik 1942 deri dhjetor 1944*, janar 1948 deri gusht 1951, dhe gusht 1951 deri dhjetor 1955.

Gjatë vitevet 1942-1944, do të riguxonj të shpall se *problemit nacional të Kosovës*, iu përkushtova vërevërte krejt së krejti: sa me mendje e ndjenja, dua të them, aq me shqisa e trup.

Se për zgjidhjen *plotësisht* shqiptare të këtij problemi *mprehtësisht* ndërballkanik e vetmja platformë e përshtatshme – atëherë (nënvizonj: atëherë) ishte domosdo ajo e “Irredentizmit kosovar”, këjo ide (simbas meje) imponohej vetiu. Por “Irredentizmi kosovar” datonte qysh prej Konferencës së Londrës 1913-s. Në konjunkturën e të dytit Konflikt Botëror, ai ishte evidentisht nevojtar prandaj duhej riaktualizuar si formë dhe rikonkretizuar si brendi në që të katër qëndrimarrjet e mëposhtëme:

a) Në qëndrimarrjen ndaj zgjedhjes së zgjedhjevet: me kë? Kundër kujt? – Kundër Boshtit Berlin – Romë! Me Bashkimin Sovjetik dhe Demokracitë e Perëndimit! Përse? – Për të dhënë edhe na kosovarët kontributin tonë të gjakut kauzës botërore së lirisë së popujvet. E, kësi kontribuimi, për të paragarantuar materialisht ushtrimin efektiv të së drejtës së vetëvendosjes;

b) Në qëndrimarrjen ndaj jurisprudencës ndërshtetërore, duke denoncuar me indignatë demagogjinë trathtarë të “Shqipnisë së Madhe”, por ama njëherazi – pa fe ndërgjegje së keqe – duke dobishmuar faktin e kryer nga tjetër-kush të shpartallimit të Jugosllavisë së vjetër, për t’u shpallur botërisht e ndër-kombëtarisht në shkëputje kryengritëse (secession insurrectionnelle) prej së njëjtës Jugosllavi, e njëherazi në gjendje kushtrimi kundër rikthimit eventual të dominacionit jugosllav të cilësdo kredo ideologjike dhe të cilitdo rend shoqëror (që të kishte);

c) Në qëndrimarrjen ndaj rrymave sociale dhe partivet politike brenda Shqipërisë, së likujtuar si shtet i pamvarur nga Italia (1939-1943), pastaj të pushtuar ushtarakisht nga Gjermania, duke mos u bërë na kosovarët as “*Bisht i Ballit*”, as “*Shtojcë e Frontit*” të Shqipërisë, por duke u vetëkushtetuar si *Lëvizje irredentiste* antifashiste e Kosovës, de facto së shkëputur nga shteti jugosllav por de jure ende gjithnjë e panjësushmuar me shtetin shqiptar; - vetëkushtetim ky dhe vetëshkëputje këjo, të cilët njëherazi do të shërbenin si qendër rrezatimi e bazë tubimi edhe për shqiptarët bashkëkufitarë të Maqedonisë e Malit të Zi, e

d) Në qëndrimarrjen ndaj grupimevet socio-politike brenda Kosovës: Rryma irredentiste antifashiste pamvarësisht nga rrjeshtimi luftarak dhe solidarizimi propagandistik pro Bashkimit Sovjetik dhe Demokracive të Perëndimit, kundër Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste, prapëseprapë dy çeshtjet të regjimit politik dhe rendit shoqëror në fazën e parë (nënvizonj: në fazën e parë) i përjashtoi nga platforma e vet me motivimin e dyfishtë nga njëra anë të prioritetit absolut të luftës kundër shtypjes nacionale ndaj luftës kundër çfrytëzimit shoqëror, e nga ana tjetër të mospargjykimit të një problemi, zgjidhja e të cilit takonte vetëm shtetasvet shqiptarë, me të cilët na kosovarët donim të njësisht-moheshim pa pyetur as për regjimin e tyre politik, as për rendin e tyre shoqëror.

Tani, këto vendimmarrje shkruesi i këtyre shënimevet vetëjetshkrimorë ende sot e kësaj dite i gjen sa adekuate secilën në vetëvehte aq edhe koherente të katra midis tyre.

Por qëndrimarrja e katërt duhet rrëfyer se vuante nga karakteri gjenetik dhe fryma atandiste.

Prandaj, mbas të parit takim që u mbajt (Prizren, ? janar 1943) e që

rezultoi inkonkludues e madje keqësues i raportit me Ramiz Sadikun në prani të Xhavit Nimanit, në të dytin takim (po në Prizren, vjeshtë 1943) me Xhavit Nimanin dhe Mehmet Hoxhën, vetëpërshekruesi duke shpërdorur asandanin personal ndaj bashkëdrejtuesave tjerë, vajti deri në pranimin e likujdimit të *Rrymës irredentiste antifashiste* në të mirë të krijimit të një *Fronti nacional-çlirimtar të Kosovës*, ideologjikisht, politikisht dhe organizativisht identik me dy partitë dhe me dy Frontet të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, por *botërisht dhe ndërkombëtarisht të pamvarur sa prej atyre shqiptarë aq prej atyre jugosllavë...*

Mbetjet e një jete së truar, padallim gjithë bashkëkombasvet të mi dëshironj të më prëhen atje ku kam lindur; në Kosovën shqiptare.

Tiranë, 23-XII-1973

Selman Riza

Nga Fletore IV

3024. Përfaqësimi *ideografik* a i *anës kuptimore* i të folurit në një gjuhë nëpër përfaqësimin e saj *fonografik* a të *anës tingullore*, ja i ashtuquajtur "drejtshkrim" i së njëjtës gjuhë.

3052. Të redaktuarit stilistikisht të të hartuarit me shkrim të të shprehurit gojarisht të të ripranishëmuarit mendërisht të të përkapurit shqisërisht të t'ekzistuarit objektivisht; nga këta pesë veprime pabarazisht të spikatur, por pamungueshëmërisht të bashkëpranishëm në përkatësen veprimtari kompozitokomplekse, tre të parët, duke u gjymtuar secili në tërësinë e vet, mundin mbizotërueshëmërisht të reduktohen në të vetëmit të hartuar, apo ende më skajshëmërisht, vetëm në të redaktuar; - të hartuar dhe të redaktuar këta, të cilët (për ndonjë mendues-kumtues jo-të-rëndomtë) nuk përjashtohet mundësia që të kryhen e madje përkryhen edhe pa ndihmën e përfaqësimit shkrimor të mendim-kumtimit. Por normalisht këjo ndihmë është rreptësisht e domosdoshëme, siç është lartësisht të këshillueshëm të improvizuarit gojarisht përpara të formuluarit me shkrim, apo (më përgjithësisht), të moscenuarit e tërësisë së procesusit formativ të asnjërit nga pesë veprimet e mendim-kumtimit.

3091. Vetëm themelimi i ardhshëm i dy shkencave komplementare:

I. MBI MBARË TË MENDUARIT ose *INTELEKTOLOGJI*, dhe

II. MBI TË KUMTUARIT E MBARË TË MENDUARIT ME MBARË LLOJET E MJETEVET TË MUNDSHËM ose *SIGNOTEKNI* – do të mund të mjekojë

dhe shërojë njerëzimin e kulturuar nga "murtaja kulturore" e *FETISHIZIMIT TË TË FOLURIT*.

3131. *Mësuesi nxënësit*: “Hartimi i yt është *shumë i mirë*; por mjerisht ke bërë *mjaft* gabime drejtshkrimi”.

Nxënësi mësuesit: “Si (!) të mos bënja, kur ju vetë na keni thënë se, **jo pak** nga “RREGULLAT E DREJTSHKRIMIT” janë përkundrazi “ÇRREGULLA ARËSYETIMI” ? !.

3238. Ndërsa *e para* gjymsë e një “kumtimi” a gjymsa e tij *dhënëse*, e pra tërë puna e kumtim-*dhënësit* përbëhet nga tri etapat: 1) ripranishëmim *për-vehte-qëndruës*, 2) ripranishëmim *për-jetër-qëndruës* (i ripranishëmimit *për-vehte-qëndruës*), dhe 3) materiallizim i ripranishëmimit *për-jetër-qëndruës*; përkundrazi *e dyta* gjymsë e të njëjtut “kumtim” a gjymsa e tij *marrëse*, e pra përsëri tërë puna e kumtim-*marrësit* përbëhet nga tri etapat: 1) përkapje e të njëjtut materializim si *për-vehte-qëndruës*, 2) ripranishëmim po i këtij materializimi si *për-jetër-qëndruës*, dhe 3) kundër-ripranishëmim i ripranishëmimit *për-vehte-qëndruës* (të kumtim *dhënësit*).

3247. Shkenca mbi *prejardhjen (e parë) të fjalëvet (të thjeshta) a etimologjia* – në fakt është *arkeologjia gjuhësore* me mbipengimin e mungesës gati së plotë së dëshmivet materiale.

3257. *Figura (joartistike), simboli dhe shenja* janë mjete materialë që riprodhohen (jo për vetë-vehte, por) për këtë që, të marrur: 1) në ripranishëmimet e tyre mendore, 2) në vetëvehte dhe 3) në përkapjet e tyre po mendore, të shërbejnë si ndërmjetës në tejdhënien e mendimevet nga një ndërgjegjje në tjetrën.

La figure (non-artistiques), le symbole et le signe sont des moyens matériels qu'on reproduit (non pas *pour eux-mêmes*, mais) *pour que*, pris conjointement: 1) en leurs représentations mentales, 2) en eux-mêmes et, 3) en leurs perceptions derechef mentales, ils servent d'intermédiaires dans la transmission de la pensée d'une conscience à l'autre.³

3260. *shenj* = dublim *material* i dublimit *ideor* të një së dhëne, i cili, nëpërmjet njëranazi ripranishëmimit, tjetranazi përkapjes-mendore përkatës, mundshëmon tejçuarjen e mendimit nga njëra ndërgjegjje në tjetrën.

3264. Kategorizimit parorendas (primordiale) të fjalëvet, si elemente të pamvarësuar a *leksema* vjen e i mbindejtohet kategorizimi i tyre dytorendës, si gjymtyrë njësitësh a *sintaksema* duke shpënë kështu në kategorizimin e tyre tradicional gjoja unitarist si “*pjesë të ligjëratës*”, në fakt dualist si “*farë*

³ [Figura (jo-artistike), simboli dhe shenja janë mjete material që riprodhohen (jo për to më vete, por) që, të marrë bashkarisht: 1) në përfytyrimet e tyre mendore, 2) më vete dhe në perceptimet e tyre sërish mendore, ata shërbejnë si ndërmjetës në pransmisionin e tyre nga mendimi I një ndërgjegjje në tjetrën].

fjalësh plus pjesë të ligjëratës”, e madje thërris si “*farë fjalësh plotësisht gjuhësore plus farë fjalësh mbizotërueshëm gjestore plus pjesë të ligjëratës*”.

3268. Çdo “*shenjë*” është një bashkëgjegjësim a idiodublim – *material*, vërte *zanafillazi* pak a shumë *ngjashëmues*, por *mëpastaj*, si rezultat thjeshtësimesh spontanë e *ende më vonë* si produkt tjetërsimesh të vullnetshëm, plotësisht i mirakandshëmuar: i një së dhëne a së nxjerre *objektive* qysh-më-parë së idiodubluar mendërisht, me, si destinacion së stërklashti ekskluziv, ndërmjetshëmi-min tri fazash: mendoro-ripranishëmimor, materialo-riprodhues dhe mendoro-përkapjor, të tejdhënies së një mendimi nga një ndërgjegjje në një tjetër.

3273. Deri numri i madh dhe rëndësia serioze të pjesëvet të nënkuptuara në çdo kumtim gjuhësor flet fort për pathemelësinë e tezës idealistiko-materialistike se “mungesa e të folurit – në vetëvehte pa asnjë bashkëgjegjësi me të menduarit – pamundësuaka ekzistencën e të njëjtit të menduar – në vetëvehte “pasqyrim” i të ekzistuarit objektivisht”.

3274. Është gjithë gjasa se tezës lashtësinore mbi “*organizimin gjuhësor të mjegullnajës mendore*” do të kenë dhënë shkas nga njëra anë specifikat gjoja thjesht gjuhësore në fakt pastërtisht mendore të ethnos-ëvet të veçantë, e nga ana tjetër ripërkijtjet e disallojshëme të një brendie ndërgjegjje nga ana e kumtimdhënësit të saj për ta “*kondicionuar*” simbas veçorivët individiale të njoftimarrësit përkatës.

3276. “(Dans cette école linguistique à la méthode exclusivement comparative) On considérait la langue comme une sphère particulière, un quatrième règne de la nature” (F. de Saussure, *Cours de linguistique générale*, p. 17): (= Gjuha vështrohej si një sferë e veçantë, si një mbretëri e katërt e natyrës):

Komentim

Është bindje e kahershëme e shkruesit se *së pari* tri mbretëritë të “*mineralevet*”, “*bimëvet*” dhe “*frymorëvet*” të ndarjes tradicionale të natyrës janë për t’u reduktuar në dy mbretëritë të “*mineralevet*” dhe “*bimë-frymorëvet*”; *së dyti* se këjo ndarje e “*natyrës*” duhet plotësuar me bashkëpërfshirjen edhe të “*kulturës*”; dhe *së treti* se dy lëndëvet të “*mineralogjisë*” (për “*fizikë-kiminë*”) dhe “*biologjisë*” janë për t’u mbishtuar dy objektet të “*intelektologjisë*” dhe pikërisht “*signografisë*”...

Në kontekstin e këtyre tre rektifikimeve të “ndarjes tradicionale së natyrës në tri mbretëri”, vështrimi (nga shkolla krahasuese e indo-europianëvet) i gjuhës si një “mbretëri e katërt” e natyrës – a nuk përbën një si intuicion, vërte nga më kazualët por njëherazi edhe nga më profetikët, të domethënies aq larg-

vajtëse së “gjuhës” → (të komunikativistikës) për fatet kulturorë të mbarë një-rëzimit.

3278. “Drejtshkrimi i zanoreve”, “Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve”, “Shkrimi i *j*-së”, “Shkrimi i bashkëtingëllores *h*”; “Shkrimi i nyjës së përparme” (*Rregullat e drejtshkrimit të shqipes*, f. 7, 35, 39, 44, 64).

Nëse fjalët e një gjuhe tashmë *së shkruar* mundin të shtrojnë praktikuesvet të saj *probleme drejtshkrimi*, përkundrazi *që të gjithë tingujt* e tyre është e mundshme të bëhen vetëm *objekte shkrimi* nga ana e tyre.

Sigurisht, me problemin *drejtshkrimor* të një fjale lidhet përfaqësimi *thjesht shkrimor* i secilit nga tingujt e saj.

Asgjëmangu, ndërsa përfaqësimi *thjesht shkrimor* i mbarë një fjale përbën edhe *drejtshkrimin* e saj ; anasjelltas përfaqësimi *thjesht shkrimor* i secilit nga tingujt e saj përbën vetëm *shkrimin* e tij.

Kështu, nëse do t’ishte shkencore të mendohet dhe logjike të thuhet “këjo fjalë është *shkruar jo-drejt* ; sepse, në shkrimin e saj njëra nga shkronjat përkatëse (ose është *shkëmbyer me një tjetër shkronjë*, ose) *ka mbetur pa u shkruar*”, anasjelltas do t’ishte absurde të mendohet, dhe qesharake të thuhet : “në shkrimin e kësaj fjale njëri nga tingujt e saj është shkruar *jo-drejt*, sepse *mungon fare*”...

Le të konkludojmë :

Në botimin e lartcitur, *Drejtshqiptimi* real i tingujvet të shqipes letrare, në kundërdallim nga *drejtshqiptimet* e tyre në dialektet e saj, është shkëmbyer me *drejtshkrimin* e tyre në fakt të paqenë, e pra është keqkonceptuar dyfish.

Në të njëjtin botim, konceptim-formulimet : “*Drejtshkrimi i zanoreve*” dhe “*Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve*” janë për t’u rektifikuar në konceptim-formulimet : “*Drejtshkrimi i fjalëve përkiturazi me zanoret*” dhe “*Drejtshkrimi i fjalëve përkiturazi me bashkëtingëlloret*”.

Për hir të së vërtetës, duhet vërejtur se poaty për tingujt *j* dhe *h* formulim-konceptimit joadekuat “*Drejtshkrimi etj.*” ka zënë vendin adekuati “*Shkrimi etj.*”.

Anasjelltas, në vend të “*Shkrimi i nyjës së përparme*” pritej “*Drejtshkrimi etj.*” ; sepse *nyja* edhe atëherë kur përbëhet nga një tingull i vetëm, është fjalë, e jo tingull.

3280. Për *variacionin shprehjor* të të njëjtit material duhen çfrytëzuar që të tria “sinonimitë” : 1) *leksematike*, 2) *morfematike* dhe 3) “*frazematike*”.

3290. Për të ngulitur radhazi : 1) *drejtshqiptimin*, 2) *drejtshkrimin* të

shqiptarishtes së mbasçlirimit është e domosdoshëme që të nisemi jo nga *regjistrimi i vetëm i trajtës themelore së një fjale së ndryshueshëme*, por përkundrazi nga *shqyrtimi krahasues i mbarë paradigmës përkatëse*.

3295. “Dy shkencat komplementare mbi të *Menduarit* dhe të *Komunikuarit* e tij ose *Intelektologjia* dhe *Noometadotika*” = “Les deux sciences complémentaires sur là *Pensée* et sa *Communication* ou bien l’*Intellectologie* et la *Noométagotique*”.

3296. Të ashtuquajturit të *folur të nyjëtuar* në të vërtetë është : 1) të *këngëtuar*, 2) të *folur* dhe 3) të *bashkëgjestikular*.

3297. Ndësa *noometadotika* ka për objekt të tejdhënët a të komunikuarit të të menduarit nga një ndërgjegjje në tjetrën, *signografia* (emërtim vehtjak ky, të cilin na parpëlqejmë terminin sosyrian “*semiologji*”) përbën studimin e *shenjave*, dmth. të llojeve të ndryshëm të mjeteve *materialë*, të cilët së *toгу* me ripranishëmimin dhe përkapjen vërte *vehtjakë* por ama përjetër-qendruës mundshëmojnë të komunikuarit e *njëkahjeshëm* midis një ndërgjegjjeje *tejdhënëse* dhe një a më shumë ndërgjegjesh *rimarrëse*.

3298. Konceptimi *joadekuat* e madje *keqkonceptimi frontal* i funksionit *noometadotik* të “shenjit” ka shpënë idealistin filozofik F. de Sosyryn që nga togu mundshëmues të të komunikuarit midis ndërgjegjtor të një kahjeshëm: *ripranishëmim i shenjit* plus vetë *shenj* plus *përkapje e shenjit* të eliminojë pikërisht vetë shenjin, me rezultatin paradoksal të cilësimit të tij si thjesht “psiqik”, e pra me tezën absurde se të menduarit u komunikua vetëm e thjesht mendërisht.

3299. Anasjelltas, stërvlerësimi *materialist* i rolit të “shenjit” *material* ka çuar deri tek tezat vulgare se të komunikuarit gjuhësor të të menduarit dhe këta të fundit, gjithë duke qenë të dallueshëm midis tyre, qenkan domosdoshmërisht të bashkëpranishëm njëerët me tjerët ; kështuqë të menduarit e *pakomunikuar* jo vetëm që nuk ekzistua fare, por as që paska mundësi të ekzistojë kurrë -

3300. Hipostatizimi i të komunikuarit *shenjor* të të menduarit ka shpënë edhe tek pamvarësimi absolut i *kuptimit* nga *koncepti*, e pra tek dualizmi “semantiko-konceptual” kundërshtencor : 1) *kuptim i fjalës* dhe 2) *koncept i sendit*, duke u argumentuar këto dy teza, midis tjerash, me dy palë konstatimet se një fjalë mund të ketë mëse një kuptim, ndërsa një sendi i takon një koncept i vetëm, dhe se këtij apo atij kuptimi të kësaj apo asaj fjale mund të mos i përgjigjet asnjë koncept i realitetit objektiv...

3304. Ai i “shenjit”, të *marrur vetëm*, është koncept parshkencor :

koncept *shkencor* është ai i “shenjit” të marrur së togu këndeje me ripranishëmimin, andej me përkapjen të tij ; sepse është pikërisht ky ndërmjetshëmim *grosso modo* tri etapash që mundshëmon mrekullinë e mrekullivet *alias* tej-cuarjen (e ndërmjetshëmuar) të të menduarit nga njëra ndërgjegjje në tjetrën.

3322. Kundërndejtimit jo logjik (e aq më pak shkencor): 1) “*Gjuhësia e përgjithshme*, dhe 2) *gjuhësia historike*” duhet të zërë vendin, ai logjik: “1) *Gjuhësia e përgjithshme* (me dy degët: përshtkruese e gjendjevet, dhe rindërtuese e zhvillimevet) dhe 2) *gjuhësitë e veçanta* (secila përsëri me dy degët përkatëse).

3320. Çdo “shenj” është një “*ish-figurim*” ndërkohësisht (më saktë : *ndër-epokalisht*) i *arbitrarizuar* i një sendi.

3322. Kundërndejtimit kryekëputshëmues : “*sinkroni : diakroni*”, duhet të zëjë vendin dallimi relativ : “*sinkroni e pakrahasuar* : dhe *sinkroni e krahasuar*”.

3323. Në asnjë gjuhë, asnjë gjendje (sado njëçastshëmërisht) *sinkronike* nuk është përkaq edhe *unisistematike*.

3324. Studimi i sinkronivet të *së kaluarës* mund të shërbejë : ja për leximin e tekstevet përkatës, ja për ndriçimin të sinkronisë krahasues së të tashmes në çfaqjet e saj *asistematike* a *reliktore*.

3325. Deri gjuha me një strukturë nga më sistematiket, larg së përbëri një sistem të vetëm, përkundrazi përbëhet nga aq sisteme sa janë paradigmat e saj kategoriale.

3326. Një gjuhë është aq *sistematike* sa është sistematik tipi mendimor a mentaliteti i përdoruesvet të saj.

3327. E ashtuquajtura nga Humboldt-i “*frymë a formë e brendshme*” e një gjuhe në të vërtetën është “*mënyra qoftë (më posaçërisht) e të perceptuarit, qoftë (më përgjithësisht) e të menduarit*” e popullit përkatës.

3328. Lulëzimin më përgjithësisht të *semiologjizmit*, më posaçërisht të *linguisticizmit* do ta ketë sjellë funksionimi më se 2000 – vjeçar i *Logjikës* a normativë e të menduarit si *Intelektologji* a shkencë e të njëjtit të menduar.

3331. E përtutransmetuara (nga një ndërgjegjje ne tjetrën) brendi ndërgjegjore nëvendqë të jetë kurdoherë ide e *një sendi*, mund të jetë edhe ide e *një jo-sendi*.

Së sipërmi del qartë pambrojtshmëria e tezës realo-naive (për të mos thënë : *vulgare*) se “shenji shenjuaka (jo idenë e sendit, por) *vetë sendin*” !?

3332. Shkrimtari-mendimtar (e aq më fort *prozatori shkencor*) më parë vrazhdëson deri strukturën e gjuhës sesa të cënojë saktësinë e mendimit.

3334. Ferdinand de SAUSSURE semiologue des *mauvais départs* et linguiste des *fausses arrivées*.⁴

3355. *Signe* = manifestation matérialisée du stade et *final de l'émission* et *initial de la réception* de tout acte de communication de la pensée.⁵

3356. Hedhja (makar ende jo plotësisht e përgatitur) e themelevet të parë një “komunikativistike” a shkence mbi të komunikuarit të të menduarit, ja e vetmja mundësi reale për të shporrur tre rrezikimet aspak fiktivë :

i. të shkarjes së “*linguistikës*” në “*linguisticizëm*”,

ii. të çfytirimit të “*koncepteve të sendeve*” në “*kuptimet e fjalëve*”, dhe të çoroditjes së “*gjuhës njerëzore*” në një “*fetish fetar*”.

3358. Une unité *linguistique*, c'est une suite *de sons* que profère A en s'adressant à B pour lui faire part d'une unité *de pensée*, A et B étant (cela devrait aller de soi) coïncités au même système linguistique (de communication de la pensée).⁶

3369. “*kuptim* i një *shenji*” = “*koncept* - tashmë, nëpër këtë shenj, i jashtësuar nga një ndërgjegje për t'u rikapur nga një tjetër – i një *sendi*”

3370. *Semantika* është sekundare ndaj “*konceptikës*”, e cila në radhën e vet, ka për primare “*objektikën*” (Sa për – *ikë*, krah. *domesticus*, *publicus*, *rusticus* etj.).

3371. Studimi i *semantikës* shkëputurazi nga ai i *konceptikës*, dhe studimi i *konceptikës* barabar pandërlidhurazi me atë të *objektikës* janë dy rre-studime.

3375. Me shpërkumtuar denuncuar i pari keqbërjet e “*linguisticizmit*”, ja tërë ambicja e ime si linguist paskëtaj.

3378. Stërvlerësimi social e gati fetishizimit filozofik të *gjuhës së folur* do t'u kenë dhënë shkas meritat e pamatshëme të *së shkruarës*, e cila jo vetëm që ka rrjedhur drejtfilli nga *ideografia*, por ende sot e kësaj dite përbëhet nga një kombinim frontal i *fonografisë* me të njëjtën *ideografi*.

3391. Nga “*toskërishtja e kulluar*” si letrarishte e Shqipërisë – në “*toskërishten e pakulluar*, si *bazë dialektore* e shqipes letrare”; e nga këjo – në “*shqipen letrare të bashkëveprimit ndërdialektor*”, ja tri etapat më kryesore të shqiptarishtes së mbasçlirimit.

⁴ [Ferdinand de saussure semiolog i *fillimeve të këqia* dhe *gjuhëtarë i arritjeve të gabuara*.]

⁵ [Shenjë = manifestim i materializuar i stadit edhe final të emetimit edhe nistor të perceptimit të çdo akti të komunikimit të të menduarit.]

⁶ [Një njësi *linguistike* është një rrjedhë *tingujsh* që prodhon A duke iu drejtuar B për t'ia bërë pjesë një njësi të *menduarit*, A dhe B duke qenë (kjo do të duhej të kuptohej vetiu) të bashkiniciuar në të njëjtin sistem linguistik (të komunikimit të të menduarit)]

3403. *Intelektologjia dhe Komunikativistika ose Signografia* (emetivo-receptive) -. Nga tri hallkat: 1) *mendore e parë*, 2) *materiale e vetëme*, dhe 3) *mendore e dytë* të konceptim - emetimit dhe receptimit të komunikimit të të menduarit është pikërisht hallka e mesëme thjesht materiale ajo që përbën SHENJIN.

3410. Secila nga brenditë e njëmbasnjëshëme të një ndërgjegjje individuale mund të jetë: ja vetëm ndijimore a *psikologjike*, e, si e këtyllë e jashtësueshëme drejtfilli si objekt i një produkti arti; ja vetëm ripranishëmimore a *intelektologjike*, e si e këtyllë e komunikueshëme tërthorazi dmth. nëpërmjet këtyj apo atij sistemi shenjor social; ja njëherazi psikologjike dhe intelektologjike.

Në rasën e tretë (që është më e rëndomta) konceptues-emetuesi i një komunikimi (të tërthortë) nga dy komponentet psikologjike dhe intelektologjike të një brendie ndërgjegjjeve objekt komunikimi bën vetëm komponenten e saj intelektologjike; kështuqë komponenten psikologjike të së njëjtës brendie ndërgjegjjeve receptuesi i komunikimit: ja e intuon nga interpretimi i komponentes intelektologjike, ja e ignoron krejt.

3411. *Komunikativistika ose Signografia emetivo-receptive* (shih 3403)

a. Një shkencë e vetme nuk mund të ketë për objekt *unitar* operimet e *anasjelltë* të dy ndërgjegjjeve *individuale*. Por emetimi i një komunikimi përkërkon receptimin e të njëjtit komunikim e madje kondicionohet nga ky receptim.

b. Operimet e dy ndërgjegjjevet janë jo simetrikisht por asimetrikisht të anasjelltë. Edhe me të vërtetë, ndërsa emetimi adekuat i një komunikimi përkërkon konceptimin e plotë të këtij të fundit e rrjedhimisht përbën një konceptim-emetim, anasjelltas receptimi i komunikimit është vetëm receptimi i këtij të fundit.

c. Ndërsa aftësimi për të koncepto-emetuar komunikime bashkëbart edhe atë për të receptuar komunikime – në bazë të të njëjtit system signografik a kod; përkundrazi, tashmë i aftësuar për të receptuar është ende jo-i-aftë për të koncepto-emetuar.

d. Vërtë hallka e mesme materiale e komunikimit bën pjesë edhe në konceptim-emetimin si pikëarritje e këtij, edhe në receptimin si pikënisje e këtij; por ndërsa shenjtit të pa njohur receptuesi mund t'i gjejë kuptimin në repertorin përkatës; përkundrazi shenjin e konceptit për t'u emetuar konceptues-emetuesi mund ta gjejë vetëm në kokën e vet.

e. Stukturën e sistemit signografik konceptues-emetuesi i komunikimit mund, dashur padashur, edhe ta ndryshojë e madje ta tjetërsojë në ndonjë njësi a pjesë të saj; mundësi këjo, të cilën receptuesi nuk e ka.

f. Ndërsa emetuesi i komunikimevet riprodhon materialisht shenjat përkatës tashmë të ripranishëmuar mendërisht edhe në funksionet edhe në qeniet e tyre po prej atij, anasjelltas tërë puna e receptuesit të të njëjtavet komunikime është thjesht mendore, sepse qëndron vetëm: 1) në përkapjen e shenjave të emtuar, 2) në ripranishëmimin e domethëniet përkatëse.

g. Ndërsa ripranishëmimi mendor dhe emetimi material i shenjave të komunikimit përbëjnë një veprimtari *mendoro-materiale*, objekti i një discipline shkencoro-teknike; anasjelltas veprimtaria vërtet e dyfazshme por thjesht mendore e receptuesit të shenjave të komunikimit përbën objektin e një discipline pastërtisht teknike.

Në konkluzion, komunikimi i brendivët ndërgjegjore nga një individ tek tjetri në bazë të të njëjtës sistem signografik a kod – poshtë lart ekzistojnë aq arsye *pro* sa arsye *anti* që të përbëjnë objektin qoftë të një shkence së vetme për t’u quajtur p.sh. *komunikativistikë*, qoftë të dy shkencave të mëvehtësishme për t’u emëruar p.sh. *emitivistikë* dhe *receptivistikë*.

Në këto rrethana, shkruesi i këtyre rrjeshtave, parpëlqen zgjidhjen monistiko-dualiste të një *signografie emetivo-receptive* e pra të një signografie; së çdyfishuar në një *signografi emetive*, dhe në një *signografi receptive*.

3433. Në punimin e projektuar “*TRE MATERIALE ALBANISTIKË*”. është tërë shpresa se *lavrimet artizanal të letrarishtes shqiptare* do t’i këndohet duaja, e fundit.

3327.3438. Autor i vërtetë i “Alfabetit të Stambollit“ kush ka qenë: Jani Vretoja, siç nuk dihej para studimit të A. Uçit; apo Sami Frashëri, siç vazhduaka të besojë M. Domi?

Pa hyrë në thelbin e kontroversës, mua të zhgënjyerit të krejtshëm nga i njëjti alfabet, por admiruesit frontal të Samiut, do të ma kishte fort ënda që, në të ardhshëmën, interpretimi i jo-gjuhëtarit të ngadhënjë mbi atë të mezi lingvistit...

3459. “Na duket, ndërmjet atyne dy polevet të kombit qi janë gega e toska, se i pari perban ma tepër landën, brumin e shqiptarit dhe i dyti, trajtën, frymën. Dhe në se gjejmë ma të madhin përfaqësues të gegnis te Fishta, ndeshim kulmin e faqes tjetër jo te Naimi, jo te Noli, por te Konica”, Arshi Pipa.

3465. E ashtuquajtura “*gjuhë e shkruar*” a “*përfaqësim shkrimor i të folurit patjetër*”, në të vërtetën rreptësisht kategoriale, është përkundra një kombinim sui generis i përfaqësimit shkrimor të të menduarit me përfaqësimin po shkrimor të të folurit; e pra “*një integrim kompozit i ideografisë me fonografinë*”.

Keqkonceptimit kategorial të “ideografi-fonografisë” si “fonografi e vetëmjaftueshëme” do t’i ketë dhënë shkas konstatimi vulgar i mbizotërimit vërtë shumë të gjërë por ama thjesht sasiore të komponentes fonografike mbi ato ideografike.

Tani, meqenëse edhe vetë të folurit është përfaqësim i të menduarit, e ashtuquajtura “gjuhë e shkruar” – kategorialisht rezulton të jetë përfaqësim pjesërisht i drejtfilltë pjesërisht i tërthortë i të menduarit.

Konkluzionet e sipërm i përforcon më tej e vërteta e njohur se, në historinë e kulturës, fonografia ka lindur nga ideografia.

3477. Disiplina – që lashtë dhe riogramatikanet kryesisht gjermanikë instauruan me aq gjenialitet si lëndë dhe përpunuan me aq durim si metodë gjatë tërë shekullit të kaluar – e ETIMOLOGJISË *REKONSTRUKTIVE* e si e këfillë, largësisht gjenealogjike dhe gjërësisht ndërgjuhësore, e pra shumë më tepër hipotetike dhe elitiste, sesa pozitive dhe masive, tashmë – në shekullin tonë, të krijimit dhe përpunimit të disiplinës kryezotërueshëm pikërisht johistorike të GJUHËSISË SË PËRGJITHSHËME – ka ardhur koha që të ridimensionohet rrënjësisht në rilevancën të shpërpjesëtuar e madje prestigjin të uzurpuar në të mirë të konceptionit dhe praktikës lashtogrekë të një ETIMOLOGJIE vetëm *ANALITIKE*, e pra ngushtësisht njëgjuhësore dhe plotësisht së vetëmjaftueshme të gjuhës së dhënë me dy funksionet barabar madhorë nga njëra anë të dallimevet konkretë të strukturave të thjeshta prej të pathjeshtave, e nga ana tjetër të analizimevet të këtyre të fundit në të thjeshtat përkatëse.

3489. Shtatë llojet e komunikimit ndërindividual të brendivët ndërgjegjore:

1.komunikimi nëpërmjet manifestimevet *spontanë* të konkomitancave fiziologjike të brendivët ndërgjegjore, objekt i komunikativistikës *ekspresive*;

2.komunikimi nëpërmjet pozave dhe gjesteve me karakter *imitues* të trupit vehtjak, objekt i komunikativistikës *mimetike*;

3.komunikimi nëpërmjet *pseudo-riprodhimit* material, objekt i komunikativistikës *pseudo-riprodhuese-materiale*;

4.komunikimi nëpërmjet *ideofigurimevet* (a ideopiktorimevet), objekt i komunikativistikës ideopiktorike a *ideofiguruese*;

5.komunikimi nëpërmjet *ideoshenjtivevet* a ideogramevet, objekt i komunikativistikës *ideoshenjtuese* (a *ideografike*);

6.komunikimi kompozit (ekspresivo-mimetiko-shenjues) nëpërmjet të *gjuhës së folur*, objekt i komunikativistikës *gjuhësorofoljore* (a *vokolin-*

gue); dhe komunikimi ultrakompozit (ideoshenjtuës a ideografik dhe zanoroshenjtuës a fonografik) nëpërmjet *gjuhës së shkruar* a *gjuhësoroshkrimore* (a *scriptolingue*).

3499. Unë, tashmë 64–a 65–vjeçari, nga jeta (kinse e imja) nuk kërkonj më shumë se 4–5 vite tjerë: nëmos edhe për të stilizuar së pakti për të hartuar si brendi, e madje së stërpakti për të konspektuar specifikuëshëm këta tre punime:

7. *Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme;*

8. *Nga Logjika dhe Linguistika në Intelektologjinë dhe Komunikativistikën;* dhe

Tre materiale albanistikë : HISTORIA – NORMAT – LAVRIMI TË SHQIPTARISHTES SË MBASÇLIRIMIT.

3535. *Diferencimi stilistik i shqiptimit* letrar plus fonetizimi i plotë i Alfabetit të gjuhës shqipe – do të shpinin gatigati vetëvetiu në fonetizimin barabar të plotë edhe të Drejtshkrimit të saj.

Nga Fletore V

3585. Secilëndo gjuhë në radhë të parë e përbëjnë jo trajtat e fjalëvet, por vetë fjalët : këtë vërtetësi a nuk e evidentizon rasi e skajshme e gjuhëvet të pajosura jo edhe me trajta fjalësh, por vetëm me fjalë ?

3592. Kush kodifikon fenomenin sekundar, sepse grafik, të “*ndarjes së fjalëvet në fund të rreshtit*”, ka kodifikuar njëherazi edhe fenomenin primar, sepse fonetik, të “*strukturës së tyre rrokjore*”, - komponente këjo nga më themeloret të “*përbërjes po fonetike*” së të njëjtavet fjalë.

3573.3617. Me një përjashtim të vetëm : atë të parpranimit të vullnetshëm nga qendroro-veriorët të *rotacizëm-çhundorizimit* të jugorëvet, shqiptarishtja e mbasçlirimit veçoritë fonetiko-gramatikore cilitdo prej dy *kryedialektevet* tanë letrarë të *paraçlirimit* i ka për të likuiduar deri më një simbas dy kriterevet rreptësisht objektivë (sepse barabar larg çdo privilegjimi subjektiv të njërit, e *ipso facto* diskriminimi po subjektiv të tjetrit – kryedialekt) parpëlqimit të partikularizimevet me:

1) të temavet *paradigmatikisht sa më unitare*, dhe

2) të morfemavet *fonetikisht sa më tërësore*.

3624. Dyfish paradoksalisht, ndërsa “*Etimologjia* klasike a krahasore – e jashtëme”, në interpretimin dhe operimin të *gjuhësisë gjoja moderne* kurse në fakt mbizotërueshëm historiciste, vazhdon të ketë për objekt vetëm *semantikën* vetëm *parhistorike* vetëm të fjalëvet të *thjeshta*; anasjelltas “*Etimologjia*

e brendshëme”, në konceptionin dhe praktikën (kinse të superuar nga Gjuhësia gjoja moderne) të “*Gramatologjisë lashtogreke*” ka pasur për objekt (autentikisht brendagjuhësor edhe përhershëmrisht aktual) analizën *struktorore* të fjalëvet të *pathjeshta*.

3628. Simbas precedentit të alfabetevet latinë të gjuhëvet evropiane, e madje deri të vetë grafikës latine për greqizmet me *ch*, *ph* dhe *th*, tërë filozofia novatoriste e Alfabetit të Bashkimit ka qëndruar vetëm në zevendësimin me dyshkronjësia latinë të shkronjavet jolatine të alfabetit latin të gegërishtes së vjetër.

3631. Drejtshkrimi ynë vërte *pasqyron* detyrimisht vetëm variantin *sollemn* të drejtshqiptimit tonë ; por ama i njëjti drejtshkrim mund, për larmim stilistik, të drejtlexohet edhe si pasqyruer i variantit të *rëndomtë* të të njëjtit drejtshqiptim.

3644. Ndërsa “*Gramatika fonematike* (a e tingujvet themelore)” ka karakter *fonografik* ; anasjelltas, karakteri i “*Grafikës leksematike* (a së fjalëvet)” dhe ai i “*Grafikës frazematike* (a së fjalivet)” janë respektivisht fono-ideografik dhe ideografik.

3650. Gjuhësia përdëftuese (e aq më fort ajo normative) duhet të operojë vetëm me materialet “e përpunuar” të prozës shkencore publicistike dhe teknike : anasjelltas materialet “e frymëzuar” të letërsisë reflektive dhe folklorit spontan mund të trajtohen gjuhësisht vetëm në esejet e lirë mbi artet përkatës.

Deri më sot, njëra nga pengesat më serioze në rrugën e rreptësimit të shkencës së gjuhësisë ka qenë pikërisht përzjerja e gjithandëjshme e dy palë materialeve të sipërm.

3653. Figurimi i nocioneve të figurueshëm të fjalëvet edhe monosilabike dhe homophone me të nocioneve mezi të figurueshëm a të pafigurueshëm fare, ja në parim kalimi nga ideografia strikte në fonografinë silabike ; - fonografi *silabike* këjo, kalimi i mëtejshëm i së cilës në fonografinë *fonomatike* do të përbënte shpikjen e Alfabetit.

3702. “*Kryevepra*” e ime si punues shkencor ka për të qenë zgjatja me dhëmbë e me thonj e jetës sime deri në moshën *shtatëdhjetëvjeçare*”.

3703. Kapitulli qëndror i mbarë Stilistikës ndoshta është ai i larmimevet leksiko-gramatikore në të shprehurit riparaqitjet gati të pandërmjetshme të të njëjtavet idera.

3708. *Shkencën* e gjuhësisë ende gjithënjë vazhdon ta komprometojë keqas mosdallimi i saj nga *arti* i stilistikës (shih 3.650).

3715. “Tingujt e thjeshtë e të pandarë të këtyre gjuhëve, që janë më të shumtë se gërmat e alfabetit latin [S. R. për sa njësite inventari i tyre fonematik sipëron atë grafematik të latinishtes] i paraqitur në mënyrë konvencionale me dy shkronja po të alfabetit latin” (J. Vreto, *Vepra të zgjedhura*, f. 277).

3719. Kalimi fillimisht nga “konkomitanca funksionale” në “atë servitudinale”, mbarimisht nga “konkomitanca servitudinale” në “atë mnemoteknike” të të folurit komunikues me të menduarit e komunikuar, ja tematika më themelore e bashkëmarr(ë)dhënievet *intelektologji – lokuografi* e anasjelltas.

3750. “Fonografia” (a shkrimësia zanore), pretendimisht e vetëmjaftueshme, a e mvehtësishme, në të vërtetën objektive dhe dëshmitarinë historike, përbën një integrim, padyshim nga më vendimtare por prapëseprapë një integrim të “ideografisë”.

Rrjedhimisht e ashtuquajtura “fonografi”, në fakt, është “ideo-fonografi”.

Për këtë dëshmojnë bindshëm tre fenomenet : *ndarja leksematike e togjevet shqiptimorë, dallimi i shkronjavet në madhanike e voglanike, si dhe shenjat diakritikë të homonimevet e sidomos ata të pikësimit* ; - fenomene që kryesisht përfaqësojnë realitete (jo zanorë, por) ideorë.

3751. “Drejtshkrimi, Ortografia, Rregullimi i mënyrës së shkruarjes nëpërmjet shenjave shkrimorë, shkronjavet dhe shenjavet fjaliorë” (Der Große Boockhaus, 1933)

Komentim

Të ashtuquajturën “ortografi”, zakonisht e përbën vetëm komponentja “fonografike” e “ideo-fonografisë”.

3755. As të shkruarit të të folurit, as vetë të folurit nuk janë përbërjesh rreptësisht të thjeshta.

Edhe me të vërtetë, se gjestikulimet e folësve nuk janë gjithëmonë krejt të tepërt, e pra se të folurit nuk është kurdoherë plotësisht të vetëmjaftueshëm, në të mirë të kësaj teze dëshmon ekzistenca e pamungueshme në çdo gjuhë e të ashtuquajturave “fjalë përemërore”, të cilat në fakt janë reflekse jo edhe *gjuhësore* por vetëm *shqiptimorë* të të njëjtëve gjeste.

Nga ana tjetër, edhe drejtshkruarja, larg së qeni frontalisht fonografike, është përkundrazi fono-ideografike, e madje ideo-fonografike (shih 3750).

3759. Ato të grafikës-ortografisë janë çeshtje jo edhe të vetë gjuhës në realitetin primar material të fjalorit, fonetikës e gramatikës, por vetëm të përfaqësimit të saj grafik e ortografik, në ekzistencën e tij sekundare e konvencionale.

3772. Gjuhësia shqiptare nuk mund të bëhet shkencë gjuhësore pa u

pamvarësuar nga historicizmi hindo-evropianist si dhe nga konfuzionizëm-verbalizmi ruso-sovjetik.

3801. Themelimin nga një austriak, të “PSIKANALIZËS” jo gjithandej së padiskutueshme ta pasojë themelvënia, prej një shqiptari, e një “INTELEKTANALIZË” më pak së kundërdëshmueshme, ja (jo ëndrra, por) projekti i fazës fundore së jetës sime.

3874. *P e s ë t e z a t h e m e l o r e*

(Një vazhdë pesë tezash)

mbi historinë e shqipes së shkruar.

I. Gjuha shqipe nuk ka mundur të shtypshkruhej nga një verigegë katolik pa u pasë dorëshkruar më herët ndër juggegët ortodoksë.

Shënim i parë: Një interpretim joserioz i dëshmisë së Brokardit.

Shënim i dytë: Dy fábulat e dy “korne”-vet.

Shënim i tretë: Gjergj Kastrioti – Skënderbeu – disa-gjuhë-ditësi – 25-vjet-mbretëruesi etj. si nuk u kujtua një herë të vetme të themelojë një shkollëz shqipe?!

II. Shqipja e Buzukut është shumë më pak verigegërishte gjenuine sesa juggegërishte e jugtoskëzuar.

III. Në veriun katolik, thyerja e plotë, nga misionarët e huaj dhe klerikët vendas, e traditës treqindvjeçare së gegërishtes mbasbuzukjane, si dhe shndërrimi antihistorik, nga ana e tyre, e së folmes së Shkodrës në një gjuhë shkrimi – qenë dy akte të rëndë dekadence kulturore dhe çinteprimi kombëtar.

IV. Kostandin Kristoforidhi rimbrujtjetari i toskërishtes letrare mbi bazën e kundërparalelizmit të saj me gegërishten mbasbuzukjane, të zbuluar nga i njëjti juggegë

V. Kushtetimi i mënëfundshëm i shqiptarishtes së mbasçlirimit.

3875. Mbi eksperimentimet dhe çeksperimentimet të Androkli Kostallarit (apo Kalamanllarit?) për shartimin sa më zvetënues të toskërishtes me gegërishten, e anasjelltas.

3884. Ajo e albanofonit (jo greko-, por) helenoman *Jani Vreto*, kur ky më 1866 hartoi “*Gramatikën e greqishtes në shqipe*”, ishte një mendje tërësej virgjër në botën e albanistikës.

Prandaj përshkrimet makar të gjymta si dhe interpretimet makar të rastit në pjesën shqip të veprës vretojane përbëjnë një dokumentar të dyfishtë, sepse të vlefshëm për historikun sa të jugtoskërishtes së shkruar aq të gramatografisë vendase.

3906. *Të folurit* është të zanuarit për tejbartjen e të menduarit nga një ndërgjegje individuale në tjetrën.

3907. *Fjalìa* është më i vogli njësit i vetëmjaftueshëm i të folurit.

3909. Karakteri sa kumulativ aq inkokludues i gjuhësisë ruso-sovjeteke mos po vazhdon së kundërshtenjuari edhe tonën?

3929. Në gjymsën e dytë të shekullit të XIX, klerikët katolikë të Shkodër *loces*, mbas braktisjes antipatriotike të gegërishtes së përbashkët atëherë më treqindvjeçare, ju përveshnë me pasion krijimit, në të folmen e të njëjtit qytet, të një letërsie herë më prestigjoze nga forma sesa regresive nga përmbajtja, e anasjelltas.

3930. Në gjuhësinë shqipe, *kush e kush* dhe *kur e kur* do të na shpëtojnë nga gjoja tekstet mësimorë të në fakt leksionlexuesvet të papërgatitur?!

3931. Gjuhët historike, larg së qeni *edhe* sisteme, mezi janë vetëm tendenca drejt sistemesh.

3934. Kostantin Kristoforidhi, themelues gjuhësor i toskërishtes letrare.

3935. Kostantin Kristoforidhi, rimbëkëmbës titanik i traditës së lavdishme së gegërishtes së vjetër, e *ipso-facto* sipërues në perspektivë i partikularizmit shkodran.

3936. Aleksandër Xhuvani, vazhdues i Kostantin Kristoforidhit.

3937. I ashtuquajturi “*kuptim i një fjale*” në fakt takon vetëm “*komponentes* thjesht *tingullore*” së kësaj së fundit.

3990. Për komunikimin e “të dhënavet *individuale*”, çdo gjuhë disponon dy lloje mjetesh:

a) “fjalët *përemërore*”, me të cilat “të dhënat *individuale*” individuohen drejtfilli dmth. pa u referuar te konceptet a nocionet përkatës; dhe

b) “fjalët *quajtëse*”, me të cilat “të dhënat *individuale*” individuohen tërthorazi dmth. njëherë duke u identifikuar si koncepte a nocione, pastaj duke u dalluar nga tjerat “të dhëna *individuale*” të së njëjtës gjini a farë a “bashkekzemplarë” të së njëjtës klasë a nënklasë të saj nga njëra anë:

β) të bashkëkomunikimit të ndonjë përcaktimi a rrethanëzimi *po* quajtës të së njëjtës së dhënë individuale.

γ) të faktit se destinatari i komunikimit di që më parë në cilën sferë të dhënash hyn e dhëna individuale që po i komunikohet me fjalë quajtëse; e nga ana tjetër

Shënimi 1. Praktikisht, fjalët përemërore dhe quajtëset rëndom kombinohen midis tyre për një komunikim sa më të pavështirë e të padyshimtë të të dhënavet individuale.

Shënimi 2. Çeshtje të kritikës e terminologjisë tradicionale

1. quajtëse

2. joquajtëse ...

3991. *E pathjeshtë* quhet ajo fjali, së pakti njëra nga gjymtyrët e së cilës përbëhet (jo nga një *fjalë* a *togfjalësh*, por) nga një fjali *e tërë*, e cila ndaj gjymtyrës përkatëse së fjalisë së pathjeshtë mund të kryejë çdo funksion që do të kryente një fjalë a tog fjalësh.

4126. *Mosnjohja e gjenezës së fjalëve të pathjeshta*, që përbëjnë stërshumicën e mbarë fjalëve të çdo gjuhe së lavruar, pamundshmon:

1) renditjen e kritershme të kuptimevet të fjalëve të përkatëse,

2) dallimin e kuptimevet të tyre të mirëfillta prej të figurshëmevet,

3) aftësimin individual për pasurimin leksikor të gjuhës së dhënë, dhe

4) ekonomizimin e energjivet mendore për zotërimin leksikor të së njëjtës gjuhë.

4076.4145. Plane pune nga 1.VII.1975 – 25.XII.1976 :

1) Vazhdim ekstensiv i autoformimit gjenerik si orientalist për turqishten e arabishten, e njëherazi si balkanolog për greqishten, bullgarishten e rumanishten.

2) Plotësim e riredaktim i punimit : “MENDIME TË SHKËPUTUR TË NJË VAZHDE SË VETME”;

3) Plotësim e organim i tezavet të punimit : “INTELEKTOLOGJIA dhe KOMUNIKATIVISTIKA”;

4) Përfundim i punimit : “PËR FONETIZIMIN E PLOTË TË ALFABETIT sidhe PËR NJË KONCEPSION THJESHT FONETIK TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE” ; dhe

5) Përfundim i punimit :

“SHQIPTARISHTJA E MBASÇLIRIMIT: HISTORIA–NORMAT–LAVRIMI”.

4155. Në gjuhësinë e përgjithshme edhe të Perëndimit edhe të Lindjes, specia “zanore” e gjinisë “materiale” së komunikimit shenjor të idevet nga një ndërgjegje individuale – “metaforikisht” (ment më shpëtoi “mutaforikisht”) është quajtur “ana tingullore” e fjalëve, herë (ende më betërçe) “lëvozhga materiale” e tyre.

4077.4156. “Jo më kot F. de Sosyri ka shkruar:

“Fjala, pamvarësisht nga vështirësia e përkufizimit të saj, është një njësi, e cila paraqitet pashporrshmërisht (rus. “neotstupno” për “neotvratimo”, fr. “inéluclablement) mendjes sonë, diçka qëndrore në tërë mekanizmin gju-

hësor” [Viktor Vladimiroviç Vinogradov, *RUSKIJ JAZYK (mësonjë gramatikore mbi fjalën)*] f. 15.

Shihet sheshit, pra, se qe këjo tezë nga më të kundërdëshmueshmet e madje vulgaret të gjuhëtarit svicerjot (sa të shkëlqyeshëm në stivimin e vrojtimevet të veçanta aq inkonkludues në trajtimin e problemevet të përgjithshëm) që akademikut sovjetik frymëzoi tre innovacionet kuriozë :

1) studimin e *mbarë rusishtes* për ta konceptuar si studim vetëm të *fjalës ruse*;

2) studimin e *fjalës ruse* për ta konceptuar si studim jo leksikologjik, por gramatikor; dhe

3) “gramatikoren” për ta konceptuar jo si “morfologjiko-sintaksore”, por si “kategorialo-morfologjike”.

4192. Përfaqësimi ndërkrainor në përbërjen e Komisionit hartues të *t’ashtuquajturavet* “RREGULLA TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES” : jugorë *tre* + qendrorë *një* + veriorë (të perëndimit e lindjes) *zero* ...

4221. Nga “toskërishtja e kulluar si shqipe letrare”, nëpër “toskërishten (e pakulluar) si bazë dialektore e shqipes letrare”, te “shqipja letrare e bashkëveprimit ndërdialektor (*simbas plus–meritavet thjesht funksionale për t’u sanksionuar nga njëri rend rasash në tjetrin*).

4292. Të menduarit nuk komunikohet dot *gjuhësisht* (më shkoqur : *fjaliorësisht*) pa pasë marrë tashmë strukturën *logjike* të një njësi të mendimor. Dmth. *strukturën* analitiko-sintetike të dublimit subjektiv a ideor të një njësi objektive a real, i cili (njësit), analitiko-sintetikusht strukturohet kështu: “një proces (i pasendizuar) sendi *plus* një send, të cilit (parpranishmisht) edhe i përkatësohet procesi”.

Ja përse teza lashtogreke mbi përjashtimin e të menduarit në mungesë të të folurit është e barasvlefshme me tezën ekzorbitante se vetëm të menduarit rregullisht të logjicizuar është të menduar ; - tezë këjo, e cila është gjithë gjasa të ketë qenë kryekëput e huaj për popujt *aziatikë* të kulturavet *ideografike*.

4293. Me përjashtim të t’vetmevet ndijime (e vetëm përderisa të ketë mbetur të pidentifikuar konceptualisht), çdo përmbajtje jo vetëm e ndër-gjegjjes ripranishmimore “së kulluar”, por edhe asaj ndijimoro-ripranishmimore a përkapjore përbën një të menduar në vetëvehte ekzistencialisht të pakushtëzuar nga epifenomeni qoftë i të shprehurit për t’u *shprehur* qoftë i të shprehurit për t’u *komunikuar*.

4305. I ashtuquajturi “*redaktim*” (nga lat. “*redaction*” = rrasje në një hapësirë më të vogël) duhet konceptuar e praktikuar në radhë të parë si një

mendim më kritik i tashmë të menduaravet më pak kritikisht, e vetëm në të dytën si një ripunim gjuhësor a përsosurim stilistik.

4384. “Kush koft i zoti, mos i *shkoft i zi moti*”:

*Analizë sintaktike*1: “i z”>: pjesë **emërore** e kallzuesit (**jo** – emëror, por) **foljor** “*shkoft*”.

Konkluzion teorik: Tërë bazën empirike të ndarjes tradicionale më se 2000 vjeçare së kallzuesvet fjaliorë në “emërorë” dhe “*foljorë*” e përbëjnë vetëm dy konceptonet barabar parshkencorë të “*grykimit logjik*” dhe “*fjalisë gjuhësore*” nga Aristoteli.

Prandaj, dy nocionet (edhe ashtu disparatë e madje hibridë): “kallzues (nacion **sintaktik**) emëror (nacion **jo**-sintaktik)” dhe “kallzues (idem) foljor (idem)” – janë më në fund për t’u mënjanuar edhe nga teoria edhe nga praktika gjuhësore në të mirë të dy nocioneve pakrahasim më adekuatë: “kallzues *i deprocesizuar*” (me “*deprocesizim*” duke kuptuar me “staticizim” atë të foljes “*qenë*” përndryshe - n ë k r y e t ë h e r ë s – gjithashtu përsosurisht procesive) dhe “kallzues *procesiv*”.

Nga Fletore VI

4417. Nëse **SINTAKSA**, empirikisht ekzistuese prej më se 2000 vjetsh e tëhu, ka mbetur ende gjithënjë shkencërisht e pakushtetuar; - çka *kurrësesi* nuk mund në të njëjtën masë të thuhet për **LEKSIKOLOGJINË** dhe **MORFOLOGJINË**, na këtë pabarazi zhvillimi të asaj kundrejt këtyre e shpjegojmë vetëm me prapambetjen paralele të **LOGJIKËS SINTETIKE** kundrejt **ANALITIKËS**.

4421. Se as materialistët më vulgarë nuk kanë mohuar dot ekzistencën sekundare të *ideores*, e se idealistët janë detyruar të pranojnë ekzistencën subalterne të *materiales*, çdo rishtar i historisë së filozofisë di kaq gjë. Por ajo që dihet pak e aspak është fakti se njërët dhe tjerët kanë rënë në dy ravgime të njëjtë: *një* duke injoruar barabar kryekëput ekzistencën e plotvlefshme të *biologjikes*, *dy* duke konfonduar *komunikativistiken* me *ideoren*; - injorim dhe konfondim këta, që kanë qenë barabar fatalë për që të dyja palët.

Tani, se për një trajtim gnoseologjik minimalisht adekuat të **Kozmikes** më së evoluar, duhet patjetër përfillur barabar edhe **Biologjikja**, si fazë ndërmjetësuese midis **Materiales** e **Ideores**, edhe **Komunikativistika** si fazë mbas **Ideore**; hedhjen e këtyre dy palë tezave masive do ta argumentojmë nga njëra anë:

historikisht, duke rikujtuar se **Materializmi** e **Idealizmi**, prej gati 3000 vjetsh e tëhu, kanë rezultuar sa të pavetëmjaftueshëm për të përligjur ekskluzivitetin e pretenduar të vërtetësisë vehtjake, aq për të ngadhnyer plotësisht njëri mbi tjetrin; nga ana tjetër:

pozitivisht, duke demonstruar deri në evidencë se e vetmja mundësi për të dalë nga qorrsokaqet e dyluftimevet frontalë midis Materializmit dhe Idealizmit, është parpranimi gnoseologjik se Kozmikja globale e Homo sapiens-it është për t'u analizuar në jo më pak se katër Rende, e pikërisht: 1) në Materialen, 2) në Biologjiken, 3) në Ideoren dhe 4) në Komunikativistiken; e nga ana tjetër e fundit:

gjenetikisht duke treguar se *materialja* bart *biologjiken*, që në radhën e vet bart *ideoren*, tejpërsjellja materialo-konvencionale e së cilës nga një ndër-gjegjje në tjetrën në radhën e tretë e të fundit mbetet më kryesorja arësye qenieje e *komunikativistikës*; e për pasojë duke likujduar *apriorizmet aberrantë* (për të mos thënë: *trillimet mistikë*) të një komunikativistikje *pa objekt ideor*, të një ideorje *pa origjinë biologjike*, e të një biologjikje *pa subjekt material*.

Pasionin për “Konceptet shkencorë” Sokrati e bashkonte me anti-patinë e përzemërt kundër “Metaforavet poetiko-retorike”.

Logjicianët, jo të formimit profesional – fazën përgatitore të zbulimevet shkencorë alias “Dialektikën” a “Parlogjikën” e kanë identifikuar nga njëra anë me “Superlogjikën” e Mendimit njerëzor, e nga tjetra, me “Kontrastikën” (mistiko-fantastike) të Natyrës Virgjër.

Tërë “gjuha e shkruar”, larg së konsistuari në përfaqësimin vetëm të “anës *shqiptimore*” së “gjuhës së folur” (*fonografi*), kushtetohet njëherazi edhe nga bashkëpërfaqësimi i “anës së saj *kuptimore*”; e pra, në analizë të fundit, edhe nga bashkëpërfaqësimi i drejtfilltë i vetë të menduarit (*ideografi*).

Dhe kanë qenë pikërisht njëherë çpërfillja e komponentes *ideografike* së gjuhës së shkruar, e pastaj identifikimi me “*gjuhën e shkruar*” i “*së folurës*” që kësaj së fundit ia kanë stërmadhuar rolin, relativisht modest, për zhvillimin kompleksiv të mendjes njerëzore.

Thosha “*relativisht modest*”, sepse përndryshe largësia mezi e matshme midis zhvillueshmërisë mendore së “zotëruesvet të teknikës” (gjoja thjesht) *fonografike* (në fakt) edhe *ideografike* nga njëra anë e nga tjetra e asaj së “analfabetëvet” – do të mbetej një enigmë e vertetë.

4451. “Njohimet” a “konceptet”, si elementë analitikë të njësitevet mendimorë (ri)prodhohen mendërisht pa mundur që edhe të *mendohen*: të *mendueshëm* janë vetëm njësitet mendimorë.

Pra, “të mendosh” don të thotë: “të prodhosh njësite mendimorë”, e për pasojë këta apo ata procese të pasendizuar t’ua përkatësosh sendevet të parpranuar si përkatës.

Vërtetësinë e kësaj teze e provon fakti paralel se “*flet*” jo edhe kush

“shqipton fjalë të shkëputura” njohimesh të shkëputur, por vetëm ai që fjalët e shkëputura i bashkon në fjalitë përkatëse (të ndejtimevet përkatës).

4455. Veset organikë parorendas të pjesës sintetike së Logjikës së Aristotelit qëndrojnë:

1) në zanafilljen e saj (jo njëherë nga shpërbërja tërësore e njësitit mendimoro-gjuhësor në pjesët e tij përbërëse e pastaj nga kryepjesa e tij, por) nga pjesa e dytë e së dytës kryepjesë së tij a atribut i predikatit a cilësues i kallëzuesit;

2) në karakterizim-klasifikim të të njëjtit cilësues kallëzuesi simbas llojevet konceptuale më të përgjithshëm;

3) në vargënimin linear të këtyre llojeve, dhe në pargjykimin e pathemeltë se, në mendjen njerëzore, elementet e analizuar të njësitit mendimoro-gjuhësor paskan ekzistuar më parë se ky i fundit.

4456. Nga veset organikë primordiale të Logjikës së Aristotelit vuajnë barabar edhe dy Logjikat më kryesore të kohëvet moderne: Logjika fragmentare e Kantit, dhe ajo integrale e Anti-Kantit *alias* ajo e Hegelit

4506. Të folurit, pa qenë *i vetmi*, mbetet *më i rëndësishmi* mjet i të komunikuarit të të menduarit.

Pra, nëse të menduarit është të pamundshëm në mungesë të të folurit, së këndejmi a nuk rezulton se njerëzit menduakan vetëm e vetëm për të komunikuar mendimet e tyre njëritjetrit, e jo njëherazi e madje kryekreje për të kontrolluar Botën materiale nëpërmjet njohjes së saj.

4541. Punime të planifikuar për 1976 – 1980:

Albanistikë

I-II. PËR FONETIZIMIN E PLOTË TË ALFABETIT

SI DHE

PËR NJË KONCEPSION THJESHT FONETIK TË DREJTËSHKRIMIT

TË

GJUHËS SHQIPE

III. GEGËRISHTJA E BUZUKUT – NJË TOSKËRISHTJE E GEGËZUAR

IV. SHQIPTARISHTJA E MBASÇLIRIMIT

- HISTORIKU, NORMAT, LAVRIMI –

Nga Logjikë–Linguistika

në

Intelektologji–Komunikativistikën

V. VESËT ORGANIKË TË KONCEPSIONEVE TË SOSYRIANË

MBI

“SEMIOLOGJIKEN”, LINGUISTIKEN DHE RAPORTET E TYRE

VI. PËR NGRITJEN E PRAKTIKËS DREJTSHKRIMORE NË RANGUN E NJË TEORIE IDEOGRAFIKE

VII. QORRSOKAQËT EMPIRIKË TË LOGJIKËS E GRAMATIKËS

LASHTOGREKE, SI BAZAT GJOJA TEORIKE TË TË NJËTAVET DISIPLINA
BASHKËKOHORE.

VIII. E. KANTI, G.V.F. HEGELI DHE B. KROÇEJA
SI

LOGJICIANË MBASARISTOTELIANË

IX. SHKECA MBI TË MENDUARIT PARSHKENCOR
OSE

INTELEKTOLOGJIA

X. SHKENCA MBI TË KOMUNIKUARIT TË TË MENDUARIT PARSHKENCOR
OSE

KOMUNIKATIVISTIKA

Filozofi

XI. PESË PËRMATJET RENDPARA TË SPECIFIKËS NJERËZORE:

5. MORALJA (filozofikja).

4. KOMUNIKATIVISTIKJA,

3. INTELEKTOLOGJIKJA,

2. BIOLOGJIKJA,

1. MATERIALJA, (Qen~ja pesëpërmatjore - L'être quinqidimenssional)

Apoftegmatikë :

XII. MENDIME TË SHKËPUTUR TË NJË VAZHDE SË VETME

4616 bis. 4616 bis. ***Punime te planifikuar për pesëvjecarin 1976 - 1980***

I. II. Për fonetizimin e plotë të Alfabetit si dhe

Për një konception thjesht fonetik të Drejtshkrimit të Gjuhës shqipe.

III. Gegërishtja e Buzukut – një toskërishte e gegëzuar.

IV. Shqiptarishtja e mbasçlirimit – Historiku, Normat, Lavrimi–

V. Për ngritjen e praktikës ortografike në rangun e një teorie gjuhësore.

VI, VII. Dy orvatje për të rithemeluar Logjikën e Aristotelit dhe Gramatikën tradicionale.

VIII, IX. Psikologjia dhe Intelektologjia.

X, XI. Komunikativistika dhe Linguistika

XII. Mendime të shkëputur të një vazhde së vetme.

XIII. *Pesë përmatjet e unikalet njerëzore:*

Materialja, biologjikja, intelektologjikja, komunikativistikja dhe politologjikja

Shkencën e Intelektologjisë

HYRJE NË: Kuazishkencën e Komunikativistikës

Metashkencën e Politologjisë

4703.

INTELEKTOLOGJIA

dhe

KOMUNIKATIVISTIKA

Prolegómena

Gjendja aspak e kënaqshme e Sudimevet mëse 2000-vjeçarë mbi të
Menduarit dhe të Komunikuarit e tij.

- 2 -

Aktualiteti i të dy tentarivavet të punimit të pranishëm për të hedhur
themelet e parë dy shkencavet mbi të Menduarit dhe të Komunikuarit të të
Menduarit.

- 3 -

Bazat gnoseologjike materialistikoshkencore të Intelektologjisë dhe
Komunikativistikës.

- 4 -

Katër Aplikimet (shihni më poshtë) të Intelektologjisë dhe
Komunikativistikës mbi vlerësimet kritikë të Logjikës dhe Gramatikës e
Linguistikës duan njëherazi të kushtetojnë poaq verifikime konceptualo-
metodologjikë të dy shkencavet te reja.

- 5 -

Motivet objektivo-subjektivë për të cilat autori lëndët të Intelektologjisë
dhe Komunikativistikës i ka më fort ekspozuar në formë tezash sesa
trajtuar organikisht.

Konkluzionet e Prolegomenavet

- 6 -

H Y R J E

N Ë

SHKENCËN E INTELEKTOLOGJISË

me dy Aplikimet:

I. BILANC INTELEKTOLOGJIK I LOGJIKËS SË ARISTOTELIT

II. KRITIKË INTELEKTOLOGJIKE E KANTIT SI LOGJICIAN

H Y R J E

N Ë

(KUAZI) SHKENCËN E KOMUNIKATIVISTIKËS

me dy Aplikimet:

I. BILANC INTELEKTOLOGJIK I GRAMATIKËS TRADICIONALE

II. KRITIKË INTELEKTOLOGJIKE E F. DE SOSYRIT

SI SEMIOLOG DHE LINGUIST.

4713. Mbasardhëse e Logjikës së Aristotelit (gjegjesisht mbijetuese
në bashkëkohoren) do të jetë “Intelektologjia e aplikuar”.

4717-4716. “Intelektologjia”, mbasi objektin e vet a “Intelektin” ta ketë
përkufizuar si atë Botë të tretë, e cila, nëpër idiodublimin e së dytës a Biologji-
kes, (në bartësin fiziologjik të të njëjtit intelekt) idiodublon edhe të parën a
Materialen, lëndët e veta do t’i trajtojë të ndara në këto katër pjesë më kryesore:

H Y R J E P S I K O - I N T E L E K T O L O G J I K E M B I N D Ë R G J E G J J E N

A. *Bashkëfunktionimet ndijimorë dhe mbasndijimorë të ndërgjegjjes
njerëzore.*

B. *Tre ndërgjegjimete intelektikë:*

1. *Përkapjet* (si funksionim ndërmjetësues për kalimin nga ndijimet në ripranishmimet),

2. *Ripranishmimet* dhe

3. *Parfytyrimet*.

I. INTELEKTOLOGJIA ANALITIKE

A. Idiodublimet elementarë, të veçantët dhe të përgjithshmit (a Konceptet dhe Togkonceptet).

B. Klasifikimet e Koncepteve të Kategoritë konceptore

II. INTELEKTOLOGJIA SINTETIKE

A. Idiodublimet njëditorë a Gjykimet dhe Klasifikimet e tyre,

B. Idiodublimet tognjëditorë a Toggjykimet dhe Klasifikimet e tyre.

III. INTELEKTOLOGJIA NORMATIVE

A. IDENTIFIKIMI KONCEPTUAL I TË VEÇANTAVET

B. NDËRMVARËSIMI I KONCEPTEVET BRENDË GJYKIMEVET

C. NDËRMVARËSIMI I GJYKIMEVET BRENDË TOGGJYKIMEVET.

Konkluzione: Paralozizmat dhe sofizmat.

4890. “Ato (S. R. “dy dialektet kryesore të gjuhës”) për arsye të ndryshme kanë ndjekur pastaj një rrugë me drejtime shpeshherë divergjente, dhe vetëm në kohën e sotme vërehet dhe procesi i një konvergjence, i një afrimi të tyre, nën ndikim të kushteve shoqërore dhe të gjuhës së shkrimit e të literaturës. Rezulton (nënvizon S. R.) se *në një periudë më të hershme, paraletrare të gjuhës, më konservative paraqitet gegërishtja, në periudën letrare toskërishtja*” (*Eqrem Çabej*, Mbi disa probleme dhe detyra të gjuhësisë historike shqiptare) (Z. i P. 1976).

Komentim

a. “një rrugë (S. R. *të vetme*) me drejtime shpesh herë (S. R. a rrallëherë) divergjente” *baras* dy rrugë.

b. “Këto “arsye të ndryshme”, për të cilat “në një periudë ... paraletrare” të shqipes, gegërishtja qenka paraqitur “më konservative”; kurse “në periudën letrare toskërishtja”, vallë cilat do të kenë qenë?”

Në të vërtetën objektive, *gjatë që të dy periudhëve*, njëri nga dy krye-dialektet (për mua *jugori*) do të jetë paraqitur gjithënjë *më konservativ*, kurse tjetri (për mua *jojugori* a *qendroro-veriori*) kurdoherë *më pak* i këtillë: teoria simbas së cilës, gegërishtja e *Buzukut* pasqyruaka besnikërisht *gjendjen e gegërishtes së atëhershme*, është krejt e pathemeltë.

4810-4927. Lartësisht i përfilluri dhe fortësisht i dashamirësuari

REXHEP ISMAJLI,

[Kombasit shqiptarë të shtetësisë jugosllave, falë meritës subjektive së seriozitetit në punë dhe favorizimit objektiv të dygjuhësisë zyrtare, është shumë e mundshme e madje gati e sigurtë që, në një të ardhshme jo të largët, të bëjnë Prishtinën një bashkëqendër evropiane të njëjës nga shkencat shoqërore më prestigjioze, e pikërisht të Linguistikës së përgjithshme].

Me të cilën (*Linguistikë të përgjithshme*) unë (ish liceisti i apasionuar sigurisht edhe për Gjeometrinë elementare (por mësëforti), për dy disiplinat binjake të Gramatikës dhe Logjikës), jam marrë gjatë etapash prej gjithsejt tridhjetë e sa vjetsh pak a shumë si pason: Në fillim, vetëm me hope e jo pa ndërgjegje të keqe, sepse për mungesa të çdo perspektive reale specializimi serioz në një shkencë praktikisht të paanë e të pafund. Pastaj me një farë pengimi t'familjarizohesha me lëndët dhe zotëronja metodat e saja. E mënëfund gjatë shtatë vjetëve të fundit mbas largimit nga Instituti me një vendosuri të prerë për të tentuar sipërimin e stagnacionit gjegjësisht të regresionit në gjendjen ndërkombëtare të studimevet qoftë tradicionale qoftë inovues sa mbi Logjikën aq mbi Linguistikën. E për të tentuar këtë sipërim duke rikushtetuar Logjikën në kuadrin e një shkence mbi mbarë të menduarit dhe Linguistikën në atë të një shkence mbi të komunikuarit të të menduarit me mbarë mjetet e mundshëm (reproduktiv-demonstrativë, mimetiko-gjestualë, komitanto-ekspresivë, konvencionalo-signeskë etj). E përmëshumë të dyja këto disiplina për t'i rikushtetuar jo në dy serira të veçara manografish tematike, por anasjelltas në një të vetme trajtesë tetraedrike, të cilën unë, në mendjen time, tashmë e kam edhe titulluar:

NGA
LOGJIKA DHE LINGUISTIKA
NË

INTELEKTOLOGJINË DHE KOMUNIKATIVISTIKËN,

duke qenë me dy terminet (të markës vehtjake) “intelektologji” dhe “komunikativistikë” për t'u kuptuar: *dy shkencat frontalisht komplementare mbi të menduarit dhe të komunikuarit e tij*; kurse vlerësimet hyrës të dy disiplinave *Logjikë dhe Linguistikë* duke u dashur shtjelluar në dy nëntitullimet përkatës:

1. Analizë dhe Bilanc të Logjikës së Aristotelit;
2. Analizë dhe Kritikë të Linguistikës sosyriane.

Madje, për që të katër pjesët e projekt-trajtesës (tetraedrike), po unë tashmë kam nga njëra anë grumbulluar materialet më të vlëfshëm të autorëvet më përfaqësimitarë të Logjikës dhe Linguistikës, e nga ana tjetër, përveç përcaktimit përfundimtar të konturevet të përgjithshëm të Intelektologjisë dhe Komunikativistikës, ideuar e formuluar një numër bajagi të madh tezash plotësisht origjinale për të zgjidhur, pakrahasim më të kënaqshëm se në të kaluarën të hershme dhe të vonë, togje të tëra problemesh kyçe nga të gnoseologjisë e madje filozofisë.

Prandaj, deri vonë, gjithënjë po unë isha gati krejt i sigurt se, të shkretën, do të rronja së pakti edhe aq vite tjera sa do të më nevojiteshin për të mos lënë të pakryer veprën e jetës...

Por, ja që *hë!* 7-8 muaj të shkuar, dy sëmundjevet (që të përmend këtu vetëm më të rëndat) të zemrës dhe ulçerës ardhi befas e u u mbishtua një e tretë (shumë më minuese e heshtur dhe alarmuese e haptë nga dy tjerat marrur së bashku): ajo e hipertrofisë së prostatit *plus* një gur (jo i lirë, por) i

inkrustuar; e i inkrustuar në një nivel t'atillë që, me siguri, nuk thuhet dot nëse inkrustimi takon një paretë të prostatit apo të fshikzës.

Në këtë situatë të re, binduria e derivonshme se ndërmarrjen romake nga njëra anë të rikushtetimit të Logjikës (si intelektuallogji normative) dhe Linguistikës (si komunikativistikë gjuhësore), e nga ana tjetër të *kushtetimit* (për herë të parë në historinë e shkencave) të një Intelektologjie dhe një Komunikativistike – të përgjithshme, do t'arrinja ta përfundonja vetëm me forcat vehtjake, ardhi e m'u përmbys në një dyshuesi nga më brenjtëset.

“Në këtë situatë të re – pyeta vetëvehten dhe u përgjegja vetëvehtes – unë ndihmim edhe më të kualifikuar edhe më të pakursyer nga kush tjetër mund edhe të pres edhe të pranohet? përveçse prej Atij, i cili, në konfidencia të shkruara, botimet e mi të deritashëm edhe diti – për lëndët e tyre – të m'i vlerësojë si kontribute gati të pashpresuar albanistikës vendase, edhe deshi – për prozën e tyre shkencore dhe frymën e tyre kririke – të m'i ekzaltojë, si modele formativë sa të shijes aq të intelektit?”

Asgjëmangu, që ende 27-vjeçari R. I. të mundë 65-vjeçarit S. R. t'i bëhet krah-e-dorë në vazhdimin dhe përfundimin të një vepre, e cila (simbas S. R.) është e thirrur të hapë një periudhë të re në historinë e dy shkencave përkatëse e njëherazi një kapitull të ri në atë të teorisë së njohjes e madje të mbarë filozofisë, është e detyrueshme që R. I. jo vetëm të mirëpresë me zemërgjërësi por edhe të praktikojë me konsekuenciaritet 2–3 këshillimet e mëposhtëm:

1. Me të mbrojtur disertacionin mbi “Kronologjinë etj.”, R. I. le të përkushtohet vetëm gjuhësisë së përgjithshme:

a) etjen nostalgjike për krijime letrarë dhe fluturime poetike duke e shuar me afirmimin vehtjak si prozator shkencor në linjën kosovare të Pjetër Bogdanit, Tahir E. Gjakovës, Shtjefën Gjeçovit, Selman Rizës etj.;

b) albanistikën *historike* e sidomos *parhistoriken* duke e lënë të presë disa vite radhazi kontributet e pamungueshëm të specialistit të ardhshëm të gjuhësisë së përgjithshme;

c) albanistikën bashkëkohore që epet më shumë e ha kohë më pak, duke e dobishmuar për sa më shumë aplikime gjuhësoro përgjithshëm etj.

2. Curatio valetudinis (Rexhepo Ismajlo) *suprema lex esto!*

3. Hastaliktan dalayi, tütün içmek jasaktir (Remzi Pernaskanin emir ile).

i tëri juaji dhe krenari për ju

Tiranë, 14. V. 1974

Selman Riza

* Koncepti i letres, së hartuar ngutshëm, vende-vende u rishkrua pastër më 24-V-1976.

5041. Frederik Hegeli, më i paçgjermanizuari i tërë filozofëve gjermanë Kush, në tërë masën e duhur, përfill shtatë të vërtetat (ende gjithënjë tepër pak të njohura):

3. se të kështuquajturit “*të folur*”, në fakt, është edhe “*të këngëtuat*”,
 4. se e kështuquajtura gjuhë e zërit, në një shtrirje të konsiderueshme, është edhe e gjestevet,
 5. se i kështuquajturi *ortografim* i një gjuhe së shkruar, në analizë të fundit del mëfort *ideografim* i idesë sesa fonografim i zërit,
 - 6.- 5. se struktura e të folurit gjeneriko-komun aspërsëlargu nuk është *frontalisht paralele* me atë të të menduarit po gjeneriko-komun, e aq më pak me atë të të menduarit shkencoro-specialistik,
 6. se të folurit deri në gjuhën më të lavruar nuk komunikon dot shterueshëm të menduarit të folësve përkatës, dhe
 7. se numri tepër i mash i divergjencave tepër të thella midis idiomave etnike dhe gjuhëve kombëtare hantikapon së tepërmi të komunikuarit ndërkombëtar të të menduarit gjithënjëzëz;
- kush, në tërë masën e duhur, përfill këto shtatë të vërteta (ende gjithënjë tepër pak të njohura) nuk mund të mos pranojë se në të deritashmet teoretizime historikokulturorë, rëndësia e rolit të të folurit për të menduarit është stërmadhuar jashtë çdo përgjegjësie shkencore.

5043. Doktrina (e Frederik Hegelit, përvehtësuar anblok dhe popullarizuar me zell shumë më të madh prej Frederik Engelsit sesa prej Karl Marksit) mbi “Strukturën dialektike (dmth, *kontradiktore a kundërthënore* jo së pasipërueshme)” sa e pasqyrimit subjektiv të realitetit objektiv, aq e vetë këtij të fundit – karakterizohet:

1. nga identifikimi arbitrar gjegjesisht konfondimi prepotent i konceptit të “*kundërthënies*” midis një gjykimi *pohues* dhe *mohuesit* përkatës mbi të njëjtin fakt me konceptin e “*kundërndejtimit*” midis dy koekzemplarëvevet *më ekstremë* a bashkëshembullorëvevet *më të skajshëm* të të njëjtit koncept;

2. (shih 5007-5009) nga identifikimi (vërte në *origjinë* kryer krejt kauzalisht prej Spinozës pak e aspak dialektik, por në *vijim* instrumentalizuar gjithandej prej Hegelit në shërbim të Doktrinës vehtjake) i çdo koncepti “*përcaktimi*” me konceptin e “*mohimit*” e, në analizë të fundit me të kundërthënies;

3. nga identifikimi i konceptit qoftë të “*forcavet kundërshtare*” qoftë të “*komponenteve heterogjene*” me konceptin e “*mohimit reciprok*”;

4. nga identifikimi i konceptit të “*transformimeve*” në natyrën objektive dhe mendimin subjektiv me konceptin (njëherë vetëm të “*kundërndejtimeve*” pastaj edhe) të “*kundërthënive*”; dhe

5. nga identifikimi i konceptit të “*rasavet kufinj*” (e, si të këtilla të epshme për interpretimet më të llojlojshëm) në shkencat të matematikës dhe natyrës me konceptin e “*rasavet të rëndomta*” në të njëjtat shkenca.

E janë këta interpretime arbitrarë gjegjesisht konfondime të këtyre

koncepteve që Hegeli, njëherë vetëm për diskreditimin, pastaj edhe për likuidimin të shkencës mbi të menduarit a *Logjikës* së përmbledhur në ligjin e ligjevet të saj *alias* në ligjin subjektivo-objektiv të *moskundërthënies* së të menduarit as me vetëvehten as me realitetin objektiv.

Nga Fletore VII

5166. PSIKOLOGJIA AKTUALE DUHET ÇTREFISHUAR NË PSIKOLOGJI, "INTELEKTOLOGJI" E KOMUNIKATIVISTIKË".

5205. Funksionimi gjenetik i Komunikativistikes si tejbartëse *sui generis* e të Menduarit nga një Ndërgjegjje individuale në tjetrën – nuk përjashton bashkëfunsionimin e saj mbasgjenetik si Auksiliaristike dmth. si mbështetëse materiale e madje fuqizuese e pallogaritshme e të njëjtit të Menduar.

5215. Tre stadet zhvillimorë të raporteve të të folurit me të menduarit:

1. stadi i *konkrecionit gjenetik* të të folurit me të menduarit,
2. stadi i *diferencimit funksional* të të folurit si komunikues i të menduarit prej vetë këtij të fundit, dhe
3. stadi i *bashkëfunsionimit* të të folurit edhe si një *komunikues* edhe si një *aukziliar* të të menduarit.

5238. Dy a më shumë fjalë janë "sinonim(ik)e" (nga greqishtja *syn – onymos* = a) bashkë-emërtuar, bashkë-emnas, b) kuptim-njëjtë a i njëkuptimshëm) kur takojnë së njëjtës së dhënë. Pra, etimologjikisht, termi "sinonim-(ik)-e" pritej të cilësonte jo "disa fjalë", por "një send të vetëm e të njëjtë", duke qëndruar kështu për terminin "simpragmatik-e".

5265. Marrja sado e zgjatur (1936-44, 1948-55, 1956-67=28 vjet) me *albanistikë* prapëseprapë ka përbërë vetëm një parentezë në vazhden e përpjekjeve të mia si metodolog dhe gnoseolog e, pra, si *filozof i shkencave*.

5273. Duke u mjaftuar vetëm me anasjelljen gjenetike të raportit "*Ideja – Materia*" në raportin "*Materia – Ideja*", e për pasojë duke parpranuar automatikisht reduktimin e që të katër rëndevet (pesë stadeve): "*Materialja, Biologjikja, Ideorja dhe Komunikativja e Ideores* (Etikja)" të "*Materiales tokësore*" në dy të vetmit rende (stade): "*Materialja*" dhe "*Ideorja*" të kësaj së fundit, materialistët paradoksalisht kanë bërë në thelb lojën e idealistëve.

5274. Ndërsa gjuha "e dëgjimit" "a thjesht f o n i k e" herë ndihmon tepër pak herë komprometon krejt zhvillimin tonë mendor të mirëfilltë, anasjelltas gjuha "e leximit" a "kryesisht ideografike" na mundshmon arritjen relativisht të pavështirë të niveleve më të lartë në teknikë, shkencë e filozofi.

5275. Duke kaluar në gjuhën e "leximit" a "kryesisht ideografike", gjuha e "dëgjimit" a "thjesht fonike" përveç sa e sa përfitimeve tjerë të një largvajtjeje së pallogaritshme (shih numrin pauses), dliret nga veset e improvizimeve e njëherazi çbarroset nga ballastet emocionalë!

5379. "Përkufizimi" i cilësdo fjalë, i reduktuar në komunikimin e thatë të gjinisë e farës së njohimit përkatës – shërben rëndom si "sinonim" i së njëjtës fjalë.

5380. “Kuptim” a “kuptime” të një fjale janë konceptet (njohimet) e komunikuar nga këjo fjalë.

5381. “Përkufizohet” jo vetë fjala, por “kuptimi” i saj, pandan i “konceptit” të sendit.

5382. Ndërsa në “fjalorët” përkufizohen kuptimet e fjalëvet, në “enciklopeditë” përshkruhen vetë gjërat si klasa.

5472. Ka qenë ignorimi i deritashëm i specifikës *intelektologjikisht gati absolute* së gjuhës së shkruar kundrejt së folurës që ka sjellë hiperbolizimin aq vulgar të rolit të të folurit për fatet e të menduarit.

5473. Nga tërë llojet e komunikimit gjuhësorofoljor më ekonomiku e njëherazi i efektshmi është ai edhe *gati pa zë* edhe *fare pa gjeste*.

5474. L’Ontologie et la Gnoséologie, comme la Logique et la Grammaire, toutes les quatres plus que bimillénaires, pourquoi donc sont-elles restées les moins susceptibles de progrès importants?⁷

5475. CONTRIBUTIONS POUR TRANSÉLABORER
L’ONTOLOGIE ET LA GNOSÉOLOGIE
DE
CONTROVERSES PHILOSOPHIQUES
À
SCIENCES FONDAMENTALES⁸

—
Livre premier
L’ONTOLOGIE ET LA GNOSÉOLOGIE
COMME
CONTROVERSES PHILOSOPHIQUES
Présentation de l’ouvrage et
Considerations introductives

—
Livre deuxième
L’ONTOLOGIE ET LA GNOSÉOLOGIE
COMME
SCIENCES FONDAMENTALES
Considerations introductives.⁹

—
Partie première du livre premier :
L’ontologie et la gnoséologie idéalistiques (Platon et Hegel, Croce et Gentile).

Partie deuxième du livre premier :
L’ontologie et la gnoséologie matérialistiques (Democrite et Marx)

⁷ [Ontologjia dhe Gnoseologjia, ashtu si Logjika dhe Gramatika, të katra mëshume se dymijëvjeçare, përse vallë kanë mbetur më pak të prekshmet nga progreset e rendësishme?]

⁸ [KONTRIBUIME PËR TË TEJ PËRPUNUAR/ ONTOLOGJI DHE/ GNOSEOLOGJI/ NGA/ KONTROVERSA FILOZOFIKE/ NË/ SHKENCA / HEMELORE/ (5-1-1977)]

⁹ Libër i parë ONTOLOGJIA DHE GNOSEOLOGJIA SI KONTROVERSA FILOZOFIKE/ Libër i dytë ONTOLOGJIA DHE GNOSEOLOGJIA SI SHKENCA THEMELORE

Partie troisième du livre premier :

L'ontologie et la gnoséologie mixtes (Aristote et Kant)¹⁰

5476. Présentation de l'ouvrage

I. Les trois principaux ordres de causes majeures, pour lesquelles l'Ontologie et la Gnoséologie universelles, déjà plus que bimillénaires, ne se trouvent toujours encore qu'à l'état d'interminables controverses philosophiques :

1. Les soi-disant "résidus théorophiques" ou "survivances releguées" dans l'Ontologie et la Gnoséologie idéalistiques en vérité en constituent toutes les composantes les plus substantielles.

2. Les tendances ultrapolémiqes, en soi bien naturelles mais scientifiquement on ne peut plus malsaines, des ontologues et des gnoseologues matérialistes à prendre presque partout l'exact contrepied de leurs adversaires idéalistes.

3. Depuis l'Antiquité jusqu'à nos jours, l'état général trop peu satisfaisant des trois études humaniste, préconditionnant directement l'élaboration définitive d'une Ontologie et d'une gnoséologie sinon scientifiques du moins scientifiquement responsables *alias* de la Psychologie, de la Logique et de la Linguistique.

II. Les temps ne sont-ils pas finalement mûr pour que sur les débris de l'Ontologie et de la Gnoséologie universelles soit tentée l'élaboration d'une Auto-Gnoséologie sinon scientifique du moins scientifiquement responsables¹¹

5477.

RÉFUTATION
DES GNOSÉOLOGIES,
PROTOÏDÉALISTO-DÉUTÉROMATÉRIALISTES
ET VICE VERSA,

¹⁰ Pjesa e parë e librit të parë: Ontologjia dhe Gnoséologjia idealistike (Platon dhe Hegel, Croce dhe Gentile). Pjesë e dytë e librit të parë: Ontologjia dhe Gnoséologjia materialistike (Demokrit dhe Marx). Pjesa e tretë e librit të parë: Ontologjia dhe Gnoséologjia të përziera (Aristotel dhe Kant).

¹¹ [I Tre rendet kryesorë të shkaqeve madhorë për të cilët Ontologjia dhe Gnoséologjia e përgjithshme, tashmë mbi dymijëvjeçare, ndodhen gjithnjë të ankoruara vetëm në gjendjen e kontraversave filozofike të pamabrim:

1. Të ashtuquajtrat "résidus théorophiques" apo "mbijetesa të releguara" në Ontologjinë dhe Gnoséologjinë idealistike në të vërtetë përbëjnë të gjithë përbërësit më thelbësorë të tyre;
 2. Tendencat ultrapolemike, në vete mtë natyrshme por shkencorisht nuk mundet më shumë të pashëndetshme, të etnologëve dhe të gnoseologëve materialistë për të marrë gati kudo qëndrimin e kundërt nga i kundërshtarëve të tyre idealistë;
 3. Qysh prej Antikitetit deri në ditët tona, gjendja e përgjithshme tepër pak e kënaqshme e tri studimeve humaniste, duke parakushtëzuar drejtpërsëdrejti elabirimin përfundimtar të një Ontologjie dhe të një Gnoséologjie nëse jo shkencore së paku shkencërisht të përgjegjshme *alias* të Psikologjisë, të Logjikës dhe të Linguistikës
- II. A nuk ka ardhur përfundimisht koha që në débris të Ontologjisë dhe të Gnoséologjisë universale të tentohet elaborimi i një Auto-Gnoséologjie nëse jo shkencore së paku shkencorisht të përgjegjshme -]

UNIVERSELLES
DÉMONSTRATION
D'UNE GNOSEOLOGIE,

- PROTOMATÉRIALISTO-PLURISTADIALISTE-TERRESTRE¹²

5616. E kështuquajtura “Logjikë matematike” [e cila, falë pëfaqësimit *simbolik* të njësitevet të të menduarit, lartëson largvajtshëm operimet mne-moteknikë me raportet midis tyre], vërte intereson direkt “Teknikën e t’arsyetuarit”, por është krejt e huaj për “Shkencën e të menduarit”, objekt ekskluziv i punimit tonë “*Intelektologjia*”.

Nga Fletore VIII

5644. S. R. tejhipërues (jo-dialektiko-hegelian) i “Dy GNOSEOLOGJIVET UNIVERSALE (TË IDEALIZMIT DHE MATERIALIZMIT) së kushtetuari abstraktisht e së zbatuari konkretisht një “GNOSEOGRAFI TOKËSORE (HYLOBIO-KONSCIO-”GLOSO”-ETIKE)”.

5674. Une Logique et une “Linguistique” s’évertuant à devenir scientifiques, mais ne réussissant à être que disciplines applicatives de sciences non constituées d’une part et la réduction des cinq stades (*matériel, biologique, conscientiel, interconscientiel, et moralo-éthique*) de l’exestentiel terrestre aux deux seuls stades consécutives, de l’*Idéal* et du *Matériel* ou vice versa du *Matériel* et de l’*Idéal* d’autre part; voila les deux ordres de causes (sans doute déterminantes mais toutefois subjectives et donc éliminables) de la FAILLITE en Europe d’une PHILOSOPHIE déjà beaucoup plus que bimillénaire.¹³

5681. Përmbi “Normat e Gramatikës” (e aq më tepër përmbi “Rregullzat e Drejtshkrimthit”) qëndron sovrani “Arti i stilit”.

5752. Moskushetimi i deritashëm i dy shkencavet “mbasmaterike” të të Menduarit dhe të të Ndërkomunikuarit të të Menduarit (a “Intelektologjisë” dhe “Interkomunikativistikës”) nuk mund të mos vononte kushtetimin shkencor nga njëra anë të Psikologjisë, Logjikës e Linguistikës, e nga ana tjetër të një Gnoseologjie shkencërisht së përgjegjësishme.

5762.

PËR

Forcën numerike
komponenten
DHE
nivelin teknik,

¹² [Refutim i gnoseologjive protoidealiste-deuteromaterialiste dhe vice versa, demonstrim universal i një gnoseologjie protomaterialisto-pluristadiialiste-tokësore]

¹³ [Një Logjikë dhe “Linguistikë” quke luftuar për t u bërë shkencore, por që ia dalin të jenë vetëm disiplina zbatuese të shkencave të pa-kushtetuarra nga njëra anë dhe reduktimi i pesë stadeve (material, biologjik, ndërgjgjor, ndërndërgjegjor dhe moralo-etik) të ekzistenciales tokësore në dy stade konsektive, të Ideale dhe të Materiales dhe vice versa të Materiales dhe të Ideale, nga ana tjetër; ja dy rendet e shkaqeve (pa dyshim përcaktuese por gjithësi subjective dhe pra të eliminueshme) të FALIMENTIMIT në Europë të një FILOZOFIE tashë shumë më se dymijëvjeçare].

GEGËRISHTJA BUZUKJANE - shih XIII
ËSHTË
NJË TOSKËRISHTE E GEGËZUAR

Në vend të parthënies:
NJË QËNDRIMMARRJE E DIFERENCUAR
NDAJ
NJË ARTIKULLI PROGRAMATIK
MBI
ALBANISTIKËN HISTORIKE

Në vend të hyrjes:
NJË SKICIM I GJENDJES SË STUDIMEVE
MBI
PROTOHISTORINË E SHQIPES SË SHKRUAR

5804. Kundrejt dy fazave: “ndijimore” e “ndjenjore” të *psikologjikes* qëndrojnë katër nivelet: “përkapjorë”, “ripranishmimorë”, “ideimorë” e “fantazimorë” (parafytyrorë) të *intelektologjikes*.

5893. La Logique et la Linguistique, loin d’être des “vraies sciences véritables”, ne sont que des “techniques applicatives” de “sciences paradocsalement encore toujours non-constituées”.

Logjika dhe Linguistika, larg së qeni “shkenca të vërteta”, nuk janë veçse “teknika zbatuese (ndajpalëzuse)” “shkencash paradoksalisht ende gjithënjë të pakushtetuara”.

6008. Gjon Buzuku, pionier naiv por epokal,
Pjetër Budi, çorientues anortografik por begatues i talentuar,
Pjetër Bogdani, turbullues strukturor por, kurorëzues definitiv
të Gegërishtes letrare vërte jo mbizotëruese por prapëseprapë në analizë të fundit bashkëpjesëmarrëse në kushtet e shqiptarishtes së mbasçlirimit.

6033. NJË ANALIZË KRITIKE E “SIGNALEVET” TË PAVLOVIT.

a) “Signalet” pavlovianë të “sistemit të parë” (përshtypje, ndijime, koncepte etj.), larg së qeni “shenja në largësi” të dhënash objektive, janë “riprodhime sui generis”, më shkurt, “idiodublime” të këtyre të fundit në ndërgjegjjen (njerëzore).

b) “Signalet” pavlovianë të “sistemit të dytë” (*fjalët*), janë materialitete referues jo të materialiteteve tjerë, por idealitete –

c) Raporti midis “një materialititi” përshenjues i një “idealiteti” dhe këtij të fundit – është krejt tjetër nga raporti midis “një ngacmimi” të organizmit dhe reagimit po të organizmit ndaj këtij ngacmimi.

ç) Pavlovi ka operuar me “signalet” a “shenjdhëniet në largësi”, pa pasë përkufizuar konceptin “shenj”.

d) Pavlovi ka operuar me “ndërgjegjjen njerëzore” si të padiferencuar funksionalisht në pesë nivelet: *ndijim, përkapje, ripranishmim, ideim realo- vërs dhe ideim realo-avers*.

dh) Pavlovi as që ka shtruar qartë (e aq më pak zgjidhur drejtë) pyetjen e pyetjeve nëse “refleksi i kushtëzuar” detyrohet përkapjes së ripranishmimit të bashkëngacmuesit të pranishëm apo ripranishmimit të të papranishmit etj.

e) Pavlovi sa do të ketë zbuluar se ndërlidhjet brendandërgjegjore kanë karakter jobashkëhapësinorë statik, por bashkëkohor e funksional (konkomi-tance)?

6037. Projekt – krijim, me kosto zero, pranë ASH së RPSSH
i një bërthame supermikse studiuesish, vrojtuesish e eksperimentuesish

për
tejpërpunimin eliminativo-integrativ
të
tri gjymsëshkencavet mbasbiologjike:
Psikologji – Logjikë – Gjuhësi
në

tri shkencat pargnoseologjike

Psikologji – Intelektologji – Komunikativistikë

6040. “Ndijimet e parafytyrimet” (edhe të I. P. Pavlovit) janë fakte brenda ndërgjegjorë, e, si të këtyllë, nuk mund të jenë as shenja në largësi (signale) as shenja në përgjithësi qoftë materialitetesh jashtëndërgjegjorë qoftë tjerë faktesh brendandërgjegjorë.

Në radhën e tyre “fjalët e folura”, larg së qeni shenja në largësi shenjash në largësi (a “signale signalesh) (siç do I. P. Pavlovi) janë mjete materialë të cilët edhe shprehin emocionalisht edhe shenjojnë konceptualisht fakte brendandërgjegjorë, e, si të këtyllë nuk mund të jenë shenja në largësi shenjash në largësi a signale signalesh: vetëm p.sh. “fjalët e shkruara”, si përfaqësuese të “të folurave” mund të merren si shenja shenjash.

6048. Mosparekzistimi i “Intelektologjisë” ndaj “Psikologjisë”, “Logjikës” dhe “Gjuhësisë” ka qenë fatal për këto tri të fundit.

Nga Fletore IX

6119. Sikundërqë të shpejtshkruarit ka nevojë për shumë më tepër shenja togtingujsh sesa të shkruarit e rendomtë për shenja njëtingujsh a shkronja alfabetike, ashtu edhe të menduarit globalisht operon me një numër pambarimisht më të madh konceptesh sesa të menduarit analitiko-sintetikusht.

6147. La restitution, par F. de Saussure, à la “Linguistique descriptive” de sa suprématie sur la “Linguistique historique” réhabilita, ipso facto, la “Grammaire grecque”, soeur jumelle de la “Logique” d’Aristote.¹⁴

6187. Me përjashtim të së vetmes “intelektologji”, që të gjitha tjerat shkenca të veçanta janë plotësisht të kushtetueshme edhe pamvarësisht nga

¹⁴ [Rivendosja nga F. de Saussure-i i supremacisë së “Linguistikës deskriptive” mbi “Linguistikën historike, ipso facto rehabilitoi “Gramatikën greke”, motër binjake e “Logjikës” së Aristotelit.]

çdo inkuadrim gnoseoteorik. Shkenca e Intelektit a Intelektologjia si Prope-
deutikë e përgjithshme e shkencave të veçanta.

Nga Fetore X

6251. Jo “Farët e fjalëvet” a “Pjesët e ligjëratës”, por “Farët e fjalëvet”
si “Gjymtyrë të fjalisë” – e përposojë “Kategorizimi i lëndëve mendimore a
koncepteve” simbas funksioneve të tyre si gjymtyrë të njësiteve mendimorë.

6323. Ai midis teje dhe A. K. ka qenë dhe do të përmbetet një antago-
nizëm jo intelektualo-individual por etiko-etnoidal.

6377. Themelimi i Intelektologjisë si shkencë e të menduarit në përg-
jithësi do të pasohet nga ai i Interkomunikativistikës si shkencë vërtë
kryesisht por ama jo edhe ekskluzivisht gjuhësore.

6378. Trajtimi i pasaktë i lëndëve të paplota të Logjikës së Aristotelit;
karakterit kompozit gnoseoteorik, intelektualogjik e oronoetik i lëndëve të L. së
A.; bilancet jo-aktivë të vlerësimeve gnoseoteorik, intelektualogjik dhe orono-
etik të L. së A.; meritat e përhershme dhe jo vetëm thjesht historike të L. së A.

6379. Diferencimin kategorik të intelektualogjikes nga psikologjika
Kanti e ka bërë i pari.

Nga Fletore XII

6620. Në frengjishte fjalëndërtimi rregullisht operon me tema jo
frenge por latine ; fjalori i italishtes, në një mori rasash, është shqeto latinisht
; kush *njeh* fjalorin e latinishtes, *ka njohur* fjalorët e riolatinishteve në ter-
minologjinë ndërkombëtare, pesha specifike e latinizmeve do të mbizotë-
rojë përherë e më gjërësisht atë të greqizmeve. Ja përse studimi *intensiv*
qoftë i frengjishtes qoftë i italishtes pa bashkëstudimin *ekstensiv* të latini-
shtes kushteton një kundërkuptim monstruoz.

6890. Ajo e Dante Alighierit: “*Nuk ka dhimbje më të madhe se të kuj-
tosh në mjerim kohën e lumtur*” – ja marrtë të keqen kësaj së mua kurrkushit
alias Selman Rizës:

“*Mezi mund të ketë pikëllim më të pafund se nga personalitet i mo-
shavet parpleqërore të katandisesh i depersonalizuar në pleqëri*”.

6916-6949. S. R. Mes vues sur la “*représentation du concret réel*” par
“*l’abstrait générique ergo linguistique et celles sur l’identifications concep-
tuelle des données particulières resp. singulières*” sont inespérément com-
plémentaires ergo corroboraries les unes des autres.¹⁵

Fletore XIII

7024. S. R. Depuis les bancs du Lycée de Kortscha, toute l’aspiration
de tout mon intellect a été que je devienne non pas “philo-sophe”, mais

¹⁵ [S.R. Pikëpamjet e mia mbi “rishtparaqitjen e konkretes reale” përmes “abstraktes gjenerike
ergo linguistike” dhe atyre mbi “identifikimin konceptual të të dhënave të veçanta përkat.
të vetme” janë pashpresueshëm komplementare ergo të vërtetuara me njëra tjetrën]

“sophe” ergo un “anti-sophiste”.¹⁶

7001-7131. Të dhënat materiale që ekzistojnë jashtë ndërgjegjjes sonë e që na porsa i kemi rrokur me shqisët tona, “pasqyrohen” prej nesh jo si *togje dy gjymtyrësh* që gjuhësisht quhen “subjekt” edhe “predikat”, por përkundrazi si *njësitet të thjeshtë* që konsistojnë në të vetmit “predikate” p.sh. “po resh, po vetëtin etj.”; e pra vetëm në “fenomene” në zhvillim hapësinoro-kohor e sipër, e si të këtillë ende jo të referuar te bartësit e tyre a “fenomenoforët” përkatës.

E, është në këta të pasqyruar nga ndërgjegjja të këtyre njësitive të këtillë të kushtetuar prej copash të vetme më vehte që konsiston praktikisht “të menduarit” në zanafillën e tij gjenetike.

Rrjedhimisht, është pra shndërrimi në fenomenoforin përkatës i çdo fenomeni në zhvillim hapsinoro-kohor e sipër që mundshmon tejzhvillimin e mendimevet nga njësitet prej copash-më-vehte në njësitet prej pjesësh-të-gjymtyrëzuara.

Analogjikisht, shndërrimit të një fenomeni në fenomenoforin përkatës i bashkëgjegjet shndërrimi i kësaj apo asaj forme mënyroro-kohore së një foljeje p.sh. “po resh, reshi, do të reshte etj.” në përkatësin emër foljor: “reshje”.

“gjërat” a “sendet” a “objektet” etj. ? ≡ “fenomenet e fenomenoforizuar”

Që nga mosfillimi i mosfillimit deri në mosmbarimin e mosmbarimit, kanë qenë dhe do të jenë si të vetëdhëna universale : “fenomenet në zhvillime hapsinoro-kohorë e sipër” e pra “fenomenet ende gjithënjë të patranskonceptuar në fenomenoforë nga

MENDJA GJITHËNJERËZORE.

“Fenomenoforët”, si konceptime të mendimit gjithënjëzësor janë :

- 1) bartës fenomenesh (në zhvillime hapësinoro-kohorë e sipër),
- 2) bashkëbartës veti – cilësish,
- 3) hyrës në raporte ndërmjet veti.

19-V-1980

7311. Kur një mendues-komunikues gabimisht a mashtrimisht, një autoprodhim të ndërgjegjjes së tij e komunikon si një idioduplikim të saj, atëherë komunikim-marrësi, me të diktuar këtë gabim a mashtrim të komunikuesit, normalisht e rektifikon të njëjtin komunikim duke e bërë pikërisht objekt të një mohimi ; - mohim ky, të cilit prej më se 2000 vjetsh e tëhu nuk i është dhënë ndonjë shpjegim i kënaqshëm e aq më pak zbuluar më tej e vërteta dhe gjetur më tej përkufizimi shkencor.

Pra, “mohimi” konsiston në kundërdëshmimin e karakterit idioduplikativ të një mendim-komunikimi në fakt autoproduktiv të ndërgjegjjes së mendues-komunikuesit përkatës.

7394. Nga “gjuha teknike” nëpër “prozën shkencore” drejt “stilit letrar”, - ja ! tri shkallët (bogdanië) të kulturës gojëtarë-shkrimore.

¹⁶ [S. R. Qysh nga bankat e Liceut të Korçës e tërë aspirata e tërë intelektit tim ka qenë që të bëhesha jo “philo-sophe”, por “sophe” ergo “anti-sophiste”.]

7002-7426. 30-IX-1980 L'énorme avantage gnoseothéorique du matérialisme posant "la matière" au premier des deux stades cosmogoniques sur l'idéalisme la reléquant au second, se trouve, dans le contexte de leurs trois postulats fondamentaux communs (*cosmisme, distadialisme, saltuarisme*) être (o ! paradoxe) réduite à une quantité philosophiquement négligeable. Les "deux" gnoseothéories, présumées antithétiques, voire antagonistes, de l'idéalisme et du matérialisme, ont vice versa pleinement en commun ces quatre caractéristiques: *pseudocosmisme, stadialisme non consecutif* et réductionnisme a deux seuls stades.¹⁷

7003-7450. 8-X-80. Sikundër që në harkun tokësor të Kozmosit fenomenal, materialiteti *inorganik*, më shkurt "hilologjikja" u tejkrijua në materialitetin organik më shkurt në "biologjiken"; po ashtu, në të njëjtin hark, shumë më vonë ndërgjegjja gjithënjëzore nga ndijimet, perceptimet, ripranishmimet e ideimet të "fenomenevet" kaloi njëherë në ndërgjegjjimet të "fenomenoforëvet" e mëpastaj nga fenomenoforizimi i jo-fenomenoforëvet, pa pushuar përkaq jashtë të njëjtit hark e madje edhe brenda këtij së ekzistuari edhe si fenomene të pafenomenoforizuar, duke mundshmuar kështu hopin e hopevet (në "aventurat gjithënjëzore") nga njësitë globale a fenomeni në njësitin analitiko-sintetike fenomenoforike gjegjësisht fenomenoforizuaro-fenomenike a (në planin komunikativistik gjuhësor) nga fjala – "fjali", te fjalia – "disafjalëshe".

¹⁷ [Përparësia enorme gnoseoteorike e materializmit që vë "materien" në të parin prej dy stadeve kozmogonike mbi idealizmin të cilin e zhvendos në të dytin, gjendet, në kontekstin e tre postulateve të tyre të përbashkët themelore (*kosmizëm, distadializëm, saltuarizëm*) (o ! paradoks) e reduktuar në një sasi filozofikisht të neglizhueshme. Të dy "gnoseoteoritë", të prezumuara autentike, domethënëne antagoniste, të idealizmit dhe të materializmit kanë vice versa plotësisht të përbashkëta këto katër karakteristika: *pseudokosmizëm, stadializëm jokonsekutiv dhe reduksionizëm në dy stade*].

Selman Riza
VEPRA 6

2022

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 13 tabakë shtypi
Tirazhi: 300 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

811.18:801.8

Riza, Selman

Vepra / Selman Riza ; përgatitur nga R. Ismajli. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2022. - libra ; 24 cm. - (ASHAK. Botime të Veçanta ; CCXVI : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë ; Libri 81)

[Vëllimi] 6. - 208 f. : ilustr.

1. Ismajli, Rexhep

Gjuha shqipe -- Burimet

ISBN 978-9951-26-057-2

Aleph [00008713]